

Seritë e Botimit të Departamentit të Kërcënimeve Ndërkombëtare/Sektorit  
për Çështjet Strategjike Policore Vëllimi 13

# Udhëzues i OSBE-së Policimi me Bazë Inteligjencën



Vjenë, qershor 2017

© OSBE 2017

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe kopjohet lirisht për qëllime edukimi dhe qëllime joko-merciale, me kusht që në çdo riprodhim të përmendet OSBE-ja si burimi i këtij dokumenti.

ISBN 978-3-903128-04-0

Sekretariati i OSBE-së  
Departamenti për Kërcënimet Ndërkombëtare  
Sektori për Çështjet Strategjike Policore

Wallnerstrasse 6  
A-1010 Vjenë, Austri  
Tel: +43-1 514 36 6942  
E-mail: [spmu@osce.org](mailto:spmu@osce.org) [osce.org/secretariat/policing](http://osce.org/secretariat/policing) [polis.osce.org](http://polis.osce.org)

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

351.74:355.40(497.7)(035)

POLICIMI me bazë inteligjencën : udhëzues i OSBE-së. - Shkup : OBSE, 2017.  
105 стр. : илустр. ; 24 см


Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 94-104

ISBN 978-608-4788-27-0

а) Полиција - Разузнавање - Македонија - Водичи  
COBISS.MK-ID 103864842

# Udhëzues i OSBE-së

Policimi me Bazë Inteligjencën



# Tabela e përmbajtjes

Parathënie	4
Përmbledhje	6
Falënderime	8
Hyrje	10
1. Modelet bashkëkohore të policimit	14
2. Informacionet, njohuritë dhe inteligjenca	16
3. Përkufizimi i Policimit me Bazë Inteligjencën	18
4. Avantazhet e Policimit me Bazë Inteligjencën	21
5. Aspektet ligjore, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e të dhënave	24
<b>6. Procesi i inteligjencës kriminale</b>	<b>30</b>
6.1 Ndarja e detyrave dhe planifikimi	31
6.2 Mbledhja dhe vlerësimi i informacioneve	33
6.3 Bashkimi dhe përpunimi i informacioneve	36
6.4 Analiza	36
6.5 Raportimi dhe shpërndarja e produkteve të inteligjencës	39
6.6 Vlerësim i procesit dhe masat në vijim	41
<b>7. Implementimi i PBI-së</b>	<b>42</b>
7.1 Modeli PBI i OSBE-së	43
7.2 Sfidat dhe kriteret kryesore të zbatimit të modelit	46
7.3 Analiza dhe vendimmarrja në kontekstin e zbatimit të ligjit	51
7.4 Nivelet e mekanizmave të inteligjencës kriminale	52
7.4.1 Mekanizmi i inteligjencës kriminale në nivel lokal/stacion policor	52
7.4.2 Mekanizmi i inteligjencës kriminale në nivel rajonal	53
7.4.3 Mekanizmi i inteligjencës kriminale në nivel qendror	53

7.5 Takimet për Ndarjen dhe Koordinimin e Detyrave	54
7.5.1 Takimet për Ndarjen dhe Koordinimin e Detyrave në nivel Strategjik	55
7.5.2 Takimet e Ndarjes dhe Koordinimit të Detyrave në nivel Taktik	55
7.6 Trajnimi dhe ndërgjegjësimi	56
<b>8. Modeli PBI në praktikë</b>	<b>58</b>
8.1 Modeli PBI, vlerësimet e kërcënimeve dhe planifikimi strategjik për të luftuar krimin e organizuar	58
8.1.1 Cikli i politikave të Bashkimit Evropian	59
8.1.2 Metoda Sleipnir për vlerësimin e krimit të organizuar	64
8.2 Shembuj të zbatimit të modelit PBI në nivel kombëtar	66
8.2.1 Modeli Kombëtar i Inteligjencës i Mbretërisë së Bashkuar	67
8.2.2 Shteti i Rajna Vestfalisë Veriore, Gjermani: Hartimi i politikave dhe planifikimi strategjik	72
8.2.3 Suedi: Strukturat organizative dhe vendimmarrëse sipas modelit PBI në Suedi	74
8.2.4 Republika e Serbisë: Strukturat operative dhe të inteligjencës të modelit PBI	80
8.2.5 Mali i Zi: Vlerësimet e Kërcënimeve nga Krimet e Rënda dhe nga Krimi i Organizuar	85
8.3 PBI dhe Policimi në Komunitet	88
8.4 PBI në parandalimin dhe luftën kundër terrorizmit dhe ERDhÇT-së	90
Referencat	93

# Parathënie

Aktivitetet policore përbëjnë një element kryesor në përpjekjet e OSBE-së për të forcuar sigurinë dhe stabilitetin në zonën e OSBE-së, andaj ato përfaqësojnë një aspekt të rëndësishëm të kontributit të organizatës për të forcuar përpjekjet e Shteteve pjesëmarrëse në trajtimin e kërcënimeve që vijnë nga aktivitetet kriminale. Që prej vitit 1999 aktivitetet policore përbëjnë një prej komponentëve bazë të përpjekjeve të OSBE-së në fushën e parandalimit të konflikteve, menaxhimit të krizave dhe rikuperimit pas konflikteve.

Në përputhje me mandatin e vetë, OSBE përpiqet të mbështesë në mënyrë konstante Shtetet e saj pjesëmarrëse për rritjen e kompetencave të tyre, për përmirësimin e efikasitetit të sistemeve të tyre gjyqësore dhe rritjen e kapaciteteve të tyre në zbatimin e ligjit dhe shërbimeve policore. Evoluimi i kërcënimeve ndërkombëtare, format e aktiviteteve kriminale që vazhdimisht ndryshojnë dhe kërkesa në rritje për shërbime që ofrohen nga policia, në mënyrë të vazhdueshme kërkojnë zëvendësim të strategjive, prioritetëve, planeve dhe metodave. Udhëzuesi i OSBE-së mbi Policimin me Bazë Inteligjencën përbën një hap të rëndësishëm të OSBE-së për trajtimin e këtyre sfidave.

Ky udhëzues paraqet Policimin me Bazë Inteligjencën (PBI) si një model modern dhe proaktiv të zbatimit të ligjit dhe një alternativë reale për Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në krahasim me format tradicionale reaguese të policimit. Modeli PBI, i cili është aprovuar dhe zbatuar në disa vende gjatë viteve të fundit me rezultate premtuese, kombinon mbledhjen, vlerësimin dhe analizën e informacioneve me procedurat dhe mekanizmat e vendimmarrjes që bazohen në informacione të besueshme, duke ofruar në këtë mënyrë një menaxhim më efikas dhe efektiv të zbatimit të ligjit në nivel kombëtar.

Studimet kanë nxjerrë në pah se PBI ka një potencial të konsiderueshëm si model modern i zbatimit të ligjit, por suksesi i tij varet shumë nga disa kërkesa specifike që paraqiten në mënyrë të përmbledhur në këtë udhëzues. Mbështetja politike, ndërgjegjësimi dhe përkushtimi i drejtuesve të lartë përbëjnë disa prej kërkesave kryesore.

Unë dëshiroj t'u shpreh mirënjohjen më shumë se 30 ekspertëve të strukturave të zbatimit të ligjit nga Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, nga bota akademike, organizatat ndërkombëtare dhe misionet e OSBE-së në terren që ofruan ndihmën e tyre Sektorit të çështjeve strategjike policore në Departamentin e kërcënimeve strategjike të OSBE-së për hartimin e këtij udhëzuesi, duke ofruar kontribute të vlefshme dhe duke rishikuar versionet e tij gjatë procesit. Dëshiroj, gjithashtu, të falënderoj kolegët tanë të Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) për shkëmbimin e njohurive të tyre lidhur me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave në kontekstin e PBI-së dhe zbatimit të tij.

Kryesia gjermane e OSBE-së në vitin 2016 dhe ajo austriake në vitin 2017 e kanë mbështetur fuqimisht iniciativën për modelin PBI në vendet ku vepron OSBE-ja. Botimi i këtij udhëzuesi nuk do të ishte realizuar pa mbështetjen e tyre.

**Lamberto Zannier**

*Sekretar i Përgjithshëm i OSBE-së*

Sot zbatimi i ligjit po përballet me sfida më komplekse se më parë. Në të njëjtën kohë janë rritur në mënyrë të konsiderueshme kërkesat e publikut për më shumë efikasitet, efektivitet dhe llogaridhënie nga ana e policisë. Modeli i Policimit me Bazë Inteligjencën (PBI) është zhvilluar vitet e fundit si një përgjigje ndaj këtyre sfidave në rritje. Ky model nuk ofron vetëm një qasje moderne ndaj identifikimit dhe planifikimit të masave kundër kërcënimeve të shtuara ndërkombëtare si terrorizmi dhe krimi i organizuar, por mund të zbatohet edhe në planifikimin e përditshëm proaktiv dhe menaxhimin e policisë. Në një kohë kur mbizotërojnë masat e marra për kursimin dhe kufizimin e buxhetit, PBI-ja u ofron drejtuesve të strukturave të zbatimit të ligjit metoda dhe mjete për identifikimin e prioriteteve dhe për caktimin e burimeve në përputhje me këto prioritetet.

Ky udhëzues e trajton PBI-në nga katër aspekte kryesore. Së pari, ai jep përkufizimin e PBI-së dhe arsyen kryesore të promovimit të këtij modeli si një qasje bashkëkohore në zbatimin e ligjit, e cila mund të zbatohet në të gjithë hapësirën ku shtrihet aktiviteti i OSBE-së si një e tërë. Së dyti, ai përfshin çështje të rëndësishme të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së të dhënave gjatë zbatimit të PBI-së. Së treti, udhëzuesi trajton analizën e të dhënave dhe informacioneve, e cila sjell si rezultat produkte të inteligjencës për nivelin strategjik dhe operacional, produkte të cilat shërbejnë si një bazë për procesin e vendimmarrjes që mbështetet në informacione dhe në prova. Së katërti dhe së fundmi, udhëzuesi bën disa rekomandime praktike për strukturat organizative në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal si dhe përcakton disa standarde minimale që kërkohen për departamentet e inteligjencës kriminale dhe mekanizmat e vendimmarrjes.

PBI-ja e vendos analizën e inteligjencës kriminale në qendër të procesit të zbatimit të ligjit. Ai gjithashtu e afron analizën e informacionit kriminal me procesin vendimmarrjes më shumë se modelet e tjera bashkëkohore të policimit, duke kërkuar si domosdoshmëri aftësi dhe kompetenca të reja nga analistët dhe drejtuesit e strukturave të zbatimit të ligjit.

Objektivi kryesor i këtij udhëzuesi është që t'u ofrojë Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së mjetet për të rritur nivelin e tyre profesional për zbatimin e ligjit, për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin e aktiviteteve të tyre dhe për të maksimizuar menaxhimin e burimeve të tyre, duke sjellë si rezultat rritjen e besimit të publikut dhe masat e identifikuara qartë kundër kërcënimeve ndaj sigurisë publike.

### ***Rasa Ostrauskaite***

*Koordinatorë e Aktiviteteve që adresojnë kërcënimet ndërkombëtare  
Sekretariati i OSBE-së*

## Përmbledhje

Policimi me Bazë Inteligjencën (PBI) është një metodologji moderne për zbatimin e ligjit. Në fillim është paraqitur në Mbretërinë e Bashkuar në vitet 1990-ta, modeli PBI është përdorur kryesisht për të luftuar krimet e rënda dhe krimin e organizuar. Rezultatet premtuese të arritura gjatë viteve të fundit i kanë nxitur autoritetet e zbatimit të ligjit ta shtrijnë metodologjinë proaktive që udhëhiqet nga inteligjenca në të gjitha fushat e menaxhimit të policisë si një model bashkëkohor pune. PBI përqendrohet në mbledhjen dhe vlerësimin në mënyrë sistematike të të dhënave dhe informacioneve nëpërmjet një procesi të përcaktuar të analizës, duke i shndërruar ato në produkte analitike për nivelin strategjik dhe operacional, të cilat shërbejnë si bazë për një proces më të mirë vendimmarrjeje të mbështetur në prova.

Dy prej sfidave kryesore të strukturave të zbatimit të ligjit në kohën e sotme janë ndërlikimet gjithnjë e më rritje dhe natyra ndërkombëtare e krimin, si dhe kërkesat në rritje të publikut për efikasitet financiar, d.m.th. “kryerja e më shumë punëve me më pak fonde”. Modeli PBI i trajton këto sfida duke theksuar dhe duke parashikuar përcaktimin e prioritetëve duke marrë për bazë inteligjencën dhe duke i ndarë detyrat dhe fondet ekzistuese sipas prioritetëve të vendosura.

Duke paraqitur në mënyrë të përmbledhur disa mekanizma të qartë dhe të përcaktuar të inteligjencës kriminale, procedura vendimmarrjeje dhe struktura organizative në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, ky udhëzues paraqet jo vetëm konceptin e modelit PBI, por ofron edhe mjete praktike për zbatimin e tij. Këtu përfshihet praktika e përditshme të policimit, planifikimi proaktiv strategjik dhe planet operacionale të veprimit, si edhe instrumentet për adresimin e krimeve të rënda dhe krimi i organizuar. Gjithashtu, ky udhëzues shpjegon sesi PBI mund të plotësojë në një masë të konsiderueshme policimin në komunitet, ndërkohë që dëshmon se ai është një mjet efikas në luftën kundër terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që mund të shpie në terrorizëm (VERLT/EDhRÇT).

Në modelin PBI më shumë rëndësi i kushtohet analizës së informacionit kriminal sesa në modelet e tjera bashkëkohore të policimit. Kjo kërkon aftësi dhe kompetenca më të mira analitike, madje në disa raste edhe aftësi të tjera brenda strukturave të zbatimit të ligjit. Duke qenë se modeli PBI e përqendron vëmendjen tek aspekti proaktiv i policimit dhe paraprirja e fenomeneve, suksesi i tyre varet shumë nga sa janë drejtuesit e strukturave të zbatimit të ligjit në gjendje të punojnë me analistët dhe si i përdorin ata produktet analitike në procesin e tyre të vendimmarrjes dhe të planifikimit. Si rrjedhim, në miratimin dhe zbatimin e modelit të PBI-së, vëmendje e veçantë i duhet kushtuar patjetër përgatitjes dhe trajnimit të drejtuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë brenda strukturave të zbatimit të ligjit.



Studimet kanë treguar se në qoftë se duam që modeli PBI të zbatohet me të gjithë potencialin e vetë, atëherë është e domosdoshme mbështetja politike, ndërgjegjësimi dhe përkushtimi i drejtuesve të nivelit të mesëm dhe të lartë. Në këtë udhëzues trajtohen edhe disa kushte tjera të rëndësishme që duhen përmbushur për zbatimin me sukses të PBI-së, duke përfshirë: metodologjinë e përfshirjes së shumë institucioneve, ngritjen e mekanizmave të qartë për ndarjen e detyrave, transformimin e mentalitetit nga “nevoja për të pasur njohuri” në “nevojën për të shkëmbyer/ndarë informacionet me të tjerët”; krijimin e kanaleve të komunikimit përmes Teknologjisë së Informacionit për qarkullimin e informacioneve; krijimin e bazës së të dhënave analitike dhe posedimin e analistëve me shkathtësi adekuate si dhe krijimin e strukturave përkatëse organizative që mbështesin modelin PBI.

Në mënyrë që PBI të funksionojë në mënyrë efikase, është me rëndësi thelbësore që të bëhet një lloj vlerësimi i produkteve të inteligjencës, të kryhet monitorimi në mënyrë konstante nga ana e drejtuesve si dhe të kontrollohet cilësia e modelit, ndërsa të gjitha këto duhet patjetër të jenë pjesë e procedurave të zbatimit të këtij modeli.

Në këtë udhëzues vazhdimisht theksohet, se respektimi i parimeve të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së të dhënave gjatë zbatimit të modelit PBI, është detyrim absolut i të gjitha strukturave të zbatimit të ligjit. Gjatë të gjithë kohës procesi i mbledhjes, përpunimit dhe përdorimit të të dhënave dhe informacioneve duhet patjetër që të jetë në përputhje me ligjet kombëtare dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Modeli i PBI-së synon të rrisë llogaridhënien e drejtuesve të strukturave të zbatimit të ligjit përmes mekanizmave të vetë të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm dhe procedurave transparente të mbështetura në prova të vendimmarrjes.

Ky udhëzues ofron një kuadër të përgjithshëm për PBI-në dhe për zbatimin e tij në të gjithë hapësirën ku OSBE-ja ushtron aktivitetin e vetë. Në këtë udhëzues nuk përfshihen detaje teknike të zbatimit të modelit të PBI-së, duke u dhënë mundësi Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së që t’ia përshtatin modelin nevojave dhe rrethanave të tyre kombëtare, si dhe kuadrit të tyre ligjor kombëtar.

## Falënderime

Departamenti për kërcënimet ndërkombëtare i OSBE-së dëshiron të falënderojë Arnar Jansson, menaxherin e Projektit për këtë udhëzues, për kontributin e tij në hartimin dhe në përgatitjen e këtij botimi. Për këtë udhëzues kanë kontribuar një grup ekspertësh të shquar të policisë, që përfaqësojnë disa Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së, organizata relevante në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, organizata të pavarura, që kryejnë studime dhe struktura ekzekutive të OSBE-së, duke dërguar materiale me shkrim dhe duke marrë pjesë në një takim dy ditor të ekspertëve. Ky takim u zhvillua në Vjenë me qëllim që të rishikohet versioni paraprak i udhëzuesit. Departamenti për kërcënimet ndërkombëtare/Sektori për çështjet strategjike policore (DKN/ SÇSP) u shpreh mirënjohjen dhe vlerëson këshillat dhe kontributet shumë të vlefshme të ofruara nga individët e mëposhtëm gjatë procesit të hartimit të këtij udhëzuesi:

Georgi Aladashavili, shef i Policisë së Tbilisit, Gjeorgji

Roberto Arcieri, shef i përkohshëm i Departamentit të Studimeve dhe Kërkimeve,

Zyra për vlerësim dhe zhvillim, Itali

Leena Anonius, këshilltare për çështjet gjinore, Seksioni i çështjeve gjinore, Sekretariati i OSBE-së

Pero Bozovic, shef i Departamentit të inteligjencës, mbledhjes së informacionit/

Agjencia shtetërore e hetimit dhe mbrojtjes, Bosnje-Hercegovinë,

Maryse Chureau, analiste strategjike/Ekipi i analizës strategjike në Europol,

Europol

Anders Danielsson, oficer për çështjet policore, DKN/SÇSP, Sekretariati i OSBE-së

Lotta Ekvall, këshilltare për çështjet gjinore, Seksioni i çështjeve gjinore, Sekretariati i OSBE-së

Nino Gakharia, shef i Divizionit Euro-Atlantik,

Ministria e Punëve të Brendshme, Gjeorgji

John Gustavsson, këshilltar i lartë për krimin e organizuar, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Johannes Heiler, këshilltar për çështjet e anti-terrorizmit,

Departamenti i të drejtave të njeriut, ODIHR

Jesus Hernandez Alvarez, analist, Policia Kombëtare, Spanjë

Iris Hutter, Sektori i analizës operacionale dhe strategjike,

Policia Kriminale Federale, Austri

Adrian James, ligjërues i lartë për hetimin penal, Instituti i Studimeve të Drejtësisë Penale,

Universiteti i Portsmuthit

Erik Johansen, këshilltar policor, Sektori i planifikimit dhe sjelljes civile,

Shërbimi i Jashtëm Evropian

Ivan Jokić, Kryeinspektor/Departamenti i inteligjencës kriminale,

Drejtoria e Policisë, Mali i Zi

Maxim Klepov, Ministria e Brendshme, Federata Ruse

Nenad Kostadinović, zëvendësshef i Departamentit të PBI-së, Ministria e Brendshme,

Republika e Serbisë

Dejan Lazaroski, shef i Sektorit të informacionit të inteligjencës strategjike, Departamenti i inteligjencës kriminale dhe analizës, Byroja e Sigurisë Publike, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë

Andrei Muntean, oficer i lartë për programet, Zyra e koordinatorit të OSBE-së për aktivitetet ekonomike dhe mjedisore, Sekretariati i OSBE-së

Susanna Naltakyan, Oficere kombëtare për programet, Zyra e OSBE-së në Jerevan

Tarik Ndifi, analist dhe studiues, Qendra për parandalimin e konflikteve, Sekretariati i OSBE-së

Maura O'Sullivan, këshilltare policore, Departamenti për siguri publike dhe mbështetje në komunitet, Misioni i OSBE-së në Shkup

Seda Öz Yildiz, drejtore e Institutit të Shkencave të Sigurisë, Akademia e Policisë, Turqi

Hans-Juergen Pechtl, asistent i drejtorit, Nëndrejtoria për analizën e informacionit kriminal, Sekretariati i Përgjithshëm i INTERPOL-it, Lion, Francë

Mark Reber, këshilltar i lartë policor, Shoqata ndërkombëtare e shefave të policisë

Joerg Rosemann, Kryeinspektor, Drejtoria e hetimit penal, Autoriteti policor i rajonit të Rheinisch Bergischer, shteti i Rinit Verior-Vestfalisë, Gjermani

Matej Seljak, Drejtoria e policisë kriminale, Drejtoria e përgjithshme e policisë, Slloveni

Bjordi Shehu, analist, Drejtoria e analizës dhe informacionit kriminal, Departamenti për hetimin e krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Shqipëri

Simon Smith, kryeinspektor, Zyra qendrore kombëtare kundër Terrorizmit, shefi i Sektorit të preventivës, Mbretëria e Bashkuar,

Thorsten Stodiek, zëvendëseshëf i DKN/SÇSP, Sekretariati i OSBE-së

Marco Teixeira, oficer programi, Seksioni i mbështetjes për zbatimin, Dega kundër krimit të organizuar dhe tregtisë të paligjishme, Divizioni për traktatet, UNODC

Adriana Toston Diez, kapitene, Guardia Civil, Spanjë

Per Wadhed, Departamenti për operacionet kombëtare, Policia suedeze

Dr. Ireen Winter, shefe e Sektorit të analizës operacionale dhe strategjike, Policia Kriminale Federale, Austri

Maica Wurmboeck, asistente projekti, DKN/SÇSP, Sekretariati i OSBE-së

# Hyrje

## Konteksti dhe shpjegimi i modelit të Policimit me Bazë Inteligjencën

Modelet tradicionale reaguese të zbatimit të ligjit janë ndeshur me vështirësi në përpjekjet për të përballuar rreziqet dhe kërcënimet e sotme dhe për të reaguar ndaj mundësive të reja, që u krijojnë kriminelëve e që mes të tjerash shkaktohen nga një rritje e lëvizjes së individëve dhe migracionit, ndryshimet e shpejta të teknologjisë dhe komunikimit, lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, si dhe nga rritja e pabarabartë e të ardhurave. Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizmi që çojnë në terrorizëm (EDhRÇT), si dhe aktet terroriste gjatë viteve të fundit, kanë nxjerrë në pah nevojën për të shkëmbyer, për të bashkuar e për të analizuar në nivel qendror të dhënat dhe informacionet nga të gjitha nivelet, në përputhje me legjislacionet kombëtare, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me angazhimet e OSBE-së. Policimi me Bazë Inteligjencën (PBI) u zhvillua si një përgjigje ndaj këtyre sfidave në rritje, duke frymëzuar dhe duke ndihmuar një qasje proaktive të policimit që plotëson modelin tradicional reagues të policimit. Ky model ka rezultuar të jetë një mjet efikas në adresimin e krimit të organizuar, në përdorimin më të mirë të burimeve dhe në identifikimin e detyrave që dalin për zbatimin e prioriteteve të përcaktuara qartë. Kjo qasje proaktive dhe vizionare e PBI-së ndihmon në parandalimin, reduktimin, goditjen dhe shkatërrimin e aktiviteteve kriminale. Thelbësore për qasjen e PBI-së është mbledhja dhe analizimi sistematik i të dhënave dhe informacioneve për parandalimin, reduktimin dhe shkatërrimin e aktiviteteve kriminale, në bazë të të cilave hartohen raporte inteligjence. Mbi këtë bazë mund të merren hartohen politika dhe të merren vendime të mirëinformuara dhe vizionare në lidhje me alokimin e resurseve, duke iu adresuar shqetësimeve, kërcënimeve, krimeve dhe kriminelëve me më shumë prioritet. Më të ngutshme në lidhje me sigurinë, llojet e krimeve dhe kriminelëve. Njashtu PBI-ja ka rezultuar, të jetë një mjet efikas dhe i qëndrueshëm në luftën kundër terrorizmit dhe EDhRÇT-së.

Duke u mbështetur në mandatin e tij për t'u ofruar asistencë Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së në ndërtimin e kapaciteteve, përmirësimin e nivelit profesional dhe në mbështetjen e zhvillimit dhe reformave të tyre policore, duke përfshirë edhe hartimin e udhëzimeve<sup>1</sup> të ndryshme, Sektori i çështjeve strategjike policore të Departamentit të kërcënimeve ndërkombëtare (DKN/SCSP) ka hartuar këtë udhëzues me titull "Policimi me Bazë Inteligjencën". Hartimi i këtij udhëzuesi u realizua në vijim të Takimit vjetor të ekspertëve të policisë, i cili u zhvillua në Vjenë në datat 9-10 qershor 2016 me temë Policimi me Bazë Inteligjencën. Një prej gjetjeve dhe konkluzioneve kryesore të këtij takimi ishte nevoja për një perceptim të përbashkët të OSBE-së në lidhje me konceptin e PBI-së dhe hartimi i një udhëzuesi për Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në lidhje me këtë temë. Kryesia gjermane e OSBE-së e vitit 2016, kryesia austriake e 2017-ës dhe Sekretari i Përgjithshëm i OSBE-së e kanë shprehur në mënyrë të qartë interesin dhe mbështetjen e tyre të fortë për promovimin e mëtejshëm të konceptit të PBI-së dhe për zbatimin e tij, duke e ngarkuar DKN/SCSP me hartimin e një udhëzuesi të OSBE-së për modelin e PBI-së.

Në përgatitjen dhe hartimin e këtij udhëzuesi, vëmendje e veçantë iu kushtua shmangies së dyfishimit të përpjekjeve dhe mbështetjes tek puna e kryer deri në atë kohë nga autoritetet kombëtare të Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së si dhe nga organizatat rajonale dhe ndërkombëtare në këtë fushë. Si rrjedhim, me lejen e autoriteteve përkatëse, për hartimin e këtij udhëzuesi u grumbulluan materiale me shkrim te përgatitura më parë.

1 Këshilli i Përhershëm i OSBE-së, Vendimi Nr. 1049. "Kudri Strategjik i OSBE-së për aktivitetet në lidhje me policinë" (PC.DEC/1049, Vjenë, 26 korrik 2012).

Materialet e këtij udhëzuesi për PBI-në përfshijnë materiale të përgatitura më parë nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC), Departamenti i Kombeve të Bashkuara për Operacionet Paqeruajtëse (UNDPKO), INTERPOL-i, Shërbimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian dhe nga EUROPOL-i.

Dokumentet ligjore në lidhje me PBI-në, udhëzimet zyrtare, manualët kombëtare dhe kontributet tjera me shkrim u grumbulluan nga disa autoritete kombëtare të Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe nga disa misione të OSBE-së në terren. Dokumenti i përbashkët informues i OSBE/UNODC mbi PBI-në i botuar në muajin prill 2016 për Takimin e përvitshëm të ekspertëve të policisë të OSBE-së në vitin 2016 (TPEP), shërbeu si baza e modelit të PBI-së të OSBE-së, i cili paraqitet në nënkapitullin 7.1 si kornizë e propozuar për zbatimin e konceptit të PBI-së në Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së.

Të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së dhe strukturat ekzekutive të saj, si dhe disa organizata rajonale dhe ndërkombëtare u ftuan të propozonin ekspertë për të rishikuar versionet e punës së udhëzuesit si dhe të ofrojnë kontributet e tyre. Rreth 30 ekspertë të propozuar morën pjesë në një seminar dy-ditor në Vjenë në dhjetor të vitit 2016; 15 prej këtyre ekspertëve ofruan kontribute me shkrim gjatë gjithë procesit të hartimit të këtij udhëzuesi.

Korniza teorike për modelin e PBI-së të OSBE-së që rekomandohet në nënkapitullin 7.1 mbështetet në studimin akademik të profesorit Jerry H. Ratcliffe, të prezantuar në librin e tij të vitit 2016 me titull “Policimi me Bazë Inteligjencën<sup>2</sup>”. Profesi Ratcliffe është studiuesi, i cili citohet më shpesh në lidhje me këtë temë. Tre akademikë të njohur në nivel ndërkombëtar paraqitën studimet e tyre mbi tema në lidhje me modelin e PBI-së në Takimin e përvitshëm të ekspertëve të policisë të OSBE-së në vitin 2016 (TPEP)<sup>3</sup>. Dr. Adrian James mori pjesë në seminarin për rishikimin e versionit paraprak të udhëzuesit dhe ofroi kontributin e tij me shkrim dhe pikëpamjen e tij akademike mbi përmbajtjen gjatë të gjithë procesit të hartimit të këtij udhëzuesi.

Gjatë procesit të përcaktimit të konceptit të përbashkët të OSBE-së në lidhje me PBI-në doli si nevojë kapërcimi i sfidave gjuhësore, pasi termi ‘inteligjencë’ nuk ka të njëjtin kuptim në gjuhë të ndryshme. Për shembull, përkthimi i konceptit të PBI-së nga gjuha angleze në gjuhën ruse mund të shkaktojë mospërputhje. Termi inteligjencë në gjuhën ruse interpretohet gjerësisht si të dhëna dhe informacione të kufizuara që ruhen nga shërbimet e sigurisë dhe agjenci të tjera të autorizuara, përfshirë strukturat policore (përgjegjëse) të autorizuara, ndërsa në gjuhën angleze ky term nënkupton të gjitha llojet e të dhënave dhe informacioneve të analizuar që përpilohen dhe disponohen nga institucionet e zbatimit të ligjit. Është e rëndësishme të kihet parasysh kjo mospërputhje gjuhësore kur i referohemi PBI-së, por edhe të përmendet se në të gjithë këtë udhëzues termi ‘inteligjencë’ i referohet kuptimit të dytë të këtij termi, gjegjësisht të dhënave dhe informacioneve të analizuar.

---

2 Ratcliffe (2016).

3 Këta akademikë janë: Dr. Adrian James, Lektor i lartë dhe studiues në Institutin e Studimeve të Drejtësisë Penale në Universitetin e Portsmouthit, Dr. Elke Devroe, Profesor i Asociuar dhe Kriminolog në Institutin e Sigurisë dhe Çështjeve Globale në Universitetin e Leidenit dhe Dr. Monica den Boer, Asistente Professore në Departamentin e Sigurisë dhe Kriminologjisë në Universitetin Macquarie në Sidnej, Australi dhe Drejtoreshë e Qendrës për Kërkime dhe Konsulencë për Sigurinë.

## Qëllimi dhe vlera e shtuar

PBI-ja nuk përbën një temë të re në OSBE. Disa misione të OSBE-së në terren veç më janë angazhuar prej kohësh në mbështetje të Shteteve pjesëmarrëse për zbatimin e PBI-së ose të disa prej përbërësve të këtij modeli. Përkundër zbatimit të pjesshëm ose të plotë të PBI-së në vendet e rajonit, ku OSBE-ja ushtron aktivitetin e saj, ka dhënë rezultate pozitive, duket se ka mospërputhje në lidhje me kuptimin, qasjen dhe mënyrat e zbatimit të PBI-së.

Ky udhëzues synon të shpjegojë dhe të paraqesë në mënyrë të përmbledhur kornizën dhe komponentët kryesorë të modelit PBI, me qëllim që ky model të kuptohet dhe të zbatohet njësoj në hapësirën ku OSBE-ja ushtron aktivitetin e vetë. Qëllimi i këtij udhëzuesi është që të shërbejë si një mjet praktik për hartuesit e politikave, vendimmarrësit e strukturave të zbatimit të ligjit dhe analistët e inteligjencës kriminale në përpjekjet e tyre për të përmirësuar nivelin profesional, efikasitetin dhe efektivitetin e policisë. Udhëzuesi ofron disa shembuj praktikë të praktikave të mira në zbatimin e modelit PBI bazuar në përvojën e Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe të organizatave ndërkombëtare, të cilat mund të përshtaten sipas rrethanave të çdo vendi.

Ndonëse i hartuar veçanërisht për hartuesit e politikave, zyrtarët e nivelit të lartë dhe për drejtuesit e strukturave të zbatimit të ligjit, ky udhëzues shërben edhe për të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit dhe trajnimit, si dhe për universitetet e botën akademike.

Ekzistojnë shkrime të ndryshme akademike dhe teorike mbi modelin PBI, si dhe një gamë materialesh teknike udhëzuese për komponentë të veçantë të këtij modeli, si udhëzues teknikë të Zyrës së UNODC-së, të cilët janë renditur në kapitullin e referencave, si dhe disa udhëzues të vendeve të ndryshme. Ky udhëzues harmonizon disa prej këtyre materialeve duke plotësuar në këtë mënyrë nevojën e identifikuar për një udhëzues mbi qasjen e përgjithshme të PBI-së që mund të përdoret si një material kuadër nga të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së dhe nga Partnerët për Bashkëpunim. Ai përfshin gjithë modelin e PBI-së, duke filluar nga korniza teorike, përkufizimet, disa prej koncepteve të rëndësishme dhe komponentëve kryesorë të modelit e deri tek paraqitja nga pikëpamja praktike e zbatimit të PBI-së, përfshirë analizën e informacioneve, vlerësimet e kërcënimeve, strukturat e vendimmarrjes dhe ato organizative.

Në përputhje me konceptin e saj gjithëpërfshirës të sigurisë, OSBE-ja e konsideron mbrojtjen e drejtave të njeriut, sundimin e ligjit dhe parimet demokratike si një element të pandarë të sigurisë. Shtetet pjesëmarrëse kanë arritur në përfundimin se nuk mund të ketë siguri nëse sakrifikohen të drejtat e njeriut, përkundrazi, ato që të dyja përbëjnë objektiva që përforcojnë njëra-tjetrën. Si rrjedhim, masat për zbatimin e ligjit sa u përket kërcënimeve ndaj sigurisë mund të jenë efektive vetëm në qoftë se ato janë në përputhje me të drejtat e njeriut. Për këtë arsye, një kapitull i veçantë përqendrohet tek aspektet ligjore, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e të dhënave, për t'i informuar pjesëmarrësit që marrin pjesë në diskutime nëpërmjet këtij udhëzuesi rreth konceptit të PBI-së dhe rreth zbatimit të tij në praktikë.

## Struktura e udhëzuesit

Pas paraqitjes në mënyrë të përmbledhur të modeleve më të zakonshme të policimit në kapitujt 1, kapitujt 2 dhe 3 përqendrohen tek sqarimi dhe paraqitja e përkufizimeve të modelit PBI dhe termave kryesorë që përfshin ky koncept. Kapitulli 4 jep një përmbledhje të shkurtër të avantazheve kryesore që mund të ketë zbatimi i modelit PBI në zbatimin e ligjit në ditët e sotme. Kapitulli 5, i cili është hartuar nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), e vë theksin tek çështjet e të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e të dhënave që përdoren në modelin PBI. Procesi i inteligjencës kriminale dhe analizës është shtylla e PBI-së dhe baza e kornizës të vendimmarrjes që paraqitet në këtë udhëzues. Si rrjedhim, Kapitulli 6 shpjegon gjashtë fazat tradicionale të procesit të inteligjencës dhe se si zbatohet ai në kontekstin e PBI-së.

Pasi trajtohet koncepti i modelit të PBI-së, çështjet e të drejtave të njeriut dhe mbrojtja e të dhënave dhe procesi i analizës së inteligjencës kriminale, kapitulli 7 përqendrohet tek aspektet operacionale të PBI-së dhe zbatimi i tij në praktikë, duke filluar me një paraqitje grafike të modelit të propozuar të PBI-së sipas OSBE-së dhe një përshkrim të shkurtër të secilit prej komponentëve të tij kryesorë. Ky kapitull pasohet nga një nënkapitull ku identifikohen disa prej sfidave dhe kushteve, që duhen përmbushur në drejtim të zbatimit të modelit. Duke qenë se analiza, raportet e vlerësimit dhe produktet e tjera të inteligjencës kriminale përbëjnë bazën e planifikimit në nivel strategjik dhe operacional, ky udhëzues e vë theksin në mënyrë të përsëritur tek rëndësia e marrëdhënies ndërmjet procesit të analizës dhe vendimmarrjes. Si rrjedhim, një nënkapitull i veçantë i kushtohet procesit të vendimmarrjes në modelin PBI, pas të cilit vijnë nënkapitujt 7.4 dhe 7.5 mbi mekanizmat dhe departamentet në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar të inteligjencës kriminale, si dhe strukturat e propozuara për takimet e ndarjes së detyrave dhe të vendimmarrjes. Këta kapituj ofrojnë sugjerime të qarta se si të zbatohet në praktikë modeli i PBI-së në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal nga këndvështrimi i menaxhimit të strukturave të zbatimit të ligjit. Kapitulli 7 përfundon me një përmbledhje të shkurtër të elementeve thelbësore të trajnimit për të gjitha nivelet e përfshira në zbatimin e modelit të PBI-së.

Kapitulli i fundit, pra kapitulli 8, jep disa shembuj praktikë të zbatimit të modelit të PBI-së, duke filluar me përdorimin e këtij modeli për adresimin e krimeve të rënda dhe krimin të organizuar, duke paraqitur dy metodologji gjerësisht të pranuar të vlerësimit të kërcënimeve, Vlerësimin sipas BE-së të Kërcënimeve nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar (SOCTA) dhe Metodën Sleipnir të Vlerësimit të Kërcënimeve dhe Rreziqeve. Këto dy metodologji pasohen nga prezantimi i modelit të PBI-së në pesë vende: Mbretërinë e Bashkuar, Gjermani (Rin-Vestfalia e Veriut), Suedi, Republikën e Serbisë dhe Malin e Zi. Krahas kësaj, kapitulli analizon edhe se si modeli i PBI-së mund të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin në dy fusha të tjera të zbatimit të ligjit që janë policimi në komunitet dhe lufta kundër terrorizmit dhe EDhRÇT-së.

# 1. Modelet bashkëkohore të policimit

Studiuesit dhe literatura e zbatimit të ligjit i ndajnë zakonisht metodologjitë e zbatimit të ligjit në pesë modele policimi: policimi tradicional, policimi në komunitet, policimi me fokus në zgjidhjen e problemeve, policimi i bazuar tek statistikat kompjuterike dhe PBI. Secili prej këtyre modeleve ka objektivat e veta strategjike, ka anë të forta dhe të dobëta, por mund të plotësojë modelet e tjera kur përdoret më shumë se një model njëherësh. Për shembull, modeli i PBI-së po zbatohet gjithnjë e më shumë për të përforcuar policimin në komunitet, duke qenë se ky model ofron procese të qarta, procedura komunikimi dhe struktura menaxhimi për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve, analizën dhe shpërndarjen e tyre<sup>4</sup>. Një shembull tjetër ofrohet nga vendet ku dominon modeli tradicional, reagues, ndërsa modeli i PBI-së zbatohet vetëm për të luftuar krimet e rënda dhe krimin e organizuar. Një faktor i përbashkët i katër modeleve të sipërpërmendur, që shpesh paraqitet si një dobësi e zbatimit të ligjit në ditët e sotme është se ato përqendrohen tek fushat dhe kërcënimet në nivel lokal.

Ndryshimet e shpejta dhe të mëdha në nivel global e kanë ndryshuar mjedisin e krimit dhe si rrjedhim, këto metodologji nuk posedojnë cilësitë e nevojshme për adresimin e kërcënimeve më të rënda të krimit të organizuar në nivel ndërkombëtar. Policimi me Bazë Inteligjencën është metoda e vetme me pozicion unik në luftën efikase ndaj krimit të organizuar në nivel ndërkombëtar.<sup>5</sup>

**Policimi tradicional**, është ndoshta modeli më i njohur ndër modelet e policimit dhe përbën ende stilin standard të zbatimit të ligjit. Ai ka të bëjë me një stil reagues që nxitet nga ngjarjet, ku punonjësit e policisë reagojnë ndaj krimeve dhe kërkesave që paraqiten për shërbime ose ndërhyrje. Marrja e telefonatave, marrja e ankesave, patrullimi në komunitet pa ndonjë qëllim të caktuar, por thjesht për të demonstruar dukshëm praninë e policisë dhe për të ndërhyrë në raste krimesh që kanë ndodhur apo që janë duke ndodhur, përbëjnë thelbin e policimit tradicional. Ndërkohë që modeli i policimit tradicional i konsideron çështjet e sigurisë dhe të rendit publik si detyrë të policisë, policimi në komunitet përqendrohet tek partneriteti mes policisë dhe publikut në adresimin në mënyrë proaktive, të çështjeve që lidhen me sigurinë.

---

4 Shiko nënkaptullin 8.3 mbi PBI-në dhe Policimin në Komunitet.

5 Bell dhe Congram (2013: 19).



**Policimi i orientuar nga komuniteti** synon të ndërtojë besimin dhe të rrisë komunikimin ndërmjet policisë dhe publikut. Programet e policimit në komunitet përfshijnë krijimin e forumeve të komunitetit me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga grupe të ndryshme të komunitetit dhe institucioneve, ku diskutohen dhe trajtohen çështjet në lidhje me sigurinë, përfshirë ngjarjet kriminale dhe zhvillimet në nivel lokal.

Në modelin e **policimit që orientohet nga zgjidhja e problemeve**, identifikimi dhe analiza e “problemimit” përbëjnë çështjen bazë, ku përqendrohet më shumë puna e policisë sesa një krim, një çështje, një telefonatë apo një incident. Modeli e vë theksin tek problemi që qëndron pas krimit ose çështjeve të sigurisë. Policia duhet të hartojë strategji parandaluese në mënyrë proaktive për të zgjidhur problemet dhe jo thjesht të reagojë ndaj pasojave të tyre të dëmshme. Shtepi.

**Modeli i statistikave kompjuterike** (CompStat) është një sistem menaxhimi, i cili në fillim u krijua sipas modelit “të teorisë së dritareve të thyera”, me anë të të cilit trajtohen krimet e vogla me qëllim që të reduktohen krimet e rënda. Mbi bazën e analizës së statistikave të krimeve të kryera, çdo drejtues i strukturave lokale të zbatimit të ligjit mban përgjegjësi për kryerjen e veprimeve në nivel lokal, veprime që organizohen në përputhje me nevojat e tyre.

## 2. Informacioni, njohuritë dhe inteligjencia

Përpara se të shpjegohet më në detaje modeli i PBI-së, është e nevojshme të sqarohen disa koncepte kryesore. Termi ‘inteligjencë’ ka përkufizime të ndryshme në varësi të kontekstit, kulturës, gjuhës dhe traditës. Në literaturën e analizuar gjatë procesit të hartimit të këtij udhëzuesi u konstatua se përdorimi i këtij termi nënkupton një metodologji, një strukturë, një proces dhe një produkt. Analiza nxori në pah edhe disa pikëpamje kontradiktore dhe një kuptim të paqartë të koncepteve që qëndrojnë pas termave si ‘të dhëna’, ‘informacione’ dhe ‘njohuri’.

„Mungesa e qartësisë dhe e një kuptimi të përbashkët në lidhje me terminologjinë dhe proceset e inteligjencës e pengon shkëmbimin e informacioneve ndërmjet agjencive.“

– Shoqata Ndërkombëtare e Shefave të Policisë (2002)

Si rrjedhim, është e domosdoshme të trajtohet dhe të sqarohet kuptimi i këtyre koncepteve. Pas analizës së dokumenteve të botuara nga UNODC-u, UNDPKO-ja, INTERPOL-i, Bashkimi Evropian (BE), si dhe të literaturës akademike, ky udhëzues përdor përkufizimet e mëposhtme, të cilat janë të pranura gjerësisht në lidhje me konceptet e mësipërme:<sup>6</sup>

*Të dhënat* janë fakte dhe matje të papërpunuara dhe të painterpretuara, që janë konstatuar. Shembuj të të dhënave përfshijnë veçori të aktiviteteve kriminale, të cilat vlerësohen me lehtësi nga pikëpamja sasiore, si raportet për krimet dhe statistikat tjera të kriminalitetit, bazat e të dhënave për kriminelët dhe detyrat e policisë.

*Informacionet* janë të dhënat që vendosen në një kontekst të caktuar, të cilave u jepet kuptim, gjë që u jep atyre rëndësi më të madhe dhe një qëllim të caktuar.

*Njohuritë* janë informacionet, të cilave iu jepet një interpretim dhe një kuptim. Kur një person i shton informacionit gjykimin e tij/saj, atëherë informacioni shndërrohet në njohuri.

*Inteligjencia* iu referohet të dhënave, informacioneve dhe njohurive, të cilat vlerësohen, analizohen dhe paraqiten në një format vendimmarrjeje me qëllim që të orientojnë hapat që duhen ndërmarrë.

---

6 Përkufizimet e termave “të dhëna”, “informacione”, “njohuri” dhe “inteligjencë” bazohen tek: Ratcliffe (2016: 70-74); UNODC, Udhëzuesi për Inteligjencën Kriminale për analistët (Vjenë: Botim i Kombeve të Bashkuara), (2011a: 1); “Analiza e inteligjencës kriminale” e INTERPOL-it. Dokumenti me të dhëna (2014); dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, “Vendimi Kuadër i Këshillit i 18 dhjetorit 2006 mbi thjeshtimin e shkëmbimit të informacionit dhe inteligjencës midis autoriteteve të zbatimit të ligjit të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian.” Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian (2006/960/JHA, 18 dhjetor 2006).




Figura 2.1 Nga të dhënat tek inteligjenca

Burimi: Ratcliffe (2016: 72).

Në një rajon të policisë lokale, incidentet e vjedhjeve të banesave regjistrohen në bazën e të dhënave të policisë. Këto detaje që ruhen në kompjuter përbëjnë të **dhënat**. Kur një analist i inteligjencës kriminale hyn në kompjuter, i hedh këto të dhëna në hartë dhe konstaton një lloj tendence të re në lidhje me vjedhjet e fundit të banesave në zonë, këto të dhëna shndërrohen në **informacion**. Në thelb, të dhënat e para pasurohen ndjeshëm për të arritur në konstatimin e një tendence. Në qoftë se në vijim, analisti e diskuton dhe e ndan këtë informacion me një punonjës nga strukturat e hetimit të krimit, opinionet dhe perceptimet e tyre shndërrohen në **njohuri**. Pas mbledhjes së të dhënave dhe informacioneve të tjera dhe pas analizimit të tyre nga strukturat e hetimit të krimit, analisti është në gjendje të ndërtojë një tablo në mendjen e vet, një tablo që pa dyshim ka boshllëqe, por që ka edhe material të mjaftueshëm për të mbështetur hipotezat që mund të ngrihen. Analisti i inteligjencës kriminale dhe punonjësi i strukturave të hetimit hartojnë një raport për analizën operative dhe informojnë një punonjës me gradë të lartë. Ai/ajo vendos të hetojë dhe fillon një operacion vëzhgimi ndaj hajdutëve të banesave mbi bazën e **inteligjencës**, që ka marrë nga analisti dhe punonjësi i strukturave të hetimit të krimit.

Shënim: Shembull i thjeshtuar dhe i formuluar ndryshe nga Ratcliffe (2016: 73-74).

### 3. Përkufizimi i Policimit me Bazë Inteligjencën

Ashtu si edhe me konceptet e trajtuara në kapitullin 2, shihet se ka ide të ndryshme e madje kontradiktore në lidhje me përkufizimin e PBI-së. Disa mendojnë se PBI ka lidhje me kryerjen e vlerësimeve të kërcënimeve, ndërsa të tjerë pretendojnë se termi i referohet procesit të grumbullimit të të dhënave dhe informacioneve. Këto pikëpamje ofrojnë kontribute të vlefshme për komponentët e modelit PBI, por nuk e mbulojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse këtë model. Këto interpretime të ndryshme të PBI-së janë të kuptueshme, sepse ky është një koncept relativisht i ri<sup>7</sup> në ndryshim e sipër. Deri kohët e fundit modeli i PBI-së është përdorur kryesisht në lidhje me kriminelët e përfshirë në krimin e organizuar dhe në krimet e rënda. Përvojat pozitive i kanë bindur profesionistët dhe akademikët për një kornizë më përfshirëse të PBI-së, që përfshin të gjitha aktivitetet policore, d.m.th. modelin e një procesi me një infrastrukturë organizative për të mbështetur kryerjen e detyrave policore në përgjithësi. Këto zhvillime e kanë zhvendosur analizën më afër qendrës së të gjitha fushave të policimit, duke theksuar më shumë bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet analistëve dhe vendimmarrësve të strukturave të zbatimit të ligjit. Kjo kërkon që vendimmarrësit të njohin potencialin e analizës dhe sesi t'i përdorin rezultatet e analizës. Si rrjedhim, policimi proaktiv i rrënjësor në PBI kërkon aftësi dhe kompetenca të reja të analistëve, hartuesve të politikave, drejtuesve të strukturave të zbatimit të ligjit dhe vendimmarrësve të tjerë. Kjo temë e rëndësishme është trajtuar më shumë në kapitullin. Megjithatë ky udhëzues inkurajon një zbatim në mënyrë proaktive të PBI-së në të gjitha fushat e mundshme të policimit, shumica e vendeve që po e zbatojnë tashmë modelin PBI e kanë kufizuar zbatimin e tij në aspektin operativ ndaj krimeve të rënda dhe krimit të organizuar, kriminelëve përsëritës, zonave të nxehta të kriminalitetit dhe krimeve që në përgjithësi shkaktojnë shqetësim për publikun.

“Policimi me bazë inteligjencën e vë theksin tek analiza dhe informacioni i përpunuar si elementët thelbësorë të një kornize objektive vendimmarrjeje, që përcakton prioritetet në lidhje me zonat e nxehta të kriminalitetit, viktimat e përsëritura, kriminelët përsëritës dhe grupet kriminale. Ai ndihmon në reduktimin e krimit dhe pasojave tij, Në parandalimin dhe goditjen e aktiviteteve kriminale nëpërmjet menaxhimit në nivel strategjik dhe taktik, shpërndarjes adekuate të burimeve dhe zbatimit të ligjit.”

– Ratcliffe (2016: 66).

Modeli i PBI-së i referohet një kornize për menaxhimin e inteligjencës kriminale dhe për punën e planifikuar operative të policisë, ku informacioni i përpunuar përbën themelin për përcaktimin e prioriteteve, objektivave strategjike dhe operative për parandalimin dhe luftën ndaj krimit dhe kërcënimeve të tjera të sigurisë. Ai përfshin edhe marrjen e vendimeve të përshtatshme në lidhje me

7 Ministria e Brendshme në Mbretërinë e Bashkuar paraqiti për herë të parë konceptin e Policimit me Bazë Inteligjencën në vitin 1993, por ky koncept u zbatua për herë të parë në nivel operacional nga Policia e Kentit. Pas ngjarjeve të 11 shtatorit, autoritetet e zbatimit të ligjit në SHBA e kanë aprovuar PBI-në si metodologjinë e luftës ndaj terrorizmit. Për më shumë detaje, lexoni Peterson (2005).

punën dhe veprimet operative të policisë, angazhimin në mënyrë racionale të burimeve njerëzore ekzistuese dhe shpërndarjen e burimeve materiale dhe teknike<sup>8</sup>

Megjithëse modeli PBI sfidon modelin tradicional, ku mbizotëron reagimi dhe ndërhyrja nga ana e policisë, aprovimi i tij dhe përshtatja e zbatimit të ligjit me procesin e të menduarit, të të përcaktuarit të prioriteteve dhe të të planifikuarit në mënyrë proaktive, nuk ka për të ndryshuar faktin që policisë do t'i duhet prapëseprapë të reagojë ndaj incidenteve të sigurisë dhe krimeve të kryera. Në një strukturë organizative, ku informacionet përkatëse mblidhen, shkëmbehen dhe analizohen në mënyrë sistematike në kuadër të një strategjie, prioriteteve dhe objektivave të përcaktuara, modeli PBI është i projektuar në mënyrë të tillë që të ndihmojë drejtuesit e strukturave të zbatimit të ligjit që të marrin vendime të mbështetura në prova dhe në informacionet e mblledhura dhe të analizuar – jo vetëm në përcaktimin e prioriteteve strategjike, por edhe në planifikimin e përditshëm operative. Në këtë kuptim, PBI shërben si plotësues i policimit tradicional, reagues.

Modeli PBI është një model për zgjidhjen e problemeve nga nivelet më të larta tek ato më të ulëta të një organizate, model vendimarrjeje dhe menaxhimi, megjithëse komunikimi dhe shkëmbimi i informacioneve brenda modelit funksionon si nga poshtë-lartë, ashtu edhe nga lartë-poshtë. Në dallim nga modeli PBI, modeli i Policimit në komunitet përbën një qasje tipike për zgjidhjen e problemeve nga nivelet më të ulëta tek ato më të larta të organizatës, i cili synon të rrisë besimin mes policisë dhe publikut.

“Policimi me bazë inteligjencën është lufta ndaj krimit, që ka ka për bazë mbledhjen dhe analizimin efikas të inteligjencës – dhe ky model ndaj krimit, që ka të jetë shpikja më e rëndësishme e shekullit XXI për zbatimin e ligjit.”

– **Kelling and Bratton (2006: 5).**

---

8 Ministria e Brendshme e Republikës së Serbisë, Udhëzues mbi Modelin e Inteligjencës Policore (2016: 16).

Modeli i 4 i-ve, emër që vjen nga 4 koncepte që në gjuhën angleze, prej nga edhe vjen modeli, fillojnë me germën ‘i’ dhe që janë ‘*intent*’ (qëllimi), ‘*interpret*’ (interpretimi), ‘*influence*’ (influencimi), dhe ‘*impact*’ (ndikimi ose efekti) na ndihmon për të shpjeguar rolet dhe raportet mes aktorëve kryesorë të konceptit PBI: situata kriminale, analistët e inteligjencës kriminale dhe vendimmarrësit e policisë. Që modeli PBI të funksionojë me të gjithë potencialin e tij duhet që të katër komponentët të miratohen dhe të funksionojnë si duhet. Modeli e vë theksin tek marrëdhënia mes analizës së inteligjencës kriminale dhe vendimmarrësve. Vendimmarrësit (drejtuesit) caktojnë detyra, drejtojnë, këshillojnë dhe udhëheqin analistët e inteligjencës kriminale. Së pari, vendimmarrësit duhet të sigurohen që qëllimet e tyre të shpjegohen dhe të kuptohen. Së dyti, analistët interpretojnë situatën kriminale dhe, së treti, ndikojnë tek vendimmarrësit përmes konkluzioneve të analizave të tyre. Mbi bazën e këtyre konkluzioneve, vendimmarrësit (së katërti) me vendimet sjellin efekte mbi situatën kriminale nëpërmjet menaxhimit në nivel strategjik, planeve të veprimit, hetimeve dhe operacioneve siç tregohet në figurën 3.1.<sup>9</sup>






Figura 3.1 Modeli i 4 i-ve: qëllimi, interpretimi, ndikimi dhe efektet

Burimi: Ratcliffe (2016: 83).



<sup>9</sup> Në materialin e saj udhëzues teknik, Zyra e UNODC-së thekson rolin qendror të analistit dhe produkteve të analizës në procesin e vendimmarrjes. Shihni modelin për Ndarjen e Detyrave që paraqitet nga Zyra e UNODC-së (2011b: 5).

## 4. Avantazhet e Policimit me Bazë Inteligjencën

Në industrinë private dhe në komunitetin e biznesit, informacioni dhe intelijenca përbëjnë faktorët kryesorë të avantazheve konkurruese. Në këtë kontekst, edhe zbatimi i ligjit nuk ndryshon, duke qenë se avantazhi strategjik i bazuar tek informacioni, njohuritë dhe intelijenca e rrit efektivitetin e strukturave të zbatimit të ligjit për të parandaluar incidentet dhe për të goditur grupet dhe rrjetet kriminale. Megjithatë nuk është e mjaftueshme që të kesh informacion, njohuri dhe intelijencë; por nevojitet një kornizë ose një model i përshtatshëm për të menaxhuar intelijencën dhe për ta shfrytëzuar atë në maksimum dhe për t'u siguruar që të dhënat dhe informacionet mblidhen, përpunohen dhe përdoren në përputhje të plotë me ligjet kombëtare dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Modeli i PBI-së u mundëson drejtuesve të policisë një qasje proaktive dhe vizionare. Zbatimi i tij me sukses gjatë viteve të fundit në disa vende të botës, në drejtim të adresimit të kërcënimeve nga krimet e rënda dhe krimet në nivel ndërkombëtar ka nxitur hartimin e një koncepti të PBI-së, nga një model që zbatohet kryesisht për të luftuar krimin e organizuar në një model më të përgjithshëm dhe më strategjik për adresimin e një game të gjerë problemesh të policimit në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar. Ky zhvillim lidhet drejtpërsëdrejti me kërkimet për metoda të zbatimit të ligjit, që e bëjnë policinë të ketë më shumë ndikim mbi krimin, tendencat e kriminalitetit dhe pasojat sociale të kriminalitetit, ndërkohë që burimet i ka të kufizuara, ndërsa kërkesa për llogaridhënie sa vjen e rritet.

Gjatë viteve të fundit kërkesat për shërbime dhe ndërhyrje nga ana e policisë kanë shkuar përtej burimeve që ka policia në dispozicion, duke e bërë kështu të nevojshme përcaktimin e prioritetëve dhe rritjen e efikasitetit të burimeve të strukturave të zbatimit të ligjit. Në të njëjtën kohë janë rritur edhe pritshmëritë e politikanëve dhe të publikut për llogaridhënie nga ana e strukturave të zbatimit të ligjit. Modeli i PBI-së paraqitet si një alternativë për të plotësuar këto kërkesa në rritje duke qenë se ai ofron arsytimin dhe mjetet për të vlerësuar dhe për të analizuar kërcënimet ndaj publikut, duke mundësuar procedura më mirë të dokumentuara, më transparente dhe më lehtësisht të verifikueshme të vendimmarrjes, për t'i përqendruar burimet ekzistuese atje ku ato nevojiten më shumë.

“Nevoja për futjen në përdorim të modelit të Policimit me Bazë Inteligjencën (PBI) nuk duhet të vihet në dyshim. Në periudhat e kufizimeve në buxhet dhe në burime, çdo individ dhe organizatë e përgjegjshme duhet të identifikojë prioritetet e veta në adresimin e problemeve madhore. Për të ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve, vendimet duhet të merren mbi bazën e fakteve dhe inteligjencës, baza e të cilave është informacioni. Modeli i PBI-së do të kontribuojë për ta bërë rentabël procesin e caktimit të burimeve dhe për t'i përqendruar përpjekjet në mënyrë më të strukturuar. Kjo do të ndihmojë në përballimin e një sofistikimi dhe lëvizjeje në rritje të kriminelëve që përipiqen të cenojnë ligjin dhe rendin.”

– **Shërbimi i Jashtëm i Bashkimit Evropian (2013: 12).**

Fakti që ekstremistët e dhunshëm që qëndrojnë pas akteve terroriste të kohëve të fundit, përfshirë edhe ata që veprojnë të vetëm, kanë qenë në valët e radarëve të strukturave të zbatimit të ligjit, ka vënë në pah nevojën për një qasje proaktive të policisë për shkëmbimin e plotë dhe analizimin e centralizuar të të dhënave dhe informacioneve përkatëse. Konstatimi se sulmet terroriste dhe ngjarje të tjera të rënda nuk mund të diktohen që në fazat e para përmes një policie që thjesht reagon ndaj asaj që ndodh bëri që PBI-ja të vihet në qendër të arenës ndërkombëtare të zbatimit të ligjit. Kjo u bë e dukshme pas sulmeve të 11 shtatorit dhe është reflektuar në konkluzionet e Komisionit të SHBA-së për ngjarjet e 11 shtatorit, i cili arriti në përfundimin se përpara këtyre sulmeve kishte pasur disa informacione që ruheshin në nivele të ndryshme, por për shkak të mosshkëmbimit të tyre nga agjencitë përkatëse, ato informacione nuk mundën të koordinoheshin në mënyrë të tillë që të ofronin një tablo të plotë.

Identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve përbën një pjesë të pandashme të policimit modern. Qasje e duhur dhe funksionale e PBI-së në mbledhjen dhe analizën e të dhënave dhe informacioneve krijon mundësi që të identifikohen dhe të vlerësohen rreziqet, përfshirë ngjarjet e rënda, zonat gjeografike, llojet e krimeve, pasojat sociale, kriminelët e rrezikshëm dhe rrjetet kriminale.





“Studimet tregojnë se ndonëse shtimi në përgjithësi i numrit të punonjësve të policisë mund të jetë zgjidhje efikase, është më me vlerë të shihet se si shpërndahen ata. Patrullimi i zakonshëm nuk përbën një taktikë efikase për të reduktuar krimin, por taktika më të përqendruara, të cilat nxirren nga një bazë të dhënash (një komponent thelbësor i modelit të policimit me bazë inteligjencën), mund të ofrojnë përfitime për reduktimin e krimit përtej sasisë së kohës që punonjësit e policisë shpenzojnë në një zonë të nxehtë të kriminalitetit.”

– **Ratcliffe (2016: 139).**

Modeli i PBI-së ka struktura të qarta organizative dhe drejtuese, përfshirë mekanizmat e vendimmarrjes dhe të ndarjes së detyrave në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, si edhe procedura të përcaktuara të bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet autoriteteve vendase të zbatimit të ligjit dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Menaxhimi i përmirësuar i të dhënave dhe informacioneve përbën një avantazh të rëndësishëm të modelit PBI për strukturat e zbatimit të ligjit në kohët e sotme. Në epokën moderne të qarkullimit të informacionit, modeli PBI ofron mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve përkatëse sipas objektivave dhe nën mbikëqyrjen e drejtuesve, në përputhje me politikën, strategjinë, objektivat dhe prioritetet e përcaktuara.



## 5. Aspektet ligjore, të drejtat e njeriut dhe mbrojtja e të dhënave

Respektimi i të drejtave të njeriut është i rëndësishëm për efikasitetin e policimit, përfshirë edhe PBI-në në periudha afatshkurtra dhe afatmesme. Veprimet e strukturave të zbatimit të ligjit që nuk respektojnë dhe nuk mbrojnë të drejtat e njeriut nuk janë produktive në planin afatgjatë, sepse ato cenojnë besimin e publikut tek policia dhe nuk janë efektive. Për shembull, ndërtimi i profileve mbi baza etnike<sup>10</sup> është diskriminues dhe është vërtetuar se mund të shmanget lehtësisht. Grupet kriminale mund t'i shpëtojnë zbulimit duke rekrutuar njerëz që nuk bëjnë pjesë në profilet e paracaktuara. Prandaj, si mjete më efektive policimi mund të përdoren edhe disa teknika të ligjshme të ndërtimit të profileve mbi bazën e provave specifike të aktiviteteve kriminale dhe mbi bazën e inteligjencës kriminale dhe jo mbi bazë supozimesh diskriminuese.

### PBI në kornizën e të drejtave të njeriut

Normat për të drejtat e njeriut janë përcaktuar në instrumentet ligjore dhe në standardet ndërkombëtare, si traktatet e detyrueshme si Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ)<sup>11</sup>. Për t'i zbatuar të drejtat e parashtruara në këto traktate, Shtetet duhet patjetër të miratojnë një kornizë ligjore dhe institucionale për konkretizimin e të drejtave të njeriut në legjislacionin e tyre të brendshëm. Brenda kësaj kornize, mbrojtja e individëve nga aktet që komprometojnë të drejtat e tyre të njeriut, përfshirë ato që rezultojnë nga krimi dhe terrorizmi dhe respektimi i këtyre të drejtave përbëjnë një nga detyrat kryesore të policisë. Në kuadër të parandalimit dhe luftës kundër krimit, policia duhet patjetër ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe standardet ndërkombëtare. Si një formë proaktive e policimit, PBI-ja duhet të mbështetet fort edhe te korniza e të drejtave të njeriut. Modeli i PBI-së duhet të rrisë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve dhe duhet të zbatohet në një mënyrë të tillë që të respektojë plotësisht të drejtat e njeriut dhe duhet të jetë në përputhje me parimet kryesore të policimit demokratik.<sup>12</sup>

### Parimet e përgjithshme të të drejtave të njeriut

Për t'u siguruar se PBI-ja bëhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe nuk ka ndikime negative ndaj gëzimit të të drejtave të njeriut, duhet patjetër të përmbushen disa

10 Ndërtimi i profileve mbi baza etnike në kuadër të policimit do të thotë ushtrim atributësh policore kundër individëve të caktuar mbi bazën e supozimeve dhe stereotipeve të pasakta dhe të papërkufizuara në lidhje me kombësi, etni se besime fetare të caktuara.

11 Të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, me përjashtim të Selisë së Shenjtë, e kanë ratifikuar ICCPR-në dhe si rrjedhim janë palë e këtij pakti. Përveç kësaj, 47 Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së janë gjithashtu anëtare të Këshillit të Evropës dhe si të tilla ato janë palë e KEDNJ. Shtetet Pjesëmarrëse të OSBE-së janë angazhuar që të plotësojnë detyrimet e tyre që rrjedhin nga traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në të cilat ato janë palë, në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar. Shiko Konferencën për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, Akti final (1975).

12 OSBE (2008b).

prej parimeve themelore në hartimin dhe zbatimin e modelit PBI në nivel kombëtar:

*Korniza ligjore, administrative dhe institucionale për zbatimin e PBI-së:* pikësepëri, PBI-ja duhet patjetër të mbështetet në dispozita të qarta dhe të sakta ligjore dhe administrative, që përcaktojnë kushtet sipas të cilave duhet të zbatohet modeli, të cilat sigurojnë marrjen e masave të përshtatshme mbrojtëse për të garantuar moskompromentimin e të drejtave të njeriut. Korniza e brendshme e PBI-së duhet patjetër të përfshijë ligje dhe rregullore që përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të saktë atributet, të cilat iu jepen institucioneve përkatëse dhe kërkesat që duhet të përmbushen për mbledhjen, përpunimin, analizën dhe shkëmbimin e llojeve të ndryshme të informacioneve. Të gjitha ligjet, rregulloret, politikat dhe praktiket e brendshme në lidhje me PBI-në duhet patjetër të jenë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me angazhimet e OSBE-së. Gjithashtu, punonjësit e strukturave të zbatimit të ligjit të përfshirë në PBI duhet patjetër të trajnohen si duhet për zbatimin e këtyre ligjeve dhe rregulloreve, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

*Ligjshmëria, domosdoshmëria dhe proporcionaliteti i kufizimeve të të drejtave të njeriut:* Ndonëse disa prej të drejtave të njeriut, si ndalimi i torturës dhe elementë të caktuar të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor, janë të drejta absolute dhe nuk mund të kufizohen në asnjë rrethanë, konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut e lejojnë vendosjen e disa kufizimeve mbi të drejta të caktuara, por vetëm brenda parametrave të përcaktuara në mënyrë strikte.<sup>13</sup> Si rrjedhim, kufizimet e vendosura në lidhje me PBI-në lejohen vetëm në qoftë se janë të parashikuara me ligj, nëse janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike në interes të një qëllimi të ligjshëm që përmendet specifikisht në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe nëse janë në raport të drejtë me arritjen e këtij qëllimi: d.m.th. si rregull respektohen të drejtat, ndërkohë që kufizimet duhet patjetër të mbeten përjashtime nga rregulli, kurse ndërhyrjet në të drejtat e njeriut duhet të përfaqësojnë gjithmonë mjetin më pak cenues për arritjen e një qëllimi të caktuar.

*Barazia dhe mosdiskriminimi: në përputhje me detyrimet e tyre ndërkombëtare për të drejtat e njeriut,* Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së angazhohen për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të çdo individi brenda juridiksionit të tyre, pa dallim race, ngjyre, gjinie, gjuhe, feje, bindjesh politike apo bindjesh të tjera, origjine kombëtare apo shoqërore, pasurie, lindjeje apo çdo statusi tjetër<sup>14</sup>. Mbrojtja e barazisë përpara ligjit dhe mosdiskriminimi përbëjnë detyrat themelore të policisë në një shoqëri demokratike<sup>15</sup>. Si rrjedhim, mbledhja, përpunimi dhe analiza e informacioneve duhet patjetër të bëhen duke mos u mbështetur në ndërtimin e profileve diskriminuese. Po kështu, sa i përket procesit të vendimmarrjes të bazuar tek inteligjenca, autoritetet duhet patjetër të tregohen vigjilente për të shmangur policimin e ekzagjeruar të komuniteteve të caktuara, gjë që mund të çojë në diskriminim. Vëmendje e veçantë u duhet kushtuar ndikimeve të ndryshme, që vendimet strategjike për policimin mund të kenë mbi femrat dhe meshkujt. Si rrjedhim, në të gjitha aktivitetet e PBI-së duhet ndjekur një qasje e ndjeshme ndaj gjinisë dhe duhet të rishikohen rregullisht ndikimet e vendimeve për të parë nëse ato çojnë në diskriminim të meshkujve, femrave apo komuniteteve të veçanta.

*Zgjidhje, mbikëqyrje dhe llogaridhënie efikase:* Standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut i njohin të drejtën çdo individi, të cilit i shkelen të drejtat apo liritë që të zhdëmtohet në mënyrë efikase dhe kërkesa për dëmshtëpërlblim t'i shqyrtohet nga një autoritet gjyqësor, administrativ ose legjislativ kompetent.<sup>16</sup> Duke qenë se PBI-ja mund të çojë në ndërhyrje në një gamë të gjerë të të drejtave të njeriut,

13 Të drejtat mund t'i nënshtrohen kufizimeve, përfshirë lirinë e lëvizjes, të drejtën për jetën private, lirinë e shprehjes, grumbullimit dhe shoqërimit dhe lirisë për të manifestuar fenë ose bindjet.

14 OSCE (1989), *Dokumenti përfundimtar i Takimit të Vjenës i 1986 i përfaqësuesve të Shteteve pjesëmarrëse të Konferencës mbi Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, takim që u zhvillua mbi bazën e dispozitave të Aktit Final në lidhje me veprimet në vijim të Konferencës*

15 OSCE (2008b).

16 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, "Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR)." Nr. 14668.

jtave të njeriut, është thelbësore që të merren masa efektive për të garantuar kompensimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut që mund të rezultojnë nga PBI-ja. Gjithashtu, duhet të ekzistojnë mekanizma të fortë të brendshëm dhe të jashtëm mbikëqyrjeje për të garantuar llogaridhënien e institucioneve dhe punonjësve të caktuar të strukturave të zbatimit të ligjit të përfshirë në PBI. Mekanizma të tillë mund të përfshijnë kontrollin dhe mbikëqyrjen e pushtetit ekzekutiv, komisionet parlamentare të mbikëqyrjes dhe mekanizma të pavarur të jashtëm për mbikëqyrjen dhe ankesat, të cilat u ofrojnë individëve mundësi kompensimi. Kontrolli nga ana e gjykatave mbi aktivitete të tilla si mbledhja e informacioneve në mënyrë të fshehtë është me rëndësi të veçantë për të ofruar masat e përshtatshme mbrojtëse kundër abuzimeve gjatë zbatimit të modelit PBI.

## E drejta për respektimin e jetës private

Mbledhja e të dhënave dhe informacioneve, por edhe përpunimi, analiza dhe shkëmbimi i tyre, të cilat janë të gjitha elementë përbërës të PBI-së, mund të kenë pasoja të rënda mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut, veçanërisht mbi respektimin e jetës private, por jo vetëm të saj.

Neni 17 i ICCPR-së parashikon që askush të mos jetë objekt i ndërhyrjeve arbitrare dhe të paligjshme në jetën e tij private, familjare, në banesë apo në korrespondencën e tij dhe çdokush duhet të ketë të drejtën e mbrojtjes me ligj nga ndërhyrje të tilla<sup>17</sup>. Në mënyrë që ndërhyrjet të mos jenë “arbitrare” ose “të paligjshme”, duhen përbushur disa kërkesa që janë të ngjashme me ato të përmendura më sipër: ato duhet të parashikohen me ligj, i cili nga ana e tij duhet të jetë patjetër në përputhje me dispozitat, qëllimet dhe objektivat e ICCPR-së si dhe patjetër duhet të jenë të arsyeshme në rrethana të veçanta<sup>18</sup>. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së e kanë rikonfirmuar të drejtën e mbrojtjes së jetës private dhe familjare, të banesës, korrespondencës dhe komunikimeve elektronike dhe të nevojës për të shmangur ndërhyrjet e papërshtatshme ose arbitrare nga autoritetet shtetërore në jetën e individit<sup>19</sup>.

Metoda të ndryshme të hapura dhe të fshehta për mbledhjen e informacionit paraqesin shkallë të ndryshme ndërhyrjesh në të drejtën e jetës private. Disa prej këtyre metodave, si përdorimi i teknikave speciale të hetimit dhe masa të tjera të fshehta të hetimit, përfshirë përgjimin në ambiente private ose në banesa, përgjimin e komunikimeve, përdorimin e agentëve nën mbulim dhe informatorëve, si dhe marrja e të dhënave nga llogaritë bankare dhe informacione të tjera konfidenciale janë shqyrtuar më në detaje në udhëzuesin e OSBE-së, ODIHR/DKN, *Të drejtat e njeriut në hetimet kundër terrorizmit*.<sup>20</sup> Kontrolli efikas nga ana e gjykatave ose nga autoritete të tjera të pavarura nëpërmjet autorizimeve paraprake, mbikëqyrjes ose rishikimit pas zbatimit të këtyre masave është me rëndësi shumë të madhe që këto masa të jenë të ligjshme. Gjithashtu, këto masa duhet të përdoren vetëm në rastet e krimeve të rënda dhe në një shkallë që është në proporcion me rëndësinë e çështjes që po hetohet.<sup>21</sup>

17 Një dispozitë e ngjashme për të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare gjendet edhe në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (KEDNJ) të Këshillit të Evropës, (4 nëntor 1950): Neni 8.

18 Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, komenti i përgjithshëm nr. 16: Neni 17 (E drejta për respektimin e jetës private), E Drejta për respektimin e jetës private, familjare, banesës dhe korrespondencës dhe mbrojtjen e nderit dhe reputacionit (8 prill 1988).

19 OSBE, Dokumenti i Konferencës së Moskës mbi Dimensionin Njerëzor të Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Evropë, Moskë, 3 tetor 1991).

20 OSBE, ODIHR/DKN (2013: 33-46). Mbi aspektet ligjore dhe teknike të përgjimeve elektronike shih edhe udhëzuesin e UNODC mbi “Praktikat aktuale të përgjimeve elektronike në hetimin e krimeve të rënda dhe krimin të organizuar” (2009).

21 OSBE, ODIHR/DKTN (2013).

Një çështje që ka tërhequr vëmendje të konsiderueshme janë pasojat e përgjimit në masë të komunikimeve mbi të drejtën e respektimit të jetës private. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka konkluduar në vendimin e saj se sistemet e përgjimeve bëjnë shkeljen e së drejtës për respektimin e jetës private, duke qenë se ato mundësojnë përgjimin e komunikimeve dhe të përmasës së madhe të të dhënave të pothuajse çdo individ në një vend, madje edhe të atyre personave që kanë qenë jashtë sferës origjinale të një operacioni dhe ku urdhrat për përdorimin e masave të tilla jepen krejtësisht brenda juridiksionit të ekzekutivit dhe pa një vlerësim strikt të domosdoshmërisë së zbatimit të tyre<sup>22</sup>. Në dallim nga përgjimi me një objekt të caktuar, i cili zakonisht mbështetet në dyshime paraprake dhe bëhet me autorizim paraprak nga gjykata ose nga ekzekutivi, programet e përgjimit në masë të gjerë nuk lejojnë vlerësime individuale rast-pas-rasti të proporcionalitetit, përpara se të zbatohen këto masa dhe si rrjedhim, të krijohet përshtypja se këto masa cenojnë vetë thelbin e së drejtës për respektimin e jetës private<sup>23</sup>.

### Mbrojtja e të dhënave

Mbrojtja e të dhënave është pjesë e rëndësishme e së drejtës për respektimin e jetës private dhe me një rëndësi të veçantë për PBI-në. Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, struktura që është ngarkuar me monitorimin e zbatimit të ICCPR-së, ka theksuar se mbledhja dhe ruajtja e të dhënave personale në kompjuterë, baza të dhënash dhe në pajisje të tjera duhet paqartë të rregullohet me ligj. Gjithashtu, janë marrë masa efektive për t'u siguruar që informacionet në lidhje me jetën private të një individ të mos vihen në dispozicion të personave që nuk janë të autorizuar me ligj për t'i marrë, përpunuar dhe përdorur ato<sup>24</sup>. Disa instrumente ndërkombëtare dhe rajonale përbajnë më shumë parime specifike për mbrojtjen e të dhënave sesa nevojiten me qëllim që të sigurojnë përputhshmëri të plotë me të drejtën për respektimin e jetës private.

Për shembull, Konventa e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, u kërkon palëve të Konventës që të garantojnë që të dhënat personale, të cilat i nënshtrohen përpunimit automatik:

- të sigurohen dhe të përpunohen pa paragjykime dhe në mënyrë të ligjshme;
- të ruhen për qëllime specifike dhe të ligjshme dhe të mos përdoren në një mënyrë që nuk është në përputhje me këto qëllime;
- të jenë të përshtatshme, të rëndësishme për hetimin, dhe të mos i tejkalojnë qëllimet për të cilat ruhen;
- të jenë të sakta dhe, atje ku është e nevojshme, të përditësohen;
- të ruhen në një formë që mundëson identifikimin e subjekteve të të dhënave jo më gjatë se sa kërkohet në qëllimin për të cilin ato ruhen.<sup>25</sup>

22 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Çështja e Szabo dhe Vissy kundër Hungarisë. Çështja Nr. 37138/14 (Strazburg: 12 janar 2016); dhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Çështja e Roman Zakharov kundër Rusisë, Nr. 47143/06 (Strazburg: 4 dhjetor 2015).

23 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. "Raportuesi special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë hetimeve kundër terrorizmit, Ben Emmerson." Raporti vjetor në Asamblesë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, 23 shtator 2014, A/69/397; paragrafi 52. Për më shumë informacion mbi përgjimet digjitale për qëllime të hetimit të terrorizmit, shiko materialin e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. "Raportuesi special mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë hetimeve kundër terrorizmit." Raport në Këshillin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 21 shkurt 2017, A/HRC/34/61: 10-13.

24 Komiteti i Kombeve të Bashkuara të të Drejtave të Njeriut (prill 1988).

25 Këshilli i Evropës. Konventa për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale, Seritë e Traktateve Evropiane, Nr. 108 (Strazburg: 28 janar 1981); Neni 5. Të 47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe si rrjedhim, shumica e Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së, janë palë të kësaj Konvente.

Gjithashtu, Konventa ndalon përpunimin automatik të të dhënave sensitive, si të dhënat që nxjerrin në pah origjinën racore, pikëpamjet politike, fetare ose bindje të tjera, si dhe të dhënat në lidhje me shëndetin, jetën seksuale ose dënimet penale, pa masat e duhura mbrojtëse në legjislacionin vendas<sup>26</sup>.

Ajo parashikon gjithashtu masa mbrojtëse dhe masa kompensuese që duhet të jenë të disponueshme për personat që janë objekt i të dhënave që ruhen<sup>27</sup>.

Konventa përcakton kufij të saktë për kufizimet e këtyre dispozitave, të cilët janë të ngjashëm me ato të përmendura më sipër. Çdo kufizim duhet patjetër të parashikohet me ligj dhe duhet patjetër të jetë i domosdoshëm në një shoqëri demokratike në interes të një qëllimi të ligjshëm të parashtruar në kushtetutë, si siguria kombëtare, siguria publike ose lufta ndaj krimi<sup>28</sup>. “Domosdoshmëria”, siç kuptohet në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përbën proporcionalitetin në raport me qëllimin e synuar.

Udhëzuesi i OSBE-së, ODIHR/DKN mbi “Të drejtat e njeriut në hetimet kundër terrorizmit” ofron një përmbledhje të praktikave më të mira ndërkombëtare që bazohen në parimet e mësipërme dhe në standarde të tjera ndërkombëtare në këtë fushë<sup>29</sup>. Këto duhet të shërbejnë si udhëzues për hartuesit e politikave dhe për punonjësit e strukturave të zbatimit të ligjit në hartimin dhe zbatimin e PBI-së, me qëllim që të sigurohet përputhshmëria me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

## Rreziqe të tjera të mundshme për të drejtat e njeriut në lidhje me Policimin me Bazë Inteligjencën

Të drejtat për respektimin e jetës private, përfshirë mbrojtjen e të dhënave, shërbejnë për ushtrimin e një gamë të gjerë të të drejtave dhe lirive themelore të tjera, ndër të tjera si: e drejta e lirisë së mendimit dhe e shprehjes; e drejta për të kërkuar, për të marrë dhe për të shkëmbyer informacione; liria e tubimit paqësor dhe e organizimit me të tjerë dhe liria e fesë ose besimit. Mirëpo mbledhja dhe përdorimi i informacioneve dhe inteligjencës mund të ndikojë drejtpërdrejt në gëzimin e të drejtave të tjera, si e drejta për një proces të rregullt, e drejta për lirinë dhe sigurinë e personit dhe ndalimin e torturës ose keqtrajtimeve të tjera.

Për shembull, përdorimi i taktikave për kontrollin e turmave që njihet me termin “shtyrja me forcë e protestuesve në një ambient nga ku nuk mund të dalin” gjatë kryerjes së detyrave policore gjatë protestave publike për mbledhjen e informacioneve, duke i detyruar protestuesit paqësorë dhe madje edhe spektatorët që të bëjnë të ditur emrat dhe adresat e tyre ndërsa dalin nga “ambienti i mbyllur” janë kritikuar për efektin frikësues që mund të kenë në ushtrimin e së drejtës së tubimit paqësor<sup>30</sup>. Një arrestim që është kryer mbi bazën e regjistrimit të personit në fjalë në një bazë të dhënash të strukturave të zbatimit të ligjit, që nuk ofron mbrojtje të përshtatshme ndaj ndërhyrjeve arbitrare në të drejtën për jetë private dhe që nuk bazohet në informacione të tjera që demonstrojnë

26 ibid. Neni 6.

27 ibid. Neni 8.

28 ibid. Neni 9.

29 OSBE, ODIHR/DKN (2013): 30-31. Instrumentet e tjera përkatëse përfshijnë, për shembull, Rezolutën 45/95 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi “Udhëzimet për rregullimin e dosjeve me të dhëna personale që ruhen në sisteme kompjuterike.” A/RES/45/95, 14 dhjetor 1990.

30 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. “Raportuesi special për të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe organizimit, Maina Kiai, Shtojcë, Misioni në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut.” Raporti në Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 17 qershor 2013, A/HRC/23/39/Add.1: paragrafi 38.

një dyshim të arsyeshëm se individi i arrestuar ka kryer ose ka qenë duke kryer një vepër të caktuar penale, është në kundërshtim me të drejtën për liri dhe siguri<sup>31</sup>.

Në lidhje me procesin e mbledhjes, përpunimit, analizës dhe shkëmbimit të informacioneve si pjesë e PBI-së, është me rëndësi të veçantë të theksohet se përdorimi i informacioneve të marra nëpërmjet torturave në proceset gjyqësore është absolutisht i ndaluar sipas legjislacionit ndërkombëtar. Pranimi i këtyre informacioneve si prova në gjykatë shkel të drejtat për masa mbrojtëse ligjore dhe për një proces të rregullt gjyqësor<sup>32</sup>. Por edhe në rastet kur nuk synohet që ato të përdoren në procese gjyqësore duhet të ndalohet mbledhja, shkëmbimi dhe marrja e informacioneve të siguruara nëpërmjet torturave<sup>33</sup>.

Këto shqetësime janë me rëndësi të veçantë në ato raste ku informacionet dhe intelijenca shkëmbehen mes dy vendeve. Përdorimi i informacioneve të siguruara nëpërmjet torturave nga një vend i tretë, edhe në qoftë se informacioni është siguruar për qëllime operationale, mund ta shndërron shtetin që merr informacionin në bashkëfajtor në kryerjen e një akti të paligjshëm në nivel ndërkombëtar<sup>34</sup>. Si rrjedhim, gjatë zbatimit të PBI-së duhet të ekzistojnë masa mbrojtëse të përshtatshme për t'u siguruar që informacionet dhe intelijenca e siguruar me mënyra të paligjshme brenda ose jashtë vendit, nuk përdoren në kundërshtim me legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar.

---

31 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Çështja e Shimovolos kundër Rusisë, Nr. 30194/09 (Strazburg: 21 qershor 2011).

32 Shih dokumentin e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. "Raportuesi special për torturën dhe trajtimet ose ndëshkimet e tjera çnjerëzore ose degraduese, Juan E. Méndez." Raporti në Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 10 prill 2014, A/HRC/25/60: paragrafi 21.

33 *ibid.*: paragrafi 73. Shih edhe OSBE dhe DKN/ODIHR (2013: 28).

34 *ibid.* Shih dokumentin e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. "Raportuesi special për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut gjatë hetimeve kundër terrorizmit, Martin Scheinin." Raporti në Komitetin e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 4 shkurt 2009, A/HRC/10/3: paragrafët 55-57; dhe OSBE, ODIHR/DKN (2013: 28-29).

## 6. Procesi i inteligjencës kriminale

Procesi i inteligjencës, i cili tradicionalisht njihet me termin cikli i inteligjencës, përshkruan gjashtë faza që njihen, gjerësisht përdoren për transformimin e të dhënave dhe inteligjencës në informacione me vlerë të shtuar, të cilat synohen të përdoren për veprime nga ana e policisë. Në rrethana ideale, procesi fillon me një vendim ose me caktimin e një detyre që pasohet nga faza e planifikimit, pas së cilës analistët angazhohen në mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve, të cilat duhet patjetër të vlerësohen në përputhje me një sistem vlerësimi të njohur zyrtarisht (shih faqen 35). Hapi tjetër është faza e përpunimit që fillon me grupimin dhe organizimin e të dhënave dhe informacioneve të disponueshme dhe me futjen e tyre në një bazë të dhënash. Më pas, të dhënat dhe informacionet analizohen dhe në përfundim të këtij procesi nxirret një produkt i inteligjencës, që u duhet shpërndarë klientëve (drejtuesve të strukturës, punonjësve të policisë të ngarkuar me hetimin përkatës ose punonjësve të tjerë që u kanë dhënë detyra analistëve ose kanë kërkuar mbështetjen e tyre) dhe palëve të tjera të interesuara. Produktet e inteligjencës vlerësohen nga klientët në bazë të nevojave dhe kërkesave të tyre. Komentet (informacionet kthyes) mbledhen përdoren për të përmirësuar produktet ekzistuese ose si të dhëna metodologjike për produkte të ngjashme në të ardhmen.

Cikli i inteligjencës nuk është një sekuençë e pandryshueshme prej gjashtë fazash. Përkundrazi, ai është një proces dinamik, ku fazat e ndryshme janë të lidhura ngushtë dhe furnizojnë me të dhëna dhe informacione njëra-tjetrën, duke ua bërë të nevojshme analistëve të kërkojnë informacione në drejtime të ndryshme brenda ciklit të inteligjencës. Cikli i paraqitur në Figurën 6.1, ofron një strukturë dhe një proces, që është i organizuar dhe i lehtë për t'u kuptuar, e cila mund të përdoret si një proces bazë për analizën strategjike dhe atë operacionale<sup>35</sup>.

35 Zyra e UNODC-së ka botuar disa udhëzues teknikë mbi inteligjencën kriminale dhe ciklin e inteligjencës për punonjësit e policisë që punojnë në terren, punonjësit që merren me mbledhjen e informacioneve, analistët dhe drejtuesit e strukturave të zbatimit të ligjit. Shih në adresën [www.unodc.org](http://www.unodc.org).






Figura 6.1 Procesi i inteligjencës kriminale

Cikli i inteligjencës fillon me caktimin e detyrave të qarta, me qëllim hartimin e produkteve konkrete të inteligjencës. Sidoqoftë, procesi i inteligjencës zhvillohet në nivele të ndryshme dhe shpesh nuk kufizohet me ciklin e inteligjencës. Krahas ciklit të paraqitur në Figurën 6.1, mund të dalë si nevojë edhe zhvillimi i një procesi më të gjerë dhe konstant vlerësimi i kërkesave për informacion nga pikëpamja strategjike. Ky vlerësim i vazhdueshëm identifikon kërcënimet ekzistuese dhe kërcënimet e reja, si dhe boshllëqet në informacion dhe kryhet në përputhje me prioritetet, politikat dhe objektivat strategjike. Ky proces kërkon një organizatë, që funksionon mirë dhe është e strukturuar, e cila mundëson mbledhjen e informacioneve dhe Procedurave Standarde të Punës (PSP), që bëjnë të mundur furnizimin e ciklit të inteligjencës me informacione dhe përcaktojnë rezultatin e pritsëm të ciklit dhe veprimet që do të kryhen më pas. Vlerësimi nga pikëpamja strategjike i kërkesave për informacione kriminale dhe cikli i inteligjencës kriminale furnizojnë procesin e planifikimit strategjik të një vendi, duke reflektuar prioritetet strategjike në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor. Ky proces shpjegohet më në detaje në kapitullin tjetër.

Nënkapitujt në vijim shpjegojnë komponentët kryesorë dhe qëllimin e secilës prej fazave të ciklit të inteligjencës.

## 6.1 Ndarja e detyrave dhe planifikimi

Cikli i inteligjencës fillon me një vendim nga ana e drejtuesve, të cilët u ngarkojnë detyra analistëve për të analizuar dhe për të nxjerrë informacione në lidhje me një problem apo çështje që po hetohet. Mbi bazën e këtyre detyrave, drejtuesit dhe analistët diskutojnë dhe bien dakord për Termat e Referencës (TeR), një dokument që përcakton fushën, objektivat kryesore, përmbajtjen dhe afatin e dorëzimit të produktit të inteligjencës. Termat e Referencës përbëjnë pikënisjen zyrtare të ciklit të inteligjencës.

Shpeshherë nënvlerësohet rëndësia e caktimit të detyrave të qarta dhe rënies dakord për objektivat e një produkti të inteligjencës. Me qëllim të caktimit të detyrave të qarta analistët, drejtuesit dhe vendimmarrësit e strukturave të zbatimit të ligjit duhet patjetër të kenë dijeni për mundësitë dhe kufizimet e analizimit të informacioneve. Po ashtu, analistët duhet të dinë se si t'i ndihmojnë

hetuesit, drejtuesit dhe vendimmarrësit (klientët), duke nxjerrë produkte sipas kërkesave të tyre dhe rekomandimeve për objektivat që synohen të arrihen. Faza e caktimit të detyrave, e cila njihet edhe si “faza e marrjes së vendimit”, kërkon bashkëpunim të ngushtë mes analistëve dhe klientëve. Ata duhet të bien dakord për çështjen e hetimit, objektivat, qëllimin, fushën, afatin kohor dhe formën e raportimit, përfshirë shpërndarjen dhe strukturën/individët që do të marrin produktin e inteligjencës. Analisti duhet ta ketë qartë se çfarë pret dhe çfarë qëllimesh ka klienti.

Është shumë e rëndësishme që detyra të tilla të trajtohen si projekte dhe fazat e tyre të ndryshme të planifikohen me kujdes. Projektet komplekse mund të kërkojnë shumë kohë dhe shumë burime. Sipas Termave të Referencës dhe fushës së projektit, analisti duhet të hartojë një plan të detajuar që përfshin objektivat, objektin dhe afatet për të cilat është rënë dakord, si dhe radhën e aktiviteteve dhe listën e burimeve që nevojiten për realizimin me sukses të detyrës. Kjo fazë është thelbësore sepse ajo shërben për të orientuar mbledhjen dhe më pas analizimin e informacioneve. Si rrjedhim, është e rëndësishme që plani i projektit të miratohet nga drejtuesit. Planin e projektit duhet të marrë në konsideratë edhe aspektet ligjore dhe çështjet e mbrojtjes së të dhënave, që mund të dalin gjatë zbatimit të tij. Veçanërisht nëse përfshihet përdorimi i të dhënave personale ose i metodave të fshehta për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve, atëherë në një fazë të hershme të procesit të planifikimit duhet të merren në konsideratë kërkesat ligjore dhe kufizimet e mundshme me qëllim që grumbullimi, shkëmbimi dhe përdorimi i të dhënave dhe informacioneve të kryhet në përputhje të plotë me legjislationin vendas dhe standardet ndërkombëtare.

Planifikimi i qartë kursen kohë në planin afatgjatë dhe lejon përdorimin në mënyrë efikase të burimeve, duke sjellë si rezultat produkte më cilësore<sup>36</sup>. Ai redukton edhe rrezikun e mosrespektimit të standardeve ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare gjatë mbledhjes, ruajtjes, shkëmbimit dhe përpunimit të të dhënave dhe informacioneve, gjë që do të rrezikonte suksesin e të gjithë projektit. Me një ndarje të duhur të detyrave dhe planifikim të qartë, produktet e analizës së informacionit mund të ndihmojnë në hartimin e planeve strategjike për trajtimin e problemeve aktuale dhe për përgatitje për problemet që parashikohen në të ardhmen<sup>37</sup>.

---

### Vlerësimi strategjik dhe kërkesat për informacione që lidhen me krime të caktuara

Kërkesat për informacione burojnë nga procesi i vlerësimit strategjik. Ky lloj vlerësimi u ofron drejtuesve të strukturave të zbatimit të ligjit një tablo përmbledhëse të problemeve të policimit me të cilat ndeshet ose mund të ndeshet institucioni. Ky dokument, i hartuar nga sektori/departamenti/agjencia e inteligjencës përfshin një gamë të gjerë problemesh dhe reflekton prioritetet strategjike në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Përgatitja e dokumentit përbën fazën e parë të procesit të planifikimit strategjik.

---

36 Shih më poshtë në nënkapitujt 6.2 dhe 8.1.

37 UNODC (2011b: 10-13).

Në këtë dokument duhet të trajtohen të gjitha kërcënimet ekzistuese dhe kërcënimet e reja, të identifikuar gjatë procesit të vlerësimit strategjik. Nuk duhet shpërfillur asnjë detaj i rëndësishëm. Më pas, dokumenti shqyrtohet në forume nivelesh strategjike, ku kërcënimet potenciale merren në konsideratë në kontekstin e burimeve ekzistuese. Prioritetet përshtaten me burimet e disponueshme. Numri i kërcënimeve që përmban strategjia e kontrollit varet nga mundësitë për trajtimin e tyre; në strategjitë e kontrollit vihen, për shembull, kërcënimet, të cilave u jepet prioriteti më i lartë nga forumet strategjike. Kjo përcakton agjendën në nivel operativ, e cila mbikëqyret nga drejtuesit e nivelit të mesëm, të cilët marrin përsipër secilin prej prioriteteve të identifikuar dhe angazhohen në hartimin e planeve për menaxhimin e atyre kërcënimeve.

Strategjia e kontrollit mund edhe të përfshijë një kombinim prioritetesh kombëtare, rajonale dhe lokale dhe, si rrjedhim, edhe fenomene që në pamje të jashtme nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin, si terrorizmi në nivel ndërkombëtar, grabitjet në rrugë dhe drejtimi i automjeteve nën ndikimin e alkoolit. Ajo duhet të mbetet e pandryshuar derisa të hartohet vlerësimi strategjik i radhës ose deri sa të identifikohen kërcënime më të mëdha dhe të informohet ekzekutivi. Ndërkohë, vlerësimet operative/taktike që prezantohen në takimet periodike të nivelit operativ/taktik, sigurojnë që këto prioritete të mbeten në qendër të vëmendjes së institucionit. Takimet e nivelit operativ/taktik rishikojnë planet operative të hartuara nga drejtuesit e nivelit të mesëm dhe sigurojnë një forum për diskutimin e kërcënimeve të reja. Kjo mundëson që drejtuesit e strukturave të caktuara të vazhdojnë të përqendrohen tek kërcënimet e identifikuar nga drejtuesit e tyre si kërcënime ndaj të cilave duhet ndërhyrë.

Nuk duhet të injorohen kërcënimet e tjera të identifikuar në vlerësimin strategjik edhe në qoftë se nuk ka burime të mjaftueshme për t'i trajtuar në mënyrë të menjëhershme; ato i shtohen strategjisë së kontrollit për të përcaktuar nevojën për informacion. Përcaktimi i prioriteteve të punës në përputhje me strategjinë e kontrollit është përgjegjësi e të gjithë punonjësve të zbatimit të ligjit në një institucion. Detyrë e sekretariatit ose e departamentit të inteligjencës është që t'i rishikojnë kërkesat për informacion, duke vlerësuar nëse kërcënime të identifikuar më parë meritojnë vëmendje më të madhe (ndoshta si ndryshime ose shtojca të një strategjie të re kontrolli) dhe të kontrollojnë në mënyrë të vazhdueshme nëse ka kërcënime të reja.

---

## 6.2 Mbledhja dhe vlerësimi i informacioneve

Mbledhja e informacioneve për qëllime përpunimi është proces i vështirë. Ndonëse nga njëra anë, analistët duhet të sigurojnë mbledhjen e të dhënave të mjaftueshme për mbulimin e të gjitha aspekteve të temave që do të analizohen, ata duhet të shmangin mbingarkesat dhe mbledhjen e informacioneve të panevojshme apo të pamjaftueshme. Ajo që ka rëndësi kyçe në këtë fazë është njohja nga ana e punonjësve që merren me mbledhjen e këtyre informacioneve lidhur me ekzistimin, rëndësinë, qasjen dhe besueshmërinë e të gjitha burimeve të informacionit dhe agjencive që përzgjidhen për një detyrë të veçantë mbledhjeje informacioni, si dhe njohja prej tyre e të gjitha kufizimeve ligjore dhe nevojës për të kërkuar autorizimet që nevojiten për të përdorur lloje të ndryshme të burimeve të informacionit. Njohja e burimeve të brendshme dhe të jashtme të informacionit dhe mundësia për marrjen e tij, si dhe informimi rreth kufizimeve dhe nevojave për marrje autorizimi që mund të ekzistojnë janë parakushte për mbledhjen dhe analizimin me efikasitet të informacioneve.

Shembuj të burimeve të të dhënave dhe informacioneve që përdoren nga analistët e informacioneve kriminale:

### **Burimet zyrtare:**

- Ministrinë, agjencitë shtetërore, prokuroritë
- Bazat e të dhënave të organeve të zbatimit të ligjit
- Organizatat ndërkombëtare
- Njësitë e inteligjencës financiare
- Specialistët e policisë që mbulojnë zona të caktuara
- Të dhënat nga kontrolli kufitar
- Të dhënat/informacionet publike
- Efektivët e patrullimit
- Hetimi
- Mbikëqyrja
- Informatorët

### **Burimet jozyrtare:**

- Organizatat joqeveritare
- Industria e transportit
- Raportet anonime
- Sektori tregtar
- Sektori financiar
- Shoqëria civile
- Mediat sociale
- Komuniteti
- Bota akademike
- Mediat

## Plani i mbledhjes së informacioneve

Hartimi i një plani për mbledhje informacionesh është hapi tjetër që vjen pas miratimit të Termave të Referencës dhe planit të një projekti të caktuar, siç përshkruhet më sipër. Të pasurit e një plani për mbledhjen e informacioneve është i domosdoshëm për të garantuar mbledhjes siç duhet dhe të saktë të të dhënave dhe informacioneve që nevojiten për përmbushjen e detyrave të ngarkuara. Ky duhet parë si një proces i vazhdueshëm që mund të përshtatet sipas ndryshimeve që mund të pësojë detyra gjatë rrugës. Plani i mbledhjes së të dhënave dhe informacioneve mbështetet tek përcaktimi i objektivave dhe afateve kohore të detyrave të ngarkuara dhe përshkruan: çfarë informacioni duhet mbledhur apo ekziston, duke përfshirë edhe qëllimin dhe vlerën e të dhënave të mbledhura; cilat burime duhen përdorur; ku mund të merret informacioni; si mund të merret informacioni dhe kush duhet ta marrë; sa të dhëna mund të përpunohen; dhe se kur duhet mbledhur çdo informacion. Në disa raste, ky plan mund të duhet të përfshijë edhe arsyet se pse duhen mbledhur informacione të caktuara. Ashtu si edhe plani i përgjithshëm, plani i mbledhjes së informacioneve duhet të marrë parasysh kërkesat e ndryshme ligjore që lindin gjatë procesit të mbledhjes së informacionit në varësi të llojeve të informacioneve që mblidhen, si dhe burimeve dhe mjeteve që përdoren për marrjen e tyre<sup>38</sup>.

Hartimi i një plani të hollësishëm për mbledhjen e informacionit, i cili përfshin edhe një vlerësim nevojash, autorizimet/lejet e nevojshme dhe kriteret që duhet të respektohen për mbikëqyrjen e procesit, është i domosdoshëm për suksesin e projektit. Prandaj, duhen marrë masat që të gjitha palët e përfshira në të të bien dakord me objektivat e vendosura dhe me standardet që duhet të respektohen.

38 OSCE, ODIHR/TNTD (2013: 34).

## Vlerësimi

Njëkohësisht me mbledhjen e informacionit ose direkt pas këtij procesi, të dhënat duhet të vlerësohen në kontekstin në të cilin ato kërkohen.<sup>39</sup> Vlerësimi i të dhënave duhet të mbështetet në një gjykim profesional dhe objektiv, duke qenë se cilësia e të dhënave përcakton nëse informacionet e mbledhura do të jenë apo jo të vlefshme.

Në vlerësim merren parasysh sa i vlefshëm dhe sa i besueshëm është informacioni, si dhe sa i dobishëm është ai për një detyrë të ngarkuar. Një hap i parë që merret zakonisht është identifikimi i asaj çka është e rëndësishme dhe që ka lidhje me detyrën e ngarkuar, si dhe vlerësimi se sa urgjente është ndërhyrja që duhet ndërmarrë bazuar në atë informacion. Besueshmëria e burimit, si dhe vlefshmëria dhe saktësia e informacionit duhet të vlerësohen veç nga njëra-tjetra nga analisti që e ka marrë dhe e ka regjistruar informacionin.<sup>40</sup>

Të gjitha burimet dhe të gjitha informacionet duhet të vlerësohen sipas një sistemi vlerësimi të njohur zyrtarisht. Sistemet 4x4 ose 5x5x5 janë dy sistemet më të përdorura.<sup>41</sup>

Tabela 6.1 Kodet e vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit 4x4

VLERËSIMI I BURIMIT		VLERËSIMI I INFORMACIONIT	
A	Plotësisht i besueshëm në çdo rast	1	Nuk vihet në diskutim saktësia
B	Zakonisht i besueshëm	2	Informacion që dihet personalisht nga burimi por jo nga zyrtari që e ka dhënë
C	Zakonisht jo i besueshëm	3	Informacion që nuk njihet personalisht nga burimi, por konfirmohet nga informacione të tjera të disponueshme
D	Nuk mund të vlerësohet nëse është i besueshëm apo jo	4	Saktësia nuk mund të vlerësohet apo konfirmohet në asnjë mënyrë (për momentin)

Tabela 6.2 Kodet e vlerësimit sipas sistemit të vlerësimit 5x5x5

VLERËSIMI I BURIMIT		VLERËSIMI I INFORMACIONIT	
A	Gjithmonë i besueshëm	1	Dihet se është i vërtetë pa asnjë rezervë
B	Përgjithësisht i besueshëm	2	Informacion që njihet personalisht nga burimi, por jo nga personi që e ka raportuar
C	Ndonjëherë i besueshëm	3	Informacion që nuk njihet personalisht nga burimi, por që konfirmohet
D	I pabesueshëm	4	Nuk mund të gjykohej
E	Burim i paprovuar	5	Dyshohet se është i pavërtetë

Shënim: Sistemi 5x5x5 përfshin edhe "Përpunimin e Kodeve", gjë që nuk shpjegohet këtu.

39 Agjencia Kombëtare e Përmirësimit të Policimit, Këshilla Praktike mbi Analizimin (Shoqata e Oficerëve Drejtues të Policisë, 2008).

40 UNODC (2011b: 25-28).

41 ibid. Shih edhe informacionin në lidhje me sistemet e vlerësimit 6x6. Sistemi 5x5x5 përfshin "Përdorimin e Kodeve", të cilët nuk shpjegohen këtu.

Vlerësimi i informacioneve nga këndvështrimi i rëndësisë që kanë për detyrën e ngarkuar, besueshmërisë dhe saktësisë, si dhe vendosja e një kodi çdo informacioni për përdorimin e tij të mëtejshëm është i domosdoshëm për saktësinë e produkteve përfundimtare të informacioneve dhe për mënyrën e shpërndarjes së tyre. Por vlerësimi është i rëndësishëm edhe nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Siç përkshkruhet në Kapitullin 5, standardet e mbrojtjes së të dhënave kërkojnë, ndër të tjera, që informacionet e regjistruara personale të jenë të sakta, të mjaftueshme, të kenë lidhje me detyrën dhe të mos jenë të ekzagjeruara në raport me qëllimin për të cilin ruhen. Prandaj, vlerësimi është shumë i rëndësishëm për të demonstruar se regjistrimi i informacioneve që përbëjnë shkelje të së drejtës për jetë private të subjekteve të të dhënave/informacioneve, është i justifikuar, i nevojshëm dhe proporcional dhe, si i tillë, i lejueshëm dhe në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së të dhënave.

Vlerësuesit duhet të jenë të ndërgjegjshëm edhe për disa çështje të tjera të të drejtave të njeriut që mund të jenë relevante sa i përket mënyrës së përdorimit të informacioneve të mbledhura. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sidomos kur vlerësohen informacione nga vende të treta për të parë nëse ka arsye për të besuar se informacioni mund të jetë marrë në rrugë të paligjshme. Kështu për shembull, përdorimi i provave të marra përmes torturave apo keqtrajtimit të tjera është kategorikisht i ndaluar sipas së drejtës ndërkombëtare në procese gjyqësore. Por edhe kur informacionet e marra në këto mënyra nuk synohet të përdoren në procese gjyqësore, ato duhet të shpërfillen<sup>42</sup>.

### 6.3 Bashkimi dhe përpunimi i informacioneve

Faza e bashkimit dhe përpunimit të informacioneve kërkon një sistem të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm. Kjo fazë përfshin përzgjedhjen, priorizimin dhe vendosjen e referencave informacioneve të mbledhura. Gjatë fazës së bashkimit të informacioneve, analisti e organizon dhe e strukturon informacionin e mbledhur, duke e konvertuar atë në një format të indeksuar dhe me referenca të krahasueshme dhe e transferon atë në një sistem ruajtjeje (p.sh. në një bazë të dhënash). Verifikimi i rëndësisë, saktësisë dhe dobisë së informacioneve është një hap i rëndësishëm që duhet marrë para futjes së tij në sistem. Është shumë e rëndësishme që të ketë një sistem të aksesueshëm, prej nga informacioni mund të nxirret sërish e të analizohet.

Përpunimi i informacioneve mund të jetë shumë i lidhur me fazën analitike, duke e bërë të vështirë ndarjen e këtyre proceseve<sup>43</sup>.

### 6.4 Analiza

Ashtu si me llojet e ndryshme të informacioneve sekrete, mënyrat se si mund të klasifikohen analizat janë të ndryshme. Ajo çka në një organizatë quhet analizë operationale, quhet analizë taktike në një tjetër, ndërkohë që analiza e rrjetit në një departament policie quhet analizë lidhjesh në një vend fqinjë. Klasifikimet më të zakonshme të analizave janë analiza strategjike, analiza operationale dhe analiza taktike. Ky udhëzues e grupon analizën taktike dhe atë operationale së bashku nën analizën operationale<sup>44</sup>.

42 OSCE TNTD/ODIHR (2013: 28).

43 Agjencia Kombëtare e Përmirësimit të Policimit (2008).

44 UNODC, INTERPOL dhe Europol përdorin po këtë klasifikim. Shih UNODC (2011b: 35-38).

**Analiza strategjike** mbështet vendimmarrjen, politikëbërjen, planifikimin dhe priorizimin; shpërndarjen e burimeve të policisë; përcakton metodat e përshtatshme të adresimit të llojeve të ndryshme të krimeve. Ajo u ofron gjithashtu edhe mbështetje me bazë inteligjencën organeve të vijës së parë të zbatimit të ligjit duke lehtësuar identifikimin e kërcënimeve, dobësive, risqeve dhe mundësive kryesore (vlerësimet e kërcënimeve dhe rreziqeve). Analizat strategjike nuk merren me informacione personale.

**Analiza operacionale** ndihmon në menaxhimin dhe në zbatimin në vijë të parë të detyrave afatshkurtra për arritjen e objektivave operacionale dhe mbështet hetimet që janë në proces. Analizat operacionale mund të përfshijnë edhe informacione personale për të dyshuarit.

Procesi i analizimit nevojitet për transformimin e të dhënave dhe informacioneve bruto në inteligjencë dhe për të orientuar qëllimet afatshkurtra operacionale dhe qëllimet afatgjata strategjike në zbatim të ligjit. Besueshmëria dhe objekti i analizës varen shumë nga njëra anë nga cilësia dhe saktësia e të dhënave të mbledhura dhe nga aftësitë e analistëve nga ana tjetër. Gjatë gjithë analizimit të informacioneve, si dhe në fazat e tjera të ciklit të modelit të inteligjencës, bashkëpunimi i ngushtë midis analistëve dhe klientëve (oficerëve, hetuesve dhe drejtuesve), duke përfshirë edhe organizimin e takimeve sistematike, është vendimtar për garantimin e një informacioni që plotëson nevojat për informacion në lidhje me krime të caktuara dhe kërkesat e klientëve.

Faza e analizimit është shumë e rëndësishme për procesin e inteligjencës, sepse ka të bëjë me identifikimin dhe ekzaminimin e kuptimit, kontekstit dhe karakteristikave thelbësore të informacioneve të disponueshme. Analizimi i të dhënave nxjerr në pah boshllëqet në informacione, dobësitë apo pikat e forta të të dhënave dhe përcakton rrugët që duhet ndjekur. Qëllimi kryesor i fazës së analizimit është që të nxjerrë kuptimin e informacioneve fillestare me qëllim shfrytëzimin e inteligjencës në praktikë. Kur rezultatet e analizës së informacioneve kriminale janë direkt të lidhura me objektin e hetimit apo i japin përgjigje atij, analiza bëhet e vlefshme si mjet operacional.

Procesi i analizimit përbëhet nga dy faza: integrimi i të dhënave dhe interpretimi i të dhënave. Faza e parë (integrimi i të dhënave) kombinon informacionet e vlerësuara dhe të bashkuara nga burime të ndryshme me qëllim ngritjen e hipotezave dhe parashikimeve fillestare, identifikon modelin sipas të cilit ka funksionuar inteligjenca dhe nxjerr përfundime. Faza e dytë (interpretimi i të dhënave) përfshin shkuarjen përtej të dhënave të disponueshme dhe interpretimin e tyre. Në këtë fazë testohen hipotezat e ngritura, duke çuar në mbështetje, modifikimin apo hedhjen poshtë të tyre.

Hipotezat përbëjnë teori pune në formë tentative që bazohen në tregues të përcaktuar më parë dhe në premisa të nxjerra nga të dhënat dhe informacionet e disponueshme dhe që kërkojnë informacione shtesë për të konfirmuar ose për të kundërshtuar prezumimet e mëparshme. Hipotezat ndihmojnë për të identifikuar boshllëqet në inteligjencë, për të fokusuar më shumë mbledhjen e të dhënave në vazhdim dhe për të arritur interpretime, përfundime, parashikime dhe vlerësime të sakta.

Ngritja dhe testimi i hipotezave është rritur për nga rëndësia që i jepet analizimit të inteligjencës. Hipotezat përbajnë shumë spekulime dhe duhet, për këtë arsye, të testohen (të konfirmohen, të modifikohen ose të hidhen poshtë) nga analistët. Testimi i hipotezave duhet të përfshijë: argumentet pro dhe kundër hipotezave, implikimet e tyre, shqyrtimin e procesit të të menduarit dhe mbledhjen dhe shqyrtimin e të dhënave të nevojshme. Çdo hipotezë apo interpretim duhet të përmbajë përgjigjet e këtyre pyetjeve:

Kush?	Individi/individët kryesorë
Çfarë?	Aktivitetet kriminale
Si?	Metodat e përdorura
Ku?	Informacioni gjeografik dhe objekti
Pse?	Motivi
Kur?	Periudha kohore

Përdorimi i hipotezave për të testuar dhe për të eksploruar një fenomen kriminal apo një shqetësim në lidhje me sigurinë përbën një hap të rëndësishëm në të menduarin strategjik, duke kaluar nga situata “më trego gjithçka që di” në një proces specifik dhe të orientuar drejt veprimit. Kjo teknikë dhe teknika të tjera që prezantohen në këtë kapitull theksojnë se trajnimi, niveli i aftësive dhe përvoja si e vendimmarrësve, ashtu edhe e analistëve, janë jetësore për një model të suksesshëm policimi të bazuar tek inteligjenca.

---

### Shembuj të metodave analitike

Modeli Kombëtar i Inteligjencës (National Intelligence Model) i Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet (UNODC) rrjedh nga nëntë teknika dhe produkte analitike që konfirmojnë vendimmarrjen e informuar strategjike dhe/ose operative dhe zhvillimin e njohurive profesionale lidhur me teknikat proaktive efikase të zbatimit të ligjit:

- **Analizimi i modelit kriminal** është një term i gjerë që përfshin një sërë analizash, duke përfshirë identifikimin e tendencave dhe analizimin e pikave të nxehta.
- **Analizimi i tendencave demografike/sociale** vlerëson ndikimin që kanë ndryshimet social-ekonomike dhe demografike, si dhe ndryshimet e popullsisë dhe mungesa e strehimit tek kriminaliteti.
- **Analizimi i rrjeteve** vlerëson drejtimin, shpeshhtësinë dhe forcën e lidhjeve midis bashkëpunëtorëve në rrjete kriminale.
- **Analizimi i profileve** të tregut vlerëson tregun kriminal për një mall të caktuar, si droga apo prostitucioni.
- **Profili i bizneseve kriminale** përcakton modelet dhe teknikat e biznesit që përdorin kriminelët dhe grupet e organizuara kriminale.
- **Analiza e riskut** vlerëson shkallën e rreziqeve apo kërcënimeve që përbëjnë kriminelët apo organizatat ndaj viktimave të mundshme, ndaj policisë dhe ndaj publikut.
- **Analizimi i profilit të cakut** përshkruan pikat e forta dhe të dobëta të kriminelëve, mënyrat e tyre të jetesës, rrjetet, aktivitetet kriminale dhe pikat që mendohet se mund të ndërhyjnë në jetën e një kriminelit të piketuar.
- **Vlerësimi i inteligjencës operative** sheh nëse mbledhja e informacioneve ka ndjekur objektivat për të cilat është rënë më parë dakord dhe identifikon boshllëqet në



përpjekjet e organizatës për inteligjencë (përdoret në projekte dhe operacione të mëdha).

- **Analizimi i rezultateve** vlerëson efikasitetin e aktiviteteve të zbatimit të ligjit dhe monitoron ecurinë e planeve.

*Burimi: Bazuar në UNODC (2011b: 35-38)*

Përveç metodave të sipërpërmendura të analizimit, analistët përdorin një sërë teknikash të tjera analizimi cilësor,<sup>45</sup> të cilat kanë një qëllim të përbashkët: ato janë mjete për t'i zbrërthyer problemet komplekse në pjesë më të menaxhueshme analitike.

## 6.5 Raportimi dhe shpërndarja e produkteve të inteligjencës

Produktet e inteligjencës janë rezultat i një procesi të tërë dhe shpërndahen përgjithësisht në formën e raporteve koncize dhe të strukturuarra qartë. Raportet e analizimit të inteligjencës kanë për qëllim reflektimin mbi objektivin dhe informacionet e sakta, si dhe identifikimin dhe rekomandimin e ndërhyrjeve strategjike dhe operative efikase. Për të siguruar vlerën praktike të produkteve të inteligjencës, ato duhet të jenë gjithmonë të qarta dhe koncize. Siç u theksua më sipër, bashkëpunimi i ngushtë mes analistëve dhe klientëve, ku përfshihet edhe organizimi i mbledhjeve periodike, është i pashmangshëm për ofrimin e produkteve të inteligjencës që i shërbejnë një qëllimi të caktuar dhe për prezantimin e gjetjeve të tij. Një qasje e mirë e përgjithshme në krijimin e çfarëdoq produkti inteligjence është krijimi i piramidës së përmbytur, që fillon me adresimin e mesazheve më të rëndësishme për klientin, duke kaluar më pas në çështje më të përgjithshme.

Në varësi të nevojave të klientit, këto produkte mund të ndahen në produkte inteligjence strategjike dhe operative.

Qëllimi i **raporteve të analizave operative** është mbështetja e hetimeve që janë në proces dhe detryave afatshkurtra operative dhe taktike. Duke pasur si synim zbatuesit në terren, këto produkte duhet të jenë koncize, të formuluar në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë dhe të fokusohen tek informacionet me vlerë të shtuar operative. Gjetjet kryesore duhet të vendosen që në fillim, duke i dhënë mundësi lexuesit të thithë informacionin kryesor dhe të vendosë se si të bëjë priorizimin e informacionit të marrë. Produktet e inteligjencës pastaj duhet të hyjnë në më shumë detaje, duke filluar me përshkrime të shkurtra të situatës operative, pasuar nga qëllimet dhe objektivat e tyre. Thelbi i produkteve të inteligjencës duhet të japë informacione të detajuara për rastin, të shpjegojë procesin e analizimit që çon në hipoteza dhe të sqarojë gjetjet. Raporti duhet të mbyllet me identifikimin e nevojave për inteligjencë dhe me rekomandime për masat që duhen marrë. Produktet e inteligjencës operative janë burim i rëndësishëm informacioni për produkte strategjike.

45 Për përshkrimin dhe shembuj të këtyre teknikave, shihni UNODC (2011a). Shihni edhe faqen e Policimit të Orientuar drejt Zgjidhjes së Problemeve: [www.popcenter.org/about/?p=whatiscpop](http://www.popcenter.org/about/?p=whatiscpop). Përveç kësaj, informacione dhe orientime mbi një sërë analizash jepen edhe në faqen e Shoqatës Ndërkombëtare të Analistëve të Informacioneve Sekrete për Zbatimin e Ligjit: [www.iaiea.org](http://www.iaiea.org)

Qëllimi i **raporteve të analizave strategjike** është që të mbështesin një proces vendimmarrjeje mirë të informuar dhe planifikimin e operacioneve. Në varësi të nevojave dhe objektivave, mund të përgatiten lloje të ndryshme dokumentesh:<sup>46</sup>

*Paralajmërimet që në faza të hershme/paralajmërimet e inteligjencës* vënë në dukje ndryshimet e reja apo të kohëve të fundit, tendencat dhe zhvillimet në terren, të cilat mund të jenë tematike ose gjeografike. Qëllimi kryesor është përshkrimi i ndryshimeve dhe vlerësimi i pasojave që mund të ketë një situatë e caktuar sigurie në tregjet kriminale, në komunitet dhe në një zonë më të madhe gjeografike. Këto paralajmërimet janë të shkurtra dhe specifike, kanë për qëllim të informojnë në mënyrë të shpejtë dhe proaktive klientin për ndryshime a tendenca të reja dhe të japin indikacione të përmbledhura për pasojat që mund të sjellin këto ndryshime apo tendenca.

*Vlerësimet e kërcënimeve* analizojnë dhe vlerësojnë kërcënimet që paraqesin fenomenet kriminale. Ato mund të fokusohen në grupe të organizuara kriminale ose në zona apo rajone kriminale specifike. Vlerësimet kanë zakonisht si objekt periudha të shkurtra ose mesatare, por mund të bëhen edhe si parashikime për të ardhmen. Ato u japin vendimmarrësve inteligjencë strategjike dhe rekomandime.

*Raportet e vlerësimit të riskut* përshkruajnë vlerësimin e rreziqeve potenciale, ku vlerësimet të kërcënimeve i shtohet edhe vlerësimi i probabilitetit, ndikimit dhe dobësive të rreziqeve. Një shembull klasik është raporti i vlerësimit të riskut paraqitur në kuadrin e përgatitjeve për një aktivitet madhor.

*Raportet e situatave* kanë më shumë natyrë përshkruuese. Ato kanë për qëllim të japin një përmbledhje të detajuar të një teme të caktuar. Ndryshe nga vlerësimet e kërcënimeve, ato përgjithësisht nuk përmbajnë rekomandime për marrje masash dhe kufizohen tek gjetjet faktike. Këto raporte mund të fokusohen në një sërë çështjesh, që nga një zonë specifike krimi ose mënyrat e operimit, deri tek grupe kriminale apo zona të caktuara gjeografike.

Hapi i fundit në procesin e inteligjencës është shpërndarja e produkteve të inteligjencës dhe informimi i klientëve rreth përmbajtjes së tyre. Konsumatorët e analizave të informacioneve sekrete mund të jenë hetues, prokurorë, drejtues të organeve të zbatimit të ligjit dhe agjenci të tjera qeveritare ose policore. Aty ku është e mundur dhe e përshtatshme, produktet e inteligjencës duhet të bëhen të ditura për publikun. Nga kjo mund të përfitojnë organet e zbatimit të ligjit duke rritur ndërgjegjësimin e publikut për çështje specifike (si pjesë e parandalimit të krimit), duke rritur transparencën dhe vizibilitetin, dhe duke mbledhur informacione të vlefshme nga publiku në përgjigje të raporteve të publikuara. Është e rëndësishme të zgjidhet metoda/formati i duhur për shpërndarjen dhe prezantimin e produkteve të inteligjencës para audiencave të synuara dhe të merren masat që ky informacion të mbërrijë në kohën e duhur për të mbështetur vendimet dhe hapat e tyre<sup>47</sup>. Faza e shpërndarjes së produkteve të inteligjencës është shumë e rëndësishme për të gjithë strukturën e modelit PBI, duke qenë se në këtë fazë informohet si klienti, ashtu edhe organet e duhura të policisë rreth aktiviteteve, fenomeneve kriminale dhe autorëve të tyre. Për shkak të natyrës delikate që ka informacioni që prezantohet zakonisht në produktet e inteligjencës, duhet të miratohet një rregullorë e qartë dhe transparente, e bazuar në parimet bazë të “së drejtës për t’u informuar” dhe “nevojës

46 Në Tabelën e tij të Analizës së Inteligjencës Kriminale, INTERPOL-i i klasifikon produktet analitike në raporte analitike, vlerësime kërcënimesh për rajone ose krime të caktuara, vlerësime risku për ngjarje të caktuara dhe publikime me temë inteligjencën (buletine, raporte mujore, etj.). Europol-i i klasifikon raportet analitike së pari në raporte operative dhe strategjike, por i ndan raportet strategjike në vlerësime kërcënimesh, raporte në nivel situatash dhe paralajmërimet të bazuara në informacione kriminale sekrete (inteligjencë).


47 Për informacione praktike mbi prezantime të ndryshme, shihni UNODC (2011a).

për t'u informuar” sipas standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së të dhënave.

Në udhëzuesit ose doracakët vendas për këto fusha duhet të jepen edhe detaje të tjera mbi shpërndarjen e produkteve të inteligjencës në përputhje me udhëzimet kombëtare dhe kërkesat ligjore, si dhe në respektim të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

### 6.6 Vlerësimi i procesit dhe masat në vijim

Rëndësia e bashkëpunimit aktiv midis klientit/vendimmarrësit dhe analistit theksohet vazhdimisht në këtë udhëzues. Kjo vlen edhe për vlerësimin e produkteve të inteligjencës dhe komenteve e vërejtjeve të klientëve, vendimmarrësve apo përdoruesve të tjerë të produkteve analitike. Analistët dhe drejtuesit e tyre duhet ta dinë nëse një produkt i përmbush nevojat dhe nëse rekomandimet e dhëna kontribuojnë në vendimet apo masat që do të merren. Analistët duhet të marrin *feedback* edhe për përmirësimet që mund t'i bëjnë produktit. Të dërguarit e një formulari *feedback-u* (vlerësimi) klientit menjëherë pasi i dërgohet raporti i analizës dhe pasi i prezantohet produkti i inteligjencës është praktikë shumë e vlefshme. Duhet të organizohet edhe një takim pasues ku do të diskutohen produkti i inteligjencës, *feedback-u*, bashkëpunimi dhe vendimet e marra si rrjedhojë e tij, si dhe masat apo operacionet e ndërmarra. Realizimi i të gjitha këtyre proceseve jo vetëm që rrit cilësinë e detyrës në fjalë, por nevojitet edhe në funksion të zhvillimit profesional.





## 7. Implementimi i PBI-së

Ky kapitull bën një prezantim grafik të modelit të PBI-së të rekomanduar nga OSBE-ja dhe shpjegon elementët e tij kryesorë, pasuar nga një shqyrtim i vëmendshëm i kërkesave kyçe për zbatimin e këtij modeli. Është tunduese ta prezantosh PBI-në në formën e një matrice apo në forma të tjera, madje as nuk ekziston dhe as nuk duhet të ekzistojë një format universal, pasi rrethanat lokale dhe kombëtare ndryshojnë ndjeshëm nga njëri vend në tjetrin. Çdo vend duhet të vlerësojë gjendjen e vet dhe të hartojë një plan zbatimi, duke u nisur nga korniza e tij ligjore, kultura, nevojat dhe faktorë të tjerë bazë kombëtarë/lokalë dhe t'ia përshtatë atë kërkesave të tij kryesore. Megjithatë, bazuar në disa parime përgjithësisht të pranuar, OSBE-ja ka hartuar një model për zbatimin në praktikë të PBI-së, të cilin Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së ftohen ta shfrytëzojnë kur përshtatin ose zbatojnë PBI-në.

Ndonëse rrethanat kombëtare ndryshojnë nga një vend në tjetrin, studimet tregojnë se suksesi i politikave, strategjive dhe zbatimit në nivel kombëtar të PBI-së varet përgjithësisht nga këta faktorë kryesorë:

- të pasurit e një kornize të qartë ligjore për PBI-në që është në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së të dhënave dhe një ndarje të qartë të kompetencave midis agjencive të ndryshme për mbledhjen, analizimin dhe shkëmbimin e të dhënave të inteligjencës;
- strukturat organizative që lehtësojnë orientimin e qartë strategjik, bashkëpunimin operacional dhe proceset vendimmarrëse në kushtet kur veprojnë disa agjenci njëherësh, si dhe mbikëqyrja e duhur;
- teknologjia për lehtësimin e qarkullimit të informacionit përmes sistemeve të ndryshme që mund të operojnë me njëri-tjetrin (ndëroperabiliteti);
- njohuritë dhe aftësitë e të gjithë stafit përkatës; dhe
- kultura bashkëpunuese e shkëmbimit të inteligjencës në mbështetje të vendimmarrjes në të gjitha fushat operative<sup>48</sup>.

Të gjitha këto çështje do të adresohen më vonë në këtë udhëzues.

---

48 Shih Strategjinë Australiane të Menaxhimit të Inteligjencës Kriminale 2012-2015.



## 7.1 Modeli i PBI-së sipas OSBE-së

Siç u shpjegua në Kapitullin 3, PBI-ja është një model vendimmarrjeje dhe menaxhimi që funksionon nga lart-poshtë. Ai ofron strukturën, metodologjinë dhe disa procese për mbledhjen, shkëmbimin dhe analizimin sistematik të informacioneve të nevojshme që shërbejnë si bazë për planifikimin dhe vendimmarrjen e informuar të drejtuesve të organeve të zbatimit të ligjit. PBI-ja është quajtur modeli i punës për zbatimin e ligjit, d.m.th. një metodologji që orientojnë drejtimin dhe realizimin e policimit.

Modeli konceptual i 4-i-ve i paraqitur në Kapitullin 3 thekson marrëdhënien mes tre aktorëve kryesorë në PBI: mjedisit kriminal, analistëve të inteligjencës kriminale dhe vendimmarrësve. Modeli 4-i tregon se vendimmarrësit i ndajnë detyrat dhe i orientojnë analistët, duke u shpjeguar qëllimet pas çdo detyre. Analistët e interpretojnë mjedisin kriminal përmes analizës së tyre dhe influencojnë vendimmarrësit me gjetjet e tyre. Bazuar tek produktet e analizës, vendimmarrësit ndikojnë tek mjedisi kriminal përmes veprimeve të ndërmarra për zbatimin e ligjit.

“Policimi me bazë inteligjencën është një model pune për policimin [...] që mund të përfshijë fusha të aktivitetit policor që nuk lidhen me vetë krimin, por që përbëjnë prapësepapë problem për komunitetet dhe agjencitë policore. Me këtë zhvillim, policimi me bazë inteligjencën po bëhet çasje pune ‘të gjitha krimet, të gjitha rreziqet, të gjitha dëmet’ e ndjekur nga shumë njerëz në fushën e policimit”.

– Ratcliffe (2016: 67).

Figura 7.1 është një prezantim i thjeshtuar grafik i hapave, aktorëve, procedurave dhe produkteve kryesore të vënies në zbatim të konceptit të PBI-së. Ky model mund të aplikohet pjesërisht ose plotësisht në nivel kombëtar, rajonal apo lokal të organeve të zbatimit të ligjit<sup>49</sup>.

<sup>49</sup> Ky ilustrim grafik i modelit PBI propozuar nga OSBE-ja është hartuar nga Njësia e Çështjeve Strategjike të Departamentit të Policisë së OSBE-së për Kërcënimet Transnacionale, në bazë të përkufizimeve të Ratcliffe (2016). Në krijimin e këtij grafiku është përdorur edhe prezantimi i Qarkullimit të Informacionit në botimin e UNODC për Sistemet e Policisë për Informacionin dhe Inteligjencën (2006).




Figura 7.1 Modeli i Policimit i OSBE-së me bazë Inteligjencën

Modeli PBI përfshin këta hapa dhe përbërës:

### CAKTIMI I DETYRAVE

Në bazë të politikave, planeve strategjike dhe operative, kërcënimeve të reja apo nevojave të identifikuar, drejtuesit kombëtarë, rajonalë apo lokalë të organeve të zbatimit të ligjit u ngarkojnë detyrat dhe u japin orientime drejtuesve të sektorit të analizimit, të cilët nga ana e tyre u ngarkojnë detyra njësisë, departamenteve të analizave apo edhe analistëve të caktuar.

### ANALIZIMI NË KUADRIN E PROCESIT TË INTELIGJENCËS KRIMINALE

Në vijim të orientimeve apo detyrave të ngarkuara nga drejtuesit apo kërkesave të hetuesve, analistët grumbullojnë informacione sekrete sipas një procesi të përkufizuar të inteligjencës. Ndonëse analiza përbën elementin thelbësor të procesit, ky i fundit përfshin edhe mbledhjen, përpunimin dhe bashkimin e informacionit. (Një përshkrim i detajuar i gjashtë hapave të procesit të inteligjencës kriminale jepet në Kapitullin 6.)

### PRODUKTET E INTELIGJENCËS KRIMINALE

Procesi i analizimit gjeneron produkte strategjike dhe operative të inteligjencës, të cilat përdoren si bazë për hartimin e planeve strategjike dhe operative dhe për mbështetjen e hetimit të krimeve dhe operacioneve të tjera në zbatim të ligjit, si dhe prioritizimin dhe shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe teknike.

### VENDIMMARRJA

Ky udhëzues rekomandon ngritjen e një strukture vendimmarrëse të PBI në çdo vend në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, ku raportet e analizave/produkteve të inteligjencës do të përdoren si baza për marrjen e vendimeve. Një mekanizëm që sugjerohet për këtë qëllim përshkruhet në nënkapitullin 7.5, kurse disa shembuj të praktikave të mira kombëtare paraqiten në nënkapitullin 8.2.

### AKTIVITETET OPERATIVE

Figura 7.1 liston pesë shembuj të fushave të policimit ku mund të aplikohen parimet e PBI-së. Kjo, sigurisht, që nuk është listë shteruese dhe zbatimi i ligjit në mënyrë proaktive mund të aplikohet në shumë fusha të tjera policimi. Fushat e policimit operativ gjenerojnë të dhëna dhe informacione sekrete dhe josekrete që përcillen mes kanaleve të përcaktuara të komunikimit dhe ruhen në baza të dhënash që lejojnë analiza të mëtejshme.

## Qarkullimi i të dhënave dhe informacioneve

Që PBI-ja të funksionojë siç duhet, të gjithë punonjësit e zbatimit të ligjit duhet të shkëmbejnë dhe të qarkullojnë, përmes mekanizmave dhe kanaleve të përcaktuara qartë të komunikimit, të dhëna dhe informacione sekrete dhe josekrete që i marrin dhe i mbledhin përmes aktiviteteve të tyre dhe punës së përditshme. Shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve sekrete dhe josekrete duhet të jetë i detyrueshëm për të gjithë punonjësit e zbatimit të ligjit parashikuar në ligjin vendas ose në udhëzime të tjera zyrtare.

### Informacion kthyes dhe vlerësimi

Analistët dhe drejtuesit e analizës marrin informacion kthyes (feedback) për cilësinë e analizës që bëjnë dhe për produktet e inteligjencës kriminale nga drejtuesit e zbatimit të ligjit, hetuesit dhe përdorues të tjerë të raporteve të tyre. Treguesit kryesorë të cilësisë së produkteve të inteligjencës kriminale janë respektimi i metodologjive dhe standardeve të përcaktuara, si dhe shkalla e përmbushjes së pritshmërisë dhe kërkesave të përdoruesve të tyre, sidomos sa i përket vendimmarrjes strategjike dhe operative.

### Monitorimi dhe kontrolli i cilësisë

Krijimi dhe ruajtja e një sistemi për monitorimin dhe kontrollin e cilësisë së modelit PBI është përgjegjësi e drejtuesve të organeve të zbatimit të ligjit. Kjo vlen për të gjithë planet, objektivat, proceset dhe hapat, duke përfshirë vlerësimin e produkteve të inteligjencës kriminale, ndjekjen e detyrave dhe vendimeve, respektimin e të drejtave të njeriut dhe standardet e mbrojtjes së të dhënave, si dhe burimet e vëna në dispozicion për çdo detyrë. Çdo vend duhet të ngrejë sistemin e vet të menaxhimit dhe kontrollit të cilësisë. Përveç monitorimit të brendshëm dhe kontrollit të cilësisë, edhe funksionet që lidhen me PBI-në, si bashkimi, ruajtja, përpunimi dhe shkëmbimi i informacioneve sekrete dhe josekrete duhet të jenë objekt i një mbikëqyrjeje të pavarur<sup>50</sup>.

Ndonëse modeli PBI ndahet në pesë hapa dhe nënprocese kryesore, duhet theksuar se të gjithë përbërësit e modelit janë ndëraktivë dhe plotësojnë njëri-tjetrin, duke e bërë shpesh të nevojshëm rikthimin në hapat e mëparshëm. Për shembull, procesi i analizës shfaq shpesh boshllëqe në informacionet sekrete, të cilat ndonjëherë kërkojnë kryerjen e një detyre apo hetimi të ri.

Siç përmendet më sipër dhe siç theksohet shpesh në këtë udhëzues, të gjithë punonjësit e zbatimit të ligjit duhet të jenë pjesëmarrës dhe kontribuues aktivë të modelit PBI. Modeli PBI mbështetet tek të dhënat dhe informacionet nga të gjitha nivelet, departamentet dhe njësitë e organeve të zbatimit të ligjit. Prandaj, të gjitha nivelet duhet të jenë të ndërgjegjësuar dhe të trajnuara dhe duhet të ketë Rregullore të Procedurave Standarde të Operimit për PBI-në, ashtu sikurse edhe mekanizma për të garantuar sigurinë, llogaridhënien dhe mbikëqyrjen.

## 7.2 Sfidat dhe kriteret kryesore të zbatimit të modelit

Studimet kanë treguar se që PBI-ja të funksionojë plotësisht, duhen kapërcyer disa sfida dhe duhen përmbushur disa parakushte. Është vërtetuar se PBI-ja mund të ketë një ndikim kuptimplotë dhe të matshëm vetëm nëse realizohet përmes një ndryshimi organizativ, kulturor dhe të udhëheqjes<sup>51</sup>. Është vërtetuar gjithashtu se mungesa e vullnetit për bërjen e këtyre reformave ka qenë pengesë e konsiderueshme në procesin e zbatimit të modelit PBI. Përveç këtyre sfidave, përshtatja dhe realizimi i modelit PBI shpesh “kërcënon rregullin, kulturën dhe identitetin e krijuar të organizatës dhe normat, vlerat dhe moralin e stafit të saj” dhe “stafi rrallë i pret mirë ndryshimet”<sup>52</sup>. Mbizotërimi i kulturës së performancës dhe statistikave operative, ku theksi më shumë i vendoset matjes së rezultateve, theksohet si një nga shkaqet kryesore që çon në këtë lloj hezitimi për të mirëpri-

50 Për një shembull praktike të mirë, shih Ministrinë e Brendshme të Republikës së Serbisë (2016: 45-49).

51 Flood and Gaspar (2009).

52 James (2017: 7).



tur ndryshimet në organet e zbatimit të ligjit<sup>53</sup>. Kështu, futja e modelit PBI si një model i ri vendimmarrjeje në organet e zbatimit të ligjit përbën një sfidë të veçantë, pasi ai kërkon shpesh metoda të reja menaxhimi dhe një ndryshim të kulturës së punës mes drejtuesve të policisë. Për të maksimizuar potencialin e PBI-së, në të gjitha nivelet e organizatës duhet të bëhet një menaxhim i plotë i ndryshimeve, duke përfshirë përgatitjet, konsultimet dhe masat ndërgjegjëse para dhe gjatë procesit të vënies së këtij modeli në zbatim.

**“Në fund të fundit, mundësia për çfarëdoj reformimi të një organizate varet detyrimisht nga sa shumë besojnë njerëzit që kanë vërtet pushtet se ndryshimet që sjell reforma janë si në të mirë të tyre, ashtu edhe në të mirë të anës praktike të institucionit.” – James (2016: 26).**

Përveç vështirësive më sipër, disa nga parakushtet e tjera që duhet të përmbushen për vënien me sukses në zbatim të modelit PBI, përfshijnë:

- përzgjedhjen cilësore të stafit, trajnimin e përshtatshëm dhe pasjen e punonjësve të zotë;
- orientimin, menaxhimin dhe kontrollin e duhur të punës për përdorimin e informacioneve sekrete;
- ngritjen e bazave të përshtatshme të të dhënave, pajisjen me pajisje IT dhe programe kompjuterike analizuuese;
- pasjen e drejtuesve të kualifikuar që dinë të shfrytëzojnë produktet e analizimit të informacioneve sekrete<sup>54</sup>.

Pikat e mëposhtme ofrojnë disa orientime të përgjithshme për planifikimin e përshtatjes dhe vënies në zbatim të modelit PBI. Edhe pse modeli bazë PBI mund të aplikohet kudo, këto pika duhen të përshtaten me kontekstin kombëtar dhe atë lokal.<sup>55</sup>

### ***Korniza ligjore kombëtare për zbatimin e PBI-së në përputhje me standardet ligjore ndërkombëtare***

- Legjislacioni kombëtar duhet të përfshijë dispozita specifike për PBI-në dhe të lejojë zbatimin e tij.
- Mbledhja, ruajtja, përpunimi dhe shkëmbimi i të dhënave dhe informacioneve duhet të bazohet në legjislacionin vendas, i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së të dhënave. Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së inkurajohen të kërkojnë asistencë dhe këshillim teknik për të vlerësuar nëse ligjet e tyre janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.
- Kuadri, metodologjitë dhe proceset e brendshme të PBI-së, si dhe ndarja dhe përdorimi i produkteve të informacioneve sekrete duhet të respektojnë parimet e OSBE-së për policimin demokratik, të cilat konfirmojnë edhe një herë rëndësinë e shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut, mbrojtjes së të dhënave, etikës së policisë, përgjegjshmërisë dhe transparencës, si dhe monitorimit dhe kontrollit nga jashtë organizatës<sup>56</sup>.

53 Komisioni i Përbashkët Parlamentar për Zbatimin e Ligjit, Hetim për mbledhjen dhe përdorimin e informacioneve sekrete në hetimin dhe luftën ndaj krimit (Canberra: Komisioni i Përbashkët Parlamentar për Zbatimin e Ligjit, Australi), (2013: 47-49).

54 James et al. (2016: 24-25); Ratcliffe (2016: 127).

55 Ky udhëzues nuk jep një listë të detajuar për shkak të specifikave të secilit vend, por fokusohet në çështjet e përgjithshme dhe të zakonshme që hasen në të gjitha Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së në bazë të literaturës së shqyrtuar dhe kontributeve të dhëna nga ekspertë të fushës që u morën me rishikimin dhe hartimin e këtij udhëzuesi.

56 OSCE (2008a: 12-13).

### *Mbështetja politike dhe angazhimi i niveleve të larta qeveritare dhe drejtuese*

- Para përshtatjes dhe vënies në zbatim të një modeli PBI, duhen marrë masat që të sigurohet mbështetja politike, si dhe njohja e mirë e këtij sistemi dhe angazhimi për zbatimin e tij të niveleve të larta të qeverisë/ministrive dhe drejtuesve të organeve të zbatimit të ligjit.
- Nuk do të mund të shfrytëzohet potenciali i plotë i PBI-së nëse ky model, strukturat dhe proceset e tij, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të ndryshëm në të nuk njihen nga të gjitha nivelet e organeve të zbatimit të ligjit.

### *Qasja ndaj modelit PBI nga e gjithë organizata*

- PBI mund të aplikohet në të gjitha fushat e policimit.
- PBI duhet të aplikohet në të gjithë organizatën dhe jo vetëm në njësi të specializuara.
- Përpjekjet për të ndryshuar kulturën e punës drejt një kulture që i vë theks “nevojës për shkëmbim” informacioni duhet të jenë pjesë të pandashme të menaxhimit të ndryshimit me futjen dhe zbatimin e modelit PBI.
- Modeli PBI përfshin analistë që punojnë duke mbështetur drejtpërdrejt vendimmarrësit në të gjitha nivelet e organizatës.

### *Planifikimi strategjik kombëtar i organeve të zbatimit të ligjit në bazë të analizave strategjike, duke përfshirë edhe vlerësimin e kërcënimeve*

- Planet strategjike kombëtare, duke përfshirë edhe vendosjen e prioriteteve, duhet të formulohen në bazë të analizave dhe vlerësimeve strategjike.
- Këto plane duhet të zhvillohen më tej në plane veprimesh operative.
- Burimet në njerëz, mjete dhe fonde duhet të shpërndahen në përputhje me këto plane.

### *Takimet për caktimin e detyrave strategjike dhe operative*

- Duhet të organizohen takime sistematike për ndarjen si të detyrave strategjike, ashtu edhe atyre operative në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar (shih më tej nënkreun 7.5).
- Mbledhja dhe analizimi me efikasitet i informacioneve sekrete mbi aktivitete kriminale kanë rezultuar se prodhojnë më shumë mundësi hetimi dhe mundësi operative sesa mund të prodhojë modeli i zakonshëm i funksionimit të organeve të zbatimit të ligjit. Prandaj, identifikimi dhe ndarja me kujdes e detyrave dhe përcaktimi i prioriteteve duhet të jenë një punë e pandarë e këtyre takimeve strategjike dhe operative.
- Për të siguruar marrjen e vendimeve të bazuara tek inteligjenca, produktet operative dhe strategjike të inteligjencës duhet të jenë pjesë integrale e kornizës së vendimmarrjes dhe ndarjes së detyrave.

### *Mbledhja dhe shkëmbimi i të dhënave, informacioneve dhe inteligjencës*

- Të gjithë punonjësit e zbatimit të ligjit duhet të jenë të detyruar me ligj apo me vendime të tjera zyrtare të shkëmbejnë informacionet e marra në lidhje me krime apo kriminelë të dyshuar përmes mekanizmave dhe kanaleve të komunikimit të përcaktuara qartë dhe në përputhje me ligjin vendas dhe standardet ndërkombëtare.
- Duhet të merren disa masa për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut të personave të përmendur në informacionet e mbledhura me qëllim analizimi.
- Duhet të merren masat e nevojshme për mbrojtjen e identitetit dhe sigurisë së informatorëve apo sinjalizuesve.

- Autoritetet duhet të lejojnë shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve mes agjencie shtetërore dhe institucioneve të tëra zyrtare brenda kornizës ligjore vendore dhe ndërkombëtare në fuqi dhe duke respektuar ligjet për sekretimin dhe mbrojtjen e të dhënave.
- Autoritetet përkatëse mund të bëjnë marrëveshje zyrtare që lejojnë marrjen dhe përdorimin e të dhënave dhe informacioneve rast-pas-rasti nga burime jashtë agjencie shtetërore, ku përfshihen autoritetet lokale, organizatat joqeveritare, shoqëria civile, industria private, organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe nga media dhe publiku me kusht që këto marrëveshje të jenë brenda kufijve të kornizës ligjore vendore dhe ndërkombëtare. Marrëveshje të tilla duhet të parashikojnë edhe garancitë e nevojshme për t'u siguruar që autoritetet të mos u jepet qasje në këto të dhëna nëse kjo është në kundërshtim me standardet e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së të dhënave.
- Sistemet kombëtare të vlerësimit të informacioneve, duke përfshirë edhe kodet e përpunimit dhe shpërndarjes së tyre, duhet të vendosen dhe të futen në përdorim me vendim zyrtar.
- Të gjithë punonjësit e organeve të zbatimit të ligjit duhet të jenë të njoftuar mirë me këto kode dhe t'i aplikojnë ato në të gjitha informacionet që marrin dhe japin.

### ***Agjencia/Departamenti qendror i inteligjencës kriminale***

- Ky udhëzues rekomandon që çdo vend të ketë një departament kombëtar të centralizuar të inteligjencës kriminale (DKIK).
- DKIK duhet të përbëhet nga punonjës ose anëtarë të disa agjencie<sup>57</sup>.
- Përfaqësuesit e enteve të ndryshme të zbatimit të ligjit dhe autoritetet të tjera përfaqësuar në DKIK duhet të kenë qasje në të dhënat dhe informacionet e agjencie të tyre dhe duhet të lejohen me ligj t'i shkëmbejnë ato me përfaqësuesit e enteve/autoritetet të tjera të përfaqësuar në DKIK, në përputhje me kornizën ligjore vendore dhe ndërkombëtare.
- DKIK duhet të jetë përgjegjës për një bazë kombëtare të dhënash të inteligjencës kriminale.
- DKIK duhet të jetë përgjegjës për kryerjen e analizave strategjike dhe operative, duke përfshirë vlerësimet e kërcënimeve në nivel kombëtar.
- DKIK duhet të asistojë departamentet/njësitë rajonale/lokale të analizimit të inteligjencës kriminale kur lind nevoja<sup>58</sup>.

### ***Analiza kriminale dhe vlerësimi i kërcënimeve***

- Autoritetet kombëtare duhet të nxjerrin vendime zyrtare dhe Rregullore të Procedurave Standarde të Operimit për metoda dhe procese transparente të analizimit dhe vlerësimit të kërcënimeve.
- Llojet dhe strukturat e produkteve të inteligjencës kriminale duhet të vendosen në nivel kombëtar dhe t'u ofrojnë të gjitha organeve të zbatimit të ligjit të njëjtën kornizë raportimi.
- Raportimet e inteligjencës kriminale të bazuara në standarde dhe formate përgjithësisht të pranuar ndërkombëtare duhet të sqarojnë dhe të frymëzojnë bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërkombëtar për çështjet penale.

### ***Ndëroperabiliteti dhe siguria e IT-së***

- Në mbështetje të PBI-së duhet të përdoren në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar struktura IT të ndërlidhura, që mund të operojnë me njëra-tjetrën dhe që mbështeten në një platformë të vetme.
- DKIK duhet të ketë akses në të gjitha të dhënat, informacionet dhe inteligjenca që zotërojnë

57 Shih më tej në nënkapitullin 7.4.3 mbi mekanizmat qendrorë të inteligjencës kriminale. Shih edhe një shembull të një praktike të mirë nga Suedia në nënkapitullin 8.2.3.

58 Rekomandime për menaxhimin e njësive të inteligjencës jepen në UNODC (2011b: 51-59).

departamentet rajonale dhe lokale të inteligjencës kriminale dhe organe të tjera të zbatimit të ligjit.

- Duhet të ekzistojnë cilësitë e duhura të sigurisë në përputhje me vendimet zyrtare dhe me Rregulloret e Procedurave Standarde të Operimit, legjislacionin kombëtar dhe legjislacionin ndërkombëtar, duke përfshirë regjistrimin e detajuar dhe mekanizmat e brendshëm të kontrollit, si dhe nivelet e aksesit të përkufizuara dhe të regjistruara qartësisht.
- Këto vendime zyrtare dhe Procedurat Standarde të Operimit duhet të mbulojnë sigurinë fizike, sigurinë e dokumentacionit, sigurinë e IT-së dhe sigurinë e personelit, duke përfshirë vetting-un dhe verifikimet e figurës së punonjësve aty ku është e nevojshme<sup>59</sup>.
- Bazat e të dhënave të inteligjencës kriminale dhe shkëmbimi i të dhënave, informacioneve dhe inteligjencës duhet të jenë objekt i monitorimit dhe kontrollit të një autoriteti të jashtëm dhe të pavarur kontrolli ngritur me ligj për të garantuar respektimin e legjislacionit kombëtar në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe dispozitat për mbrojtjen e të dhënave, si dhe të parashikojnë zgjidhje efektive dhe të arritshme në raste shkeljesh.

### ***Mekanizmat e informacionit kthyes dhe praktika***

- Drejtuesit dhe analistët që marrin informacione nga punonjësit e zbatimit të ligjit duhet t'u japin atyre një lloj vlerësimi (feedback) për të inkurajuar shkëmbimin e mëtejshëm të të dhënave.
- Drejtuesit, hetuesit dhe përdoruesit e tjerë të produkteve të analizave duhet t'u japin feedback analistëve mbi cilësinë e produkteve të analizës për të nxitur progres dhe përmirësim.

### ***Menaxhimi dhe kontrolli i cilësisë***

- Niveli drejtues i organeve të zbatimit të ligjit në shkallë vendi është përgjegjës për: ngritjen dhe ruajtjen e një sistemi monitorimi dhe kontrolli të cilësisë në të gjitha nivelet e zbatimit të modelit PBI; për ndarjen e detyrave dhe marrjen e vendimeve; objektivat dhe rezultatet; proceset e brendshme; produktet e inteligjencës kriminale; bazën materiale dhe pajisjet; si dhe për burimet njerëzore, duke përfshirë trajnimin dhe performancën e stafit.
- I gjithë procesi i inteligjencës në secilin vend duhet t'i nënshtrohet mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm të mbikëqyrjes.

### ***Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i inteligjencës me komunitetin e zbatimit të ligjit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar***

- Në përputhje me legjislacionin vendas, standardet ndërkombëtare dhe instrumentet e ndihmës së ndërsjellë juridike, analizat kombëtare dhe vlerësimet strategjike të kërcënimeve duhet të shkëmbehen me vendet me të cilat një vend bashkëpunon, si dhe me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare përkatëse.
- Shkëmbimi i inteligjencës me shtete të tjera duhet të bazohet tek legjislacioni vendas, i cili duhet të përcaktojë parametra të qartë për shkëmbimin e inteligjencës, duke përfshirë edhe kushtet që duhet të përmbushen për shkëmbimin e informacioneve, njësitë me të cilat mund të shkëmbehet intelijenca, si dhe masat që duhen marrë si garanci në shkëmbimin e inteligjencës<sup>60</sup>.

59 UNODC (2011b: 39-50).

60 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara. "Raportuesi i Posaçëm mbi promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në luftën kundër terrorizmit, Martin Scheinin." Këshilli i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, 17 maj 2010, A/HRC/14/46: Nenet 26, 38 dhe 90.

- Duhet të merren masa proaktive për ndërmarrjen e hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta të bazuara tek inteligjenca në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, bazuar në sfidat e përbashkëta kriminale të identifikuara dhe të prezantuara në raportet e analizave dhe vlerësimit të kërcënimeve.

### 7.3 Analiza dhe vendimmarrja në procesin e zbatimit të ligjit

Zbatimi i ligjit në mënyrë proaktive kërkon inteligjencë dhe planifikim strategjik. Përveç kërkesave gjithnjë e më të mëdha për burime më efektive, për më shumë transparencë dhe përgjegjshmëri, vendimmarrësit ndikohen nga një sërë faktorësh të jashtëm dhe personalë, siç tregohet në Figurën 7.2.




Figura 7.2 Ndikimet e jashtme dhe personale te vendimmarrësit

Burimi: Ratcliffe (2016: 118).

Vendimmarrësit në organet moderne të zbatimit të ligjit duhet të jetojnë me faktin që puna e tyre e përditshme dhe vendimet e tyre kyçe ndikohen nga një gamë e gjerë faktorësh. Drejtimi cilësor i policisë, duke përfshirë edhe vendimmarrjen, kërkon produkte cilësore analitike dhe analistë të zotë që janë në gjendje të mbështesin drejtuesit duke u ofruar raporte të përgatitura me detaje dhe sipas rastit. Duke qenë se shumica e vendimeve të organeve të zbatimit të ligjit ndikon drejtpërdrejt në jetën e njerëzve dhe duke qenë se të gjithë punonjësit e zbatimit të ligjit janë përgjegjës për veprimet e tyre<sup>61</sup>, informacionet mbi të cilat ata bazojnë vendimet marrin rëndësi të veçantë. Këto fakte theksojnë edhe një herë se sa i rëndësishëm është modeli PBI si një kuadër i rëndësishëm vendimmarrjeje në nivel drejtues.

61 Këshilli i Evropës, Kodi Evropian i Etikës në Polici (Strasbourg: Botim i Këshillit të Evropës, mars 2002): Neni 26, 38 dhe 90.

“Shpesh, një tipar karakteristik i sistemeve të dobëta vendimmarrëse të policisë është që analistët vendosin vetë se me çfarë detyrash duhet të merren ose marrin në dorë përcaktimin e prioriteteve strategjike. Drejtuesit e policisë në sisteme të konsoliduara vendimmarrjeje marrin përsipër një rol më drejtues duke qartësuar qëllimet e tyre në ndarjen e detyrave njësisive të inteligjencës dhe njësisive të analizës. Ndërkohë që lënë hapësirë për t'u influencuar nga kërcënimet e reja që mund të mos jenë fare në radarët e tyre, drejtuesit me përvojë nuk e lënë krahun e analizës së policisë të lundrojë si anije pa timon, por e mbikëqyrin dhe e drejtojnë atë.” – **Ratcliffe (2016: 83).**

Edhe pse analizuesit duhet t'i mbështesin gjithmonë gjetjet e analizave të tyre duke qenë neutralë, ata duhet të jenë njohës të mirë të kushteve ku operojnë vendimmarrësit, duke përfshirë këtu edhe kufizimet ligjore, politike, organizative dhe financiare që mund të ekzistojnë. Kjo duhet marrë parasysh në hartimin dhe prezantimin e rekomandimeve. Është e kotë që analistët të prezantojnë rekomandime që për klientin janë ose krejt pa vend ose të perealizueshme.

### 7.4 Nivelet e mekanizmave të inteligjencës kriminale

PBI-ja kërkon struktura organizative, procedura administrative dhe vendimmarrëse, si dhe mekanizma komunikimi midis të gjitha niveleve. Ky nënkapitull prezanton disa mekanizma inteligjence (njësi/departamente/agjenci) që mbështesin ekzekutimin e PBI-së. Një nga detyrat kryesore të çdo mekanizmi të inteligjencës kriminale të çdo niveli është që t'i furnizojë strukturat drejtuese me analiza dhe vlerësime që ata t'i marrin vendimet pasi të jenë informuar mirë paraprakisht.

#### 7.4.1 Mekanizmi e inteligjencës kriminale në nivel vendor/stacioni policor

Mekanizmat e inteligjencës kriminale në nivel vendor/stacioni policor mbulojnë krimet, kriminelët dhe problemet e sigurisë që prekin njësinë bazë të komandës së policisë në nivel komuniteti apo stacioni policor. Në varësi të përmasës dhe strukturës që ka, çdo nivel vendor duhet të ketë një njësi të inteligjencës kriminale ose një ekip përgjegjës për të gjitha detyrat operative kriminale të atij niveli policor. Kjo njësi duhet të drejtohet nga një drejtues i së njëjtës gradë me krerët e njësisive operative dhe të hetimeve në nivel vendor/stacioni.

Njësitë e inteligjencës kriminale në nivel vendor/stacioni mbështesin planifikimin vendor, operacionet dhe hetimet. Kështu, ato:

- mbështesin shërbimet e përgjithshme operative të policisë në luftën ndaj krimit të përditshëm dhe në përpjekje për ruajtjen e sigurisë dhe rendit publik në nivel vendor ose stacioni policor;
- ofrojnë mbështetje analitike për hetimet në nivel vendor/stacioni policor;
- ofrojnë të dhëna dhe informacione për regjistrat policorë, bazat e të dhënave dhe për proceset e inteligjencës kriminale;
- u ofrojnë të dhëna, informacione dhe inteligjencë njësisive të inteligjencës kriminale të niveleve rajonale dhe/ose kombëtare për përpunim të mëtejshëm;
- kryejnë dhe prezantojnë analiza dhe vlerësime risku në rastet e aktiviteteve vendore; dhe
- ofrojnë mbështetje analitike për parandalimin e krimit vendor.

### 7.4.2 Mekanizmi e inteligjencës kriminale në nivel rajonal

Seksioni i inteligjencës kriminale në nivel rajonal mbulon detyra ligjzbatuese që prekin më shumë se një njësi bazë komande policore. Detyrat dhe përgjegjësitë e tij kryesore përfshijnë evidentimin e kërcënimeve të zakonshme kriminale në rajon, shkëmbimin e informacioneve dhe ofrimin e aftësive dhe burimeve në mbështetje të veprimtarisë në nivel vendor dhe rajonal. Seksioni i inteligjencës kriminale në nivel rajonal duhet të jetë në të njëjtin nivel dhe të drejtohet nga një gradë e njëjtë si krerët rajonalë të operacioneve dhe hetimeve dhe të varet drejtpërdrejt nga drejtori i policisë rajonale.

Seksioni i inteligjencës kriminale në nivel rajonal mbështet njësitë e inteligjencës kriminale të nivelit vendor sipas nevojës. Roli i tij kryesor është mbështetja e planifikimit, operacioneve dhe hetimeve në nivel rajonal. Konkretisht, ky seksion:

- harton dhe zbaton planet vjetore të inteligjencës kriminale në nivel rajonal;
- mbledh në mënyrë sistematike të dhëna, informacione dhe inteligjencë në nivelin rajonal dhe i dërgon në bazën e centralizuar rajonale të të dhënave, ku ka akses organi i centralizuar i inteligjencës kriminale i secilit shtet (këtu: Departamenti Kombëtar i Inteligjencës Kriminale);
- dërgon të dhëna, informacione, inteligjencë dhe raporte të inteligjencës tek nivelet vendore dhe kombëtare;
- kryen analiza dhe vlerësime strategjike në mbështetje të vendimmarrjes dhe planifikimit në nivel rajonal të drejtuesve;
- ofron mbështetje për parandalimin e krimit rajonal;
- mbështet hetimet dhe operacionet kundër krimit rajonal dhe ndërkuftar, ku përfshihet dhe krimi i organizuar ndërkuftar;

### 7.4.3. Mekanizmi e inteligjencës në nivel qendror

DKIK-ja duhet të vendoset në ambientet e drejtorisë kombëtare të zbatimit të ligjit (drejtoria e policisë/agjencia kombëtare kundër krimeve) dhe të drejtohet nga një punonjës i lartë policie.

Roli kryesor i DKIK-së është hartimi i raporteve informative në mbështetje të vendimmarrjes kundër kërcënimeve të rënda kombëtare, veçanërisht krimit të organizuar ndërkuftar, terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm. Përgjegjësitë e saj kryesore përfshijnë:

- hartimin dhe zbatimin e planit kombëtar të inteligjencës kriminale;
- hartimin dhe prezantimin e vlerësimit kombëtar të kërcënimeve nga krimi i rëndë dhe krimi i organizuar;
- hartimin dhe prezantimin e vlerësimeve të tjera strategjike për të mbështetur drejtimin dhe planifikimin të zbatimit të ligjit në nivel kombëtar;
- ofrimin e mbështetjes informative në nivel rajonal;
- vendosjen e standardeve dhe koordinimin e punës për inteligjencë kriminale në vend;
- funksionimin si pika e kontaktit në nivel kombëtar për autoritetet dhe organizatat e huaja për zbatim të ligjit në lidhje me inteligjencën kriminale; dhe
- kryerjen e kërkimeve dhe përpjekjeve për zhvillim profesional në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar<sup>62</sup>.

DKIK-ja duhet të jetë një organ ligjzbatues i përbërë prej shumë agjencive, stafi i të cilit përbëhet nga ekspertë të agjencive dhe institucioneve të ndryshme shtetërore, ku çdo ekspert ka qasje

62 Shih gjithashtu rekomandimet për menaxhimin dhe vendosjen e standardeve për njësitë e inteligjencës kriminale në UNODC (2011b: 51, 61)

në informacionet dhe bazat e të dhënave të institucionit që përfaqëson dhe që lejohet me ligj të shkëmbejë të dhëna dhe informacione me stafin e agjencie/institucioneve që përfaqësohen në DKIK. Në varësi të strukturave të sektorit të sigurisë së secilit shtet, në DKIK mund të përfaqësohen këto autoritete shtetërore:

- Policia kufitare
- Autoritetet e burgjeve
- Doganat
- Njësia e Inteligjencës Financiare (FIU)
- Roja bregdetare/Policia Detare
- Agjencitë informative dhe të sigurisë
- Policia
- Autoritetet tatimore
- Agjencitë e specializuara të zbatimit të ligjit, kur ka të tilla

Agjencitë/institucionet që përfaqësohen në DKIK mund të preferojnë të hartojnë marrëveshje zyrtare bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe DKIK-së. Në këto marrëveshje, disa Shtete pjesëmarrëse të OSBE-së kanë zgjedhur të caktojnë përfaqësues të agjencie/institucioneve të mësipërme si zyrtarë ndërlidhës brenda DKIK-së.

### 7.5 Takimet për ndarjen dhe koordinimin e detyrave

Disa nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së kanë ngritur mekanizma vendimmarrës proaktivë që bazohen tek inteligjenca kriminale, të cilët njihen shpesh si “takimet për ndarjen dhe koordinimin e detyrave”, “takimet drejtuese dhe koordinuese” ose “takimet për ndarjen e informacioneve dhe udhëzimeve”. Takimet për ndarjen dhe koordinimin e detyrave kryhen në të tre nivelet: vendor, rajonal dhe kombëtar. Qëllimi i tyre kryesor është: sjellja së bashku e përfaqësuesve të institucioneve ligjzbatuese të secilit nivel për të marrë vendime rreth planeve, përparësive, operacioneve dhe hetimeve, në bazë të analizave dhe dokumenteve vlerësues; evidentimi i boshllëqeve në inteligjencë me qëllim plotësimin e tyre; si dhe marrja e vendimeve për shpërndarjen e burimeve financiare dhe njerëzore. Ky model qëndron në thelb të PBI-së duke qenë se i bën rezultatet e analizave pjesë të procedurave menaxhuese, duke çuar në marrje vendimesh të bazuara në më shumë informacion e inteligjencë, vendime më transparente dhe në më shumë llogaridhënie. Gjithashtu, ngritja e mekanizmave të inteligjencës kriminale që i shërbejnë vendimmarrjes së secilit nivel u lejon drejtuesve të policisë të vendosin prioritetet mes detyrave të tyre në zbatim të ligjit në përputhje me kërcënimet e evidentuara dhe të vlerësuara, si dhe t'i shpërndajnë burimet financiare, njerëzore dhe burimet e tjera sipas këtyre prioriteteve. Evidentimi i boshllëqeve në inteligjencë, kërkesave për inteligjencë dhe ndarja e detyrave për njësitë analizuese për të përmbushur kërkesat është gjithashtu një nga detyrat e rëndësishme të takimeve vendimmarrëse të secilit nivel. Për të pasur shkëmbime të vazhdueshme informacioni dhe koordinim mes niveleve të ndryshme, në këto takime marrin pjesë dhe drejtuesit ose përfaqësues të niveleve të tjera më të ulëta.

Ky udhëzues sugjeron që takimet e ndarjes dhe koordinimit të detyrave të ndahen në takime për ndarjen dhe koordinimin e detyrave në nivel strategjik dhe takime për ndarjen dhe koordinimin e detyrave në nivel operativ.



### 7.5.1. Takimet për ndarjen dhe koordinimin e detyrave në nivel strategjik

Siç kuptohet nga vetë emërtimi, këto takime duhet të përqendrohen tek çështjet strategjike dhe të organizohen shumë më rrallë se sa takimet e nivelit operativ, që bëhen zakonisht një herë në gjashtë ose tre muaj. Në disa shtete, takimet për ndarjen dhe koordinimin e detyrave në nivel strategjik organizohen në të tre nivelet, por më e zakonshme është organizimi në nivel qendror/kombëtar. Këto takime duhet të përqendrohen tek planifikimi strategjik dhe tek caktimi i prioriteteve dhe objektivave në bazë të analizave strategjike dhe vlerësimeve të kërcënimeve, si dhe të planifikimit organizativ të punës dhe ciklet buxhetore. Rekomandohet që takimet për ndarjen dhe koordinimin e detyrave në nivel strategjik të përcaktojnë përparësitë mes kërkesave kombëtare për inteligjencë, si dhe përparësitë sa i takon parandalimit dhe zbatimit në bazë të gjetjeve të analizave strategjike dhe vlerësimeve të kërcënimeve. Me të marrë këto vendime, takimet duhet të vendosin se çfarë burimesh nevojiten për zbatimin e zgjedhjeve strategjike.<sup>63</sup>

### 7.5.2 Takimet për ndarjen dhe koordinimin e detyrave në nivel operativ

Ky udhëzues rekomandon që mekanizmat operativë të vendimmarrjes në kuadër të PBI-së të organizohen në të tre nivelet çdo javë ose çdo dy javë. Drejtuesit operativë dhe të hetimeve duhet të marrin pjesë së bashku me drejtuesit e njësive të inteligjencës kriminale dhe njësive përkatëse të analizave, si dhe me ekspertë të tjerë nëse është nevoja. Rekomandohet që këto takime të drejtohen nga drejtuesit operativë që mbajnë gradën më të lartë. Në varësi të niveleve dhe rrethanave kombëtare/rajonale/vendore, takimet për ndarjen dhe koordinimin e detyrave në nivel operativ kanë kryesisht përgjegjësinë: të kthejnë planet strategjike në plane veprimi sipas nevojave, prioriteteve dhe mundësive; të vlerësojnë raportet e reja apo të përditësuara të inteligjencës kriminale dhe të marrin vendime për hetimet apo veprimtaritë e reja operativë, ose të mbyllin dhe të kombinonin veprimtari të ndryshme; të evidentojnë boshllëqet në informacione dhe në inteligjencën kriminale dhe t'u caktojnë detyra njësive të inteligjencës kriminale për plotësimin e këtyre boshllëqeve; si dhe të monitorojnë ecurinë e operacioneve

## 7.6 Trajnimi dhe ndërgjegjësimi

Trajnimi është faktor thelbësor për ecurinë e çdo organizate. Gjatë planifikimit dhe zbatimit të PBI-së, është shumë e rëndësishme të zhvillohet një plan trajnimi dhe të kryhet një trajnim i koordinuar i të gjithë zbatuesve të ligjit. Pritet që të gjithë pjesëtarët e stafit të mësojnë jo vetëm aftësitë e nevojshme për punën e tyre, por dhe të kuptojnë rolet e pjesëtarëve të tjerë, në mënyrë që të japin kontribut në rezultatet e përgjithshme të PBI-së. Prej trajnimit, stafi duhet të kuptojë PBI-në, mënyrën si funksionon procesi i inteligjencës, çfarë kontributi mund të japin në këtë proces dhe si mund ta japin dhe ta përdorin atë. Kultura e shkëmbimit të informacionit duhet të synohet veçanërisht në trajnimet për të tre nivelet. Trajnimi duhet të përfshijë edhe njohuri mbi kërkesat ligjore që kanë të bëjnë me funksionet e PBI-së dhe të drejtat përkatëse ndërkombëtare të njeriut dhe standardet e mbrojtjes së të dhënave për aq sa u duhet pjesëmarrësve në trajnim nisur nga niveli dhe funksioni i tyre.

63 Shih shembujt kombëtar të praktikave të mira në nënkapitullin 8.2.

“Që policimi me bazë inteligjencën të jetë i suksesshëm dhe të zhvillohet si paradigmë qendrore e policimit në shekullin XXI, është thelbësore t’u ofrohet trajnim dhe arsimim për praktikantët e uljes së krimit jo vetëm analistëve, por dhe drejtuesve të policisë dhe vendimmarrësve kryesorë të sistemit të drejtësisë penale dhe ky mund të jetë përcaktuesi kryesor i të ardhmes së policimit të bazuar në inteligjencën.” – **Ratcliffe (2016: 143).**

### *Ndërgjegjësimi i niveleve të larta drejtuese*

Siç u theksua dhe më sipër, mbështetja politike dhe angazhimi i nivelit të lartë të qeverisë për PBI-në janë parakushte për zbatimin e tij të suksesshëm. Një gjë e tillë kërkon ndërgjegjësimin e niveleve më të larta, duke përfshirë edhe politikanët, qeveritarët e ministrive përkatëse dhe agjencive shtetërore, prokurorët e përgjithshëm dhe përfaqësues të tjerë kyç të prokurorisë, si dhe drejtuesit e lartë të të gjitha organeve dhe shërbimeve ligjzbatuese.

### *Trajnimi i drejtuesve dhe menaxherëve ligjzbatues*

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi është të tregojë se si korniza e PBI-së dhe analizat mund të mbështesin politikëbërësit dhe drejtuesit ligjzbatues në vendimmarrjen dhe planifikimin e punëve të tyre. Trajnimi me sukses i drejtuesve i ndihmon ata të kuptojnë më mirë potencialin e PBI-së, çfarë detyrash duhet t’u ngarkojnë analistëve dhe si t’i përdoren produktet e analistëve në procesin e vendimmarrjes dhe në planifikimet operative dhe strategjike. Këto trajnime duhet t’u ofrojnë vendimmarrësve informacione për të gjitha standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes së të dhënave, si dhe për çështje të të drejtave të njeriut që mund të dalin e që duhen adresuar gjatë zbatimit të PBI-së.

### *Trajnimi i analistëve*

Zakonisht, ky lloj trajnimi ndahet në trajnim analizimi strategjik dhe operativ, në përputhje me dy kategoritë kryesore të analizimit. Analistët duhet të jenë objekt i trajnimit më kompleks që ekziston në mënyrë që të kuptojnë rolin dhe funksionet e analizimit të krimit brenda kuadrit ligjzbatues dhe legjislativ, si dhe kërkesat ligjore që duhet të plotësojnë metodat e ndryshme të mbledhjes, shkëmbimit dhe përdorimit të informacionit. Trajnimi duhet gjithashtu të përmbajë zhvillimin e aftësive dhe kompetencave për mbledhjen dhe strukturimin e të dhënave dhe informacioneve dhe për kryerjen e analizave të hollësishme, arritjen e përfundimeve dhe paraqitjen e rekomandimeve. Gjithashtu, trajnimi i analistëve përfshin: aftësitë për të shkruar raporte; bashkëpunimin ndërmjet analizës dhe hetimeve dhe atë ndërmjet analizës dhe vendimmarrjes; metodat, mjetet, teknikat e analizimit dhe programet kompjuterike përkatëse; burimet e informacionit; kodet e vlerësimit; dhe kornizën ligjore për të drejtat e njeriut dhe etikën e policisë në lidhje me këto detyra. Trajnimi mund të kryhet në faza të ndryshme për nivele të ndryshme.

### ***Trajnimi i hetuesve***

Hetimet përfshijnë punën operative që bëhet me inteligjencën ose me informacionin e mbledhur dhe të përpunuar. Prandaj, hetuesit duhet të trajnohen në mënyrë adekuate për PBI-në që përpara se të fillojnë të përfshihen në hetime. Trajnimi i hetuesve duhet të përfshijë njohuri paraprake në lidhje me analizat operative dhe se si këto analiza mund të mbështesin hetimin e krimit dhe si mund të bashkëpunojnë analistët dhe hetuesit.

### ***Trajnimi i policëve me uniformë***

Policët me uniformë janë në kontakt të drejtpërdrejtë me publikun dhe me personat e përfshirë në krime dhe për këtë arsye përbëjnë burim të vlefshëm informacioni për sektorin e inteligjencës. Të gjithë punonjësit e policisë me uniformë duhet të marrin një trajnim të përgjithshëm mbi PBI-në dhe përbërësit e tij kryesorë, duke përfshirë përgjegjësitë e tyre në kuadrin e modelit PBI.

### ***Trajnimi i kadetëve***

Trajnimi për PBI-në duhet të bëhet që në kursin bazë të policisë. Është veçanërisht e rëndësishme të sqarohen të gjithë konceptet bazë të modelit PBI për të shmangur çdo keqkuptim të panevojshëm rreth punës së inteligjencës kriminale. Duhet bërë përpjekje për ta prezantuar inteligjencën kriminale si pjesë të veprimtarive normale të policisë, si një fushë tërheqëse për punonjësit e ardhshëm të policisë.

## 8. Modeli PBI në praktikë


Kapitujt e mëparshëm sqarojnë konceptin e PBI-së dhe procesin e analizës së inteligjencës kriminale, duke shpjeguar disa sfida kyçe dhe kushtet për të pasur zbatim të suksesshëm të PBI-së dhe duke bërë sugjerime për struktura organizative që nevojiten për të lehtësuar zbatimin e efektshëm të PBI-së.

Kapitulli 8 mbështetet te kapitujt paraardhës dhe ofron disa shembuj të PBI-së në praktikë, duke filluar me nënkapitullin që përshkruan se si vlerësimi i kërcënimeve luan rol jetësor në adresimin e krimit të rëndë dhe krimit të organizuar. Më pas vijnë pesë shembuj të praktikave të mira të zbatimit të PBI-së ose përbërësve të tij kryesorë në nivel kombëtar. Në fund, nënkapitujt 8.3 dhe 8.4 prezantojnë PBI-në dhe policimin në komunitet, si dhe PBI-në për parandalimin dhe luftën ndaj terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çojnë në terrorizëm.

### 8.1 Modeli PBI, vlerësimi i kërcënimeve dhe planifikimi strategjik kundër krimit të organizuar

Krimi i organizuar kërcënon paqen dhe sigurinë e njerëzve, rrezikon gëzimin e të drejtave të njeriut dhe cenon zhvillimin ekonomik, shoqëror, kulturor, politik dhe civil të shoqërive në botë.<sup>64</sup> Sidoqoftë, autoritetet ligjzbatuese janë në gjendje të hetojnë vetëm një përqindje të vogël të informacioneve dhe të inteligjencës që marrin rreth krimit të organizuar dhe rrjeteve të organizuara kriminale në juridiksionet e tyre. Prandaj, është jetësore të kryhet vlerësimi i këtyre kërcënimeve, të vendosen disa prioritete dhe të caktohen burimet njerëzore, financiare dhe teknike. Modeli PBI ofron kornizën e nevojshme për të pasur qasje moderne dhe për t'u dhënë mundësi strukturave organizative të miratojnë atë çka njihet gjerësisht si e vetmja mënyrë për të luftuar krimin e organizuar transnacional, pra analizën e të dhënave dhe informacioneve, shkëmbimin dhe bashkëpunimin, trajtimin e kërcënimeve të evidentuara dhe të vlerësuara me fokus të qartë dhe sipas prioriteteve.

„Krimi i rëndë dhe krimi i organizuar do të vazhdojnë të jenë shumë dinamikë dhe të shpejtë për të shfrytëzuar ndryshimet që ndodhin në mjedis. Autoritetet ligjzbatuese [...] përballen me sfidën e ecjes paralel me inovacionet teknologjike



dhe me sipërmarrjet gjithnjë e më të ndërlukuara kriminale që prekin të gjithë sektorët e ekonomisë dhe shoqërisë – ndërkohë që duhet të ulin shpenzimet dhe në shumë raste të funksionojnë me buxhete të reduktuara. Për t'iu përgjigjur më mirë krimit, policimi po bëhet gjithnjë e më kompleks dhe lufta ndaj krimit po kërkon tashmë një nivel të pashembullt të specializimit dhe ekspertizës. Autoriteteve ligjzbatuese u duhet të gjejnë mënyra për t'ia dalë mbanë me buxhete më të vogla nga njëra anë dhe nevojës për njohuri të specializuara nga ana tjetër. [...]

Analizimi i përparuar i të dhënave mund t'i ndihmojë autoritetet ligjzbatuese në vendosjen e prioriteteve në përpjekjet e tyre dhe në përfshirjen në policim vërtet të zgjuar dhe të bazuar në inteligjencë.” – **Europol (2015: 44).**

### 8.1.1 Cikli i Politikave të Bashkimit Evropian

BE-ja e ka miratuar zyrtarisht PBI-në në vitin 2005.<sup>65</sup> Që prej atëherë, planifikimet e përbashkëta strategjike të BE-së dhe planet operative të veprimit kundër krimit të organizuar janë zhvilluar sipas modelit PBI. Në vitin 2010, BE-ja miratoi Ciklin e Politikave të BE-së për Krimin e Rëndë dhe Krimin e Organizuar, parathënia e të cilit ofrohet këtu si shembull i praktikave të mira të luftës ndaj krimit të organizuar transnacional, në përputhje me parimet e PBI-së.<sup>66</sup>

Cikli i Politikave të BE-së ka për qëllim të ofrojë një kornizë koherente dhe veprime të forta operative kundër kërcënimeve kriminale kryesore me të cilat përballet BE-ja. Cikli i Politikave ofron një mundësi dhe është hartuar për të arritur integrimin e strukturave të ndryshme me qasje shumë-disiplinore, i cili përfshin edhe gjenerimin e sinergjive mes autoriteteve ligjzbatuese dhe atyre të menaxhimit të kufijve dhe një bashkëpunim të mëtejshëm ndërmjet agjencive evropiane dhe aktorëve që nuk janë pjesë e BE-së.

Secili cikël politikash mbulon një periudhë katërvjeçare dhe përfshin katër hapa kryesorë, si në Figurën 8.1.

65 Këshilli i Bashkimit Evropian. “Përfundimet e Këshillit për policimin me bazë inteligjencës dhe përpilimi i Vlerësimit të Kërcënimeve nga Krimi i Organizuar (OCTA).” Doc. 10180/4/05, REV 4 (Bruksel: 3 tetor 2005).

66 Këshilli i Bashkimit Evropian. “Përfundimet e Këshillit për krijimin dhe zbatimin e ciklit të politikave të BE-së për krimin e rëndë dhe krimin e organizuar ndërkombëtar.” Takimi i 3043-të i Këshillit të Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme (Bruksel: 8 dhe 9 nëntor 2010).




Figura 8.1 Cikli i Politikave të BE-së kundër krimit të rëndë dhe krimit të organizuar  
 PSS: Planet Strategjike Shumëvjeçare  
 POV: Planet Operative të Veprimit  
 Burimi: Këshilli i Bashkimit Evropian (2014).

### HAPI 1 – Vlerësimi i BE-së i Kërcënimeve nga Krimet e Rënda dhe nga Krimi i Organizuar (SOCTA)

SOCTA zhvillohet dhe botohet nga Europol-i në bashkëpunim me grupin këshillues të SOCTA-s (që përbëhet nga shtete anëtare të BE-së, Agjenci të BE-së, Komisioni Evropian dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit), me mbështetje nga shtetet dhe organizatat palë të treta të Europol-it. Duke qenë se metodologjia është miratuar nga Këshilli i Drejtësisë i BE-së dhe nga Ministri e Punëve të Brendshme, ajo ka një kornizë ligjore të qartë dhe mbështetje të fortë politike<sup>67</sup>

“Filluar me prioritetet strategjike e deri tek veprimet operative, [SOCTA] garanton se lufta ndaj kërcënimeve të mëdha kriminale me të cilat ballafaqohet BE do të ketë në thelb qasjen që udhëhiqet nga intelijenca”  
– **Europol (2010).**

Procesi SOCTA i Europol-it përfshin:

- përgatitjen dhe miratimin e kërkesave të hollësishme të klientëve;
- përgatitjen dhe miratimin e metodologjisë;
- evidentimin e kërkesave për intelijencë;
- mbledhjen e të dhënave;
- analizën e të dhënave;
- hartimin e raportit të SOCTA-s, duke përfshirë një listë të kërcënimeve dhe rreziqeve kryesore; dhe
- prezantimin e rezultateve dhe përparësive të rekomanduara.

Procesi i analizimit kryhet duke u përqendruar në katër elemente; të dhëna të posaçme mblidhen për secilin nga elementët (shih Tabelën 8.1):

- fushat/llojet e **krimit të rëndë dhe të organizuar**;
- rrjetet/grupet kriminale të organizuara dhe individë të përfshirë në krimin e rëndë;
- mjedisi: dobësitë, mundësitë dhe **infrastruktura**;
- **efektet dhe dëmet.**

Vlerësimi bazë i kërcënimeve kryhet me anë të një analize kualitative përmes dy lloje treguesish, të cilët paraqiten në dy kolonat e para të Tabelës 8.1. Megjithatë, kërcënimet mund të materializohen në dëme vetëm nëse ka elementë dobësie. Prandaj, për të bërë një vlerësim të plotë të rreziqeve që rrjedhin nga këto kërcënime, duhen evidentuar, analizuar dhe vlerësuar elemente të tjera të dobësive dhe probabilitetit, si dhe efektet dhe dëmet. Dokumenti publik i metodologjisë së SOCTA-s radhit treguesit e mëposhtëm të kërcënimeve dhe të rreziqeve që vlerësohen në procesin e SOCTA-s, siç paraqitet në Tabelën 8.1.

67 Këshilli i Bashkimit Evropian. “Vlerësimi i Kërcënimeve nga Krimi i Rëndë dhe Krimi i Organizuar 2017 – Metodologjia e Rishikuar.” Doc. 14913/15, CRIMORG 128 (Bruksel: 11 dhjetor 2015).

Tabela 8.1 Treguesit që analizohen gjatë procesit të SOCTA-s

VLERËSIMI I KËRCËNIMEVE		VLERËSIMI I KËRCËNIMEVE+ RREZIQET	
Fushat/llojet e krimeve	Grupet/rrjetet kriminale	Faktorë të mjedisit	Efektet/dëmet
Burimet e ndryshme në dispozicion	Fushat/llojet e krimeve ku ato janë aktive	Situata ekonomike	Ndikim Financiar
Kërkesë-Oferta	Veprimtaritë që përfshijnë disa lloje krimesh	Situata gjeopolitike	Ndikim social
Numri i grupeve aktive në fushën/llojin e krimit	Kombësia	Infrastruktura e transportit dhe logjistikës	Ndikim në shëndet
Evolucioni i fushës/llojit të krimit	Madhësia e grupeve	Qëndrimet e publikut	Ndikim në mjedis
Dimensioni gjeografik	Burimet financiare	Novacioni	
Fusha/lloje të tjerë krimesh që lidhen me një krim të caktuar	Burimet njerëzore	Interneti dhe teknologjitë e reja	
Modus operandi i shfrytëzuar	Përfitimi financiar	Legjislacioni	
	Burime të tjera	Veprimi ligjzbatues	
	Struktura, tipi	Prioritetet e BE-së për krimin të vendosura nga Komisioni për Bashkëpunimin	
	Ekspertiza		
	Bashkëpunimi		
	Modus operandi		
	Dimensioni gjeografik		
	Fleksibiliteti dhe aftësia për t'iu përshtatur ndryshimeve		
	Kundërpërgjigjet		
	Korrupsioni dhe ndikimi në sektorin publik		
	Përdorimi i strukturave të ligjshme të biznesit		
	Pastrimi i parave – niveli i sofistikimit		
	Dhuna nga jashtë		



Vlerësimet e kërcënimeve nuk janë raporte përshkruese të situatës aktuale, por shohin drejt së ardhmes. Ato dalin në përfundime duke renditur kërcënimet dhe rekomandimet kryesore se si të vendosen përparësitë. Raportet SOCTA të Europol-it i dërgohen Komisionit të Përhershëm të BE-së për Bashkëpunimin Operativ për Sigurinë e Brendshme (COSI) ku diskutohen në kuadër të procesit politikëbërës të BE-së. Prandaj, vendimi që merret në fund është një bashkim vlerësimesh të ekspertëve dhe pikëpamjeve politike.

### HAPI 2 – Planet Strategjike Shumëvjeçare

Në bazë të SOCTA-s, Këshilli i Drejtësisë i BE-së dhe Ministrat e Punëve të Brendshme marrin vendime zyrtare për fushat kriminale me prioritet për katër vitet e ardhshme. Gjatë përcaktimit të këtyre politikave, Këshilli merr parasysh komentet e vendeve anëtare të BE-së, agjencive, dhe shteteve partnere që nuk janë pjesë e BE-së.

Për secilin prioritet, një grup ekspertësh nga shtetet më të prekura harton një Plan Strategjik Shumëvjeçar. Këto plane shumëdisiplinore përmbajnë një listë objektivash strategjike që duhen arritur gjatë ciklit katërvjeçar. Treguesit kyç të punës, afatet, synimet dhe agjencitë/personat përgjegjës përfshihen në të gjitha planet. COSI miraton këtë plan duke i dhënë atij një status zyrtar dhe duke siguruar burimet financiare.

### HAPI 3 – Planet Operative të Veprimit dhe Platforma Shumëdisiplinore Evropiane Kundër Kërcënimeve Kriminale (EMPACT)

Secili Plan Strategjik Shumëvjeçar kthehet në Plan Vjetor Operativ Veprimi (POV) sipas prioritetit. Të gjitha këto plane përshkruajnë hapat dhe veprimet e institucioneve dhe agjencive të BE-së, si dhe veprimet që duhen ndërmarrë nga autoritetet kombëtare.

Veprimet e përbashkëta brenda Planeve Operative të Veprimit kryhen në kuadër të mekanizmit të Platformës Shumëdisiplinore Evropiane Kundër Kërcënimeve Kriminale (EMPACT). Ky mekanizëm ofron një platformë bashkëpunimi të strukturuar për shtetet anëtare përkatëse, institucionet dhe agjencitë e BE-së, si dhe për partnerët që nuk janë pjesë e BE-së. Zbatimi i secilit Plan Operativ Veprimi drejtohet vullnetarisht nga një drejtues nga një shtet anëtar i BE-së dhe mbikëqyret në nivel kombëtar nga Koordinatorët Kombëtarë të EMPACT-it (KKE), të caktuar në çdo vend anëtar të BE-së. Europol-i u ofron mbështetje administrative dhe logjistike projekteve të EMPACT-it dhe monitoron ecurinë e tyre. Europol-i gjithashtu cakton Menaxherë Mbështetës të EMPACT-it për të siguruar mbështetje analitike dhe operative për të gjitha prioritetet kundër krimit. COSI miraton Planet Operative të Veprimit dhe monitoron zbatimin e tyre në bazë të raporteve gjashtëmuore.

Të gjitha autoritetet kombëtare të BE-së ftohen dhe nxiten t'i integrojnë Planet e tyre Strategjike Shumëvjeçare dhe Planet e tyre një-vjeçare Operative të Veprimit në proceset e tyre kombëtare të planifikimit dhe në përpjekjet ligjzbatuese kundër krimit të rëndë dhe krimit të organizuar. Edhe agjencitë përkatëse të BE-së nxiten t'i pasqyrojnë përparësitë dhe planet e tyre të veprimit në programet e tyre vjetore të punës.

### HAPI 4 – Rishikimi dhe vlerësimi

Efikasiteti i Planeve Operative të Veprimit dhe ndikimi i tyre në kërcënimet me përparësi rishikohet nga COSI. Raportet vjetore nga drejtuesit kombëtarë dhe vlerësimet e ndërmjetme të Europol-it ofrojnë mundësi për t'i përshtatur apo modifikuar Planet Strategjike Shumëvjeçare nëse është e nevojshme. COSI-t i dërgohet një pasqyrim vjetor i situatës dhe ai kryen një vlerësim të plotë dhe të pavarur në fund të secilit cikël politikash. Mësimet e nxjerra nga ky vlerësim shërbejnë si material për ciklin e radhës të politikave.

### 8.1.2 Metoda Sleipnir për Vlerësimin e Krimit të Organizuar

Metoda Sleipnir është krijuar për të përmirësuar caktimin e përparësive strategjike duke ofruar një mënyrë të besueshme, objektive dhe të bazuar në ekspertizë për analizat e inteligjencës kriminale për të ndihmuar renditjen dhe krahasimin e kërcënimeve të grupeve të krimit të organizuar, si dhe për të evidentuar boshllëqet në informacionet e përpunuara.

Metoda Sleipnir u ofron analistëve të inteligjencës që punojnë me grupet e organizuara kriminale një metodë të plotë dhe transparente për hartimin dhe paraqitjen në mënyrë të mbështetur të rekomandimeve dhe inteligjencës mbi të cilën ata bazohen. Sidoqoftë, korniza dhe matrica që dalin si rezultat i kësaj metode nuk duhet të mbeten të izoluara, por të përdorur në kontekstin e vlerësimeve analitike strategjike që shpjegojnë hollësitë dhe kuptimin e krahasimeve<sup>68</sup>

Fillimisht kanë qenë 19 kriteret osetribute sipas të cilave analizoheshin nivelet e ndryshme të kërcënimeve. Çdo atributi i caktohet një vlerësim – qoftë “nuk dihet” ose nga “zero” deri në “shumë” – në bazë të përmasave të vëzhguara, por varianti i përditësuar i teknikës Sleipnir e ka ulur numrin etributeve në 12. Kjo e ka bërë më efikas procesin e grumbullimit të informacioneve, ndërsa atributet e mbetura përqendrohen në sjellje më lehtë të vëzhgueshme.

Sidoqoftë, duhet kuptuar se metoda Sleipnir është mjet strategjik që përdoret për të përcaktuar prioritetet organizative dhe nuk është hartuar për t'u përdorur si mjet informativ taktik. Metoda Sleipnir bazohet edhe në disa supozime që mund të mos pasqyrohen në lidhjet gjithnjë e më komplekse dhe të sofistikuar të grupeve ndërkombëtare të krimit të organizuar dhe në lidhjet ndërmjet këtyre grupeve dhe organizatave terroriste. Kjo mund të çojë në zhvillimin e përparësive strategjike që përqendrohen më shumë tek organizatat e mëdha dhe të sofistikuar, duke anashkaluar kështu grupet më të vogla që mund të jenë më të rrezikshme me lidhjet e tyre me krimin e huaj të organizuar dhe me terrorizmin.<sup>69</sup> Gjithashtu, Sleipnir bazohet në supozimet që përcaktojnë kërcënimet më të mëdha të perceptuara për shoqërinë kanadeze dhe renditja etributeve mund të mos pasqyrojë detyrimisht realitetin e shoqërive apo juridiksioneve të tjera.

68 Royal Canadian Mounted Police Criminal Intelligence. “Sleipnir Version 2.0, Organized Crime Groups Capability Measurement Matrix.” Royal Canadian Mounted Police (Ottawa, 2011).

69 Ratcliffe, Strang and Taylor (2014: 206-227).


Tabela 8.2 Krahasim i pesë grupeve kriminale duke përdorur modelin Sleipnir

	GRUPI 1	GRUPI 2	GRUPI 3	GRUPI 4	GRUPI 5	SHKALLA E KËRCËNIMIT
Korrupsioni	Orange	Orange	Blue	Orange	Green	E lartë
Dhuna	Orange	Orange	Blue	Light Blue	Light Blue	Mesatare
Infiltrimi	Orange	Orange	Orange	Orange	Light Blue	E ulët
Pastrimi i parave	Orange	Orange	Orange	Orange	Orange	Zero
Bashkëpunimi	Orange	Orange	Orange	Light Blue	Orange	Nuk dihet
Izolimi	Orange	Orange	Orange	Orange	Light Blue	
Monopoli	Orange	Orange	Orange	Orange	Orange	
Sfera e mbulimit	Orange	Orange	Orange	Orange	Green	
Përdorimi i Inteligjencës	Orange	Light Blue	Orange	Light Blue	Orange	
Diversifikimi	Orange	Light Blue	Light Blue	Green	Blue	
Disiplina	Orange	Light Orange	Orange	Light Blue	Orange	
Kohezioni	Green	Green	Blue	Green	Light Blue	

Ndryshimi kryesor ndërmjet kategorive të kërcënimeve ‘zero’ dhe kërcënimeve të një shkalle që ‘nuk dihet’ qëndron tek fakti nëse janë grumbulluar apo jo informacione rreth grupeve përkatëse. Nëse grupi nuk është hetuar në kuadër të inteligjencës kriminale, cilësitë për të cilat nuk ka informacion duhet të shënohen si ‘nuk dihet’. Kategorizimi ‘nuk dihet’ duhet përdorur edhe kur ka arsye për të dyshuar se një grup i caktuar është në gjendje të përbëjë një kërcënim, por nuk ka prova që vërtetojnë se ai grup po vepron realisht me këtë qëllim, apo edhe kur ka informacione kontradiktore rreth aftësisë së grupit dhe kur ky gjykim nuk mbështetet dot me siguri<sup>70</sup>

**Nënpërbërësit e Metodës Sleipnir**

Metoda Sleipnir përmban 12 attribute ose ‘cilësi’, sipas kërcënimit që ato paraqesin për shoqërinë Kanadeze. Kjo metodë shërben për t’i renditur këto cilësi nga ajo që paraqet kërcënimin më të madh për shoqërinë deri tek ajo që paraqet kërcënimin më të vogël. Për shembull, ‘korrupsioni’ shihet si kërcënim më i madh nga krimi i organizuar, kurse i dyti vjen ‘dhuna’.



70 Policia Kanadeze. “Sleipnir, Varianti 2.0”. (2011: 2).

## 8. MODELI PBI NË PRAKTIKË

Më poshtë gjeni renditjen që përshkruan 12 cilësitë (P, shih më poshtë) që përdoren për të vlerësuar grupe të ndryshme kriminale:

12. Korrupsioni
11. Dhuna
10. Infiltrimi
9. Pastrimi i parave
8. Bashkëpunimi
7. Izolimi
6. Monopoli
5. Sfera e mbulimit
4. Përdorimi i inteligjencës
3. Diversifikimi
2. Disiplina
1. Kohezioni

### Vlerësimi me pikë

Secila nga këto 12 cilësi mund të vlerësohet sipas metodës së mëposhtme:

- E lartë = 4 x P
- Mesatare = 2 x P
- E ulët = 1 x P
- Zero = 0
- Nuk dihet = 2 x P

Kur P është numri i nënpërbërësve të listës më lart; për shembull, nëse Monopoli (#6) është i lartë, Përdorimi i inteligjencës (#4) është mesatar, dhe Dhuna (#11) është e ulët, rezultati do ishte si më poshtë:

- Monopoli = 4 x 6 = 24
- Përdorimi i inteligjencës = 2 x 4 = 8
- Dhuna = 1 x 11 = 11

Totali del 43. Vlerat më të larta, krahasuar me organizatat e tjera që vlerësohen, përfaqësojnë kërcënime më të mëdha.

## 8.2. Shembuj të zbatimit të modelit PBI në vende të ndryshme

Nënkapitujt 8.2.1 deri më 8.2.5 ofrojnë shembuj të zbatimit të PBI-së në pesë vende të Evropës. Nënkapitulli 8.2.1 prezanton Modelin Kombëtar Informativ (MKI) të Mbretërisë së Bashkuar (MB), ku PBI-ja është zhvilluar për herë të parë në vitet 90. Zbatimi praktik dhe strukturat organizative të PBI-së në MB janë përdorur që atëherë si model i praktikës së mirë nga shumë vende të botës. MKI-ja pasohet nga një prezantim i shkurtër i politikëbërjes dhe planifikimit strategjik të organeve të zbatimit të ligjit në Rin-Vestfalinë e Veriut në Gjermani, të cilat bazohen tek inteligjenca. Nënkapitulli 8.2.3 prezanton modelin suedez të PBI-së, si dhe përpjekjet e përbashkëta kombëtare të bazuara tek inteligjenca kundër krimit të rëndë dhe krimit të organizuar në Suedi. Republika e Serbisë ka integruar disa dispozita të posaçme të PBI-së në një Ligj të ri të vitit 2016 për Policinë dhe ka hartuar Udhëzuesin e saj Kombëtar për PBI-në për shërbimet ligjzbatuese serbe. Këto masa prezantohen në nënkapitullin 8.2.4. Shembulli i fundit kombëtar përshkruan qasjen malazeze ndaj vlerësimit të kërcënimeve të krimit të rëndë dhe atij të organizuar.

### 8.2.1 Modeli Kombëtar i Inteligjencës i Mbretërisë së Bashkuar

MKI-ja është korniza e zbatimit të PBI-së në MB.<sup>71</sup> Qëllimi i MKI-së është t'i rrisë përqendrimin në policimin operativ dhe të arrijë ndikim shumë të madh duke përdorur burimet që ka në dispozicion. Ajo bazohet në një kornizë të qartë të analizimit të të dhënave dhe informacioneve, duke mundësuar qasje problem-zgjidhës në zbatimin e ligjit dhe teknikat për parandalimin e krimit. Rezultatet që priten janë siguri më e mirë e komunitetit, ulje e nivelit të krimit dhe kontroll i kriminalitetit dhe prishjes së rendit me synim rritjen e sigurisë dhe besimit të publikut. Nuk është se MKI-ja përdoret vetëm nga specialistët. Ajo vlen për të gjitha fushat e zbatimit të ligjit: krimin dhe hetimin e tij, prishje të rendit dhe sigurisë së komunitetit. Në vija të përgjithshme, MKI-ja është model pune për policimin operativ.




Figura 8.2 Modeli Kombëtar i Inteligjencës i Mbretërisë së Bashkuar

Burimi: NCIS (2000: 9).

71 Ky nënkaptull është hartuar në bazë të dy dokumenteve: (i) *Modeli Kombëtar i Inteligjencës i Shërbimit të Inteligjencës Kriminale* (NCIS) (NCIS Corporate Communications, 2000); dhe (ii) the *Kodi i Praktikës –Modeli Kombëtar Informativ i Qendrës Kombëtare të Policimit* (Zyra e Punëve të Brendshme Londër, CENTREX, 2005).

MKI-ja është edhe model vendimmarrjeje menaxherial dhe përshkrim i proceseve dhe produkteve informative. Faktori kryesor që siguron uljen e kimit është roli proaktiv i drejtuesve të organeve të zbatimit të ligjit.

Procesi kryhet në tre nivele: Niveli 1 (komuniteti/niveli lokal), Niveli 2 (ndërmjet strukturave/rajonale) dhe Niveli 3 (kombëtar/ndërkombëtar).

Në secilin prej këtyre niveleve, proceset dhe lloji i produkteve e inteligjencës janë gati të njëjta, edhe pse përmbajtja e hollësishme e produkteve dhe e llojit të të dhënave që përdoren dhe përpunohen është e ndryshme. Kjo ngjashmëri përgjatë modelit theksohet qëllimisht për t'i ndihmuar profesionistët e niveleve të ndryshme që t'i kuptojnë ato më mirë.

MKI-ja funksionon dhe si sistem i veçuar për një nivel veprimtarie dhe si model i integruar, ku në secilin nivel bashkëvepron me të tjerët për të evidentuar më mirë problemet dhe zgjidhjet e mundshme. Modeli përshkruan secilën njësi të inteligjencës së një niveli dhe cakton kërkesat për inteligjencë. Standardizimi i produkteve të inteligjencës ofron bazat më të mira për arritjen e inteligjencës, por kërkon sisteme qasjeje që i mundësojnë secilës njësi inteligjence përdorimin e të dhënave që ruhen nga kolegët e tyre.

Produkti më i rëndësishëm i Nivelit 3 është *Vlerësimi Vjetor i Kërcënimeve të Mbretërisë së Bashkuar, me titull Vlerësimi Strategjik Kombëtar (VSK) për Krimin e Rëndë dhe Krimin e Organizuar*. Ai prodhohet nga Agjencia Kombëtare e Krimeve të Mbretërisë së Bashkuar dhe përpunon të dhënat e ofruara nga forcat e policisë, doganat, agjencitë e inteligjencës dhe të sigurisë dhe organet e tjera për zbatimin e ligjit.

VSK-ja ofron një panoramë të plotë të rrezikut që i kanoset Mbretërisë së Bashkuar dhe interesave të saj nga krimi i rëndë dhe ai i organizuar. Ajo ofron reagimin kombëtar dhe informacione rreth përparësive, veprimeve që duhen ndërmarrë, rezultateve të pritshme dhe mënyrës sipas së cilës do të matet suksesi.

Grupet për Ndarjen dhe Koordinimin e Detyrave, të cilët takohen në të tre nivelet, ndodhen në qendër të MKI-së. Takimet e këtyre grupeve ndahen në *Takime për Ndarjen dhe Koordinimin e Detyrave në Nivel Strategjik dhe në Takime për Ndarjen dhe Koordinimin e Detyrave në Nivel Taktik*. Qëllimi i këtyre takimeve është të bihet dakord për një Strategji Kontrolli që përcakton kërkesat për inteligjencë dhe programin për përparësitë informative, parandaluese dhe zbatimin e ligjit, me qëllim arritjen e një ndikimi maksimal. Në këtë kuadër, drejtuesit për zbatimin e ligjit duhet të kuptojnë mirë natyrën e problemeve me të cilat përballen dhe mekanizmin e vendimmarrjes që evidenton përparësitë, burimet e nevojshme dhe që mund të ndërmarrin veprime. Procesi i ndarjes dhe koordinimit të detyrave është vetë mekanizmi.

NDARJA E DETYRAVE DHE KOORDINIMI




Figura 8.3 Proceset e Ndarjes dhe Koordinimit të Detyrave në Nivel Strategjik dhe Taktik në Mbretërinë e Bashkuar

Burimi: NCIS (2000: 14).

**Ndarja e detyrave në nivel strategjik**

Objektivat e takimeve për ndarjen dhe koordinimin e detyrave në nivel strategjik janë krijimi apo ndryshimi i strategjisë së kontrollit dhe gjetja e burimeve kryesore në përputhje me përparësitë. Grupi për ndarjen dhe koordinimin e detyrave në nivel strategjik takohet çdo tre ose gjashtë muaj dhe e përshtat ciklin e tij me planifikimin e punës. Puna e grupit kryhet në bazë të problemeve dhe çështjeve të identifikuara nga Vlerësimi strategjik (VSK), i cili, pasi shihet në pikëpamjen e objektivave qendrorë dhe vendorë, përdoret për të përcaktuar përparësitë informative, zbatuese dhe parandaluese. Kjo punë plotësohet me caktimin e burimeve dhe të politikave që nevojiten për zbatimin e strategjisë së kontrollit.

**Ndarja e detyrave në nivel taktik**

Grupi për ndarjen dhe koordinimin e detyrave takohet çdo javë apo çdo dy javë. Ai ka tre role kryesore: caktimin dhe zbatimin e agjendës taktike të Strategjisë së kontrollit; përgjigjen ndaj nevojave të reja; dhe marrjen e masave që planet e miratuara dhe puna zbatuese të arrijnë të përmbushin objektivat. Raporti vlerësues taktik është produkti kryesor i inteligjencës ku bazohet vendimmarrja taktike.

Qëllimet taktike përmbajnë katër elemente:

- piketimin e autorëve të veprave penale në përputhje me përparësitë e Strategjisë së Kontrollit;
- menaxhimin e pikave të nxehta të krimit dhe probleme me rendin;
- hetimin e krimeve dhe incidenteve që mund të lidhen në 'seri';
- aplikimin e "masave parandaluese" si vendosjen e kamerave regjistruese CCTV apo skemave të ndriçimit dhe nismave të komuniteteve.

Monitorimi i ecurisë dhe nxitja e punës në të katër pjesët e agjendës taktike, është thelbi i programit të Takimit për ndarjen dhe koordinimin e detyrave në nivel taktik.

Proceset e ndarjes dhe koordinimit të detyrave në nivel strategjik dhe taktik që bazohen tek inteligjenca mbështeten në katër raporte kryesore informative që përshkruhen shkurtimisht poshtë.

### Vlerësimet strategjike

Qëllimi kryesor i raportit të vlerësimit strategjik është t'i japë grupit të Ndarjes dhe koordinimit të detyrave një panoramë të saktë të situatës brenda fushës së përgjegjesisë dhe se si po ndryshon dhe mund të ndryshojë në të ardhmen kjo panoramë. Është vëzhgim afatgjatë dhe i nivelit të lartë i problemeve të zbatimit të ligjit dhe prandaj nuk merr parasysh vetëm veprimtaritë e momentit, por përpiqet të parashikojë zhvillimet që mund të ndodhin. Një vlerësim strategjik i krijuar në nivel lokal ndihmon planifikimin dhe hartimin e politikës dhe jep kontribut për një panoramë më të gjerë të modeleve dhe tendencave rajonale dhe kombëtare.

### Vlerësimet taktike

Vlerësimi taktik krijon bazën e punës së Grupit të ndarjes dhe koordinimit të detyrave në nivel taktik. Ky vlerësim është i aftë të identifikojë modelet që shfaqen dhe tendencat që kërkojnë vëmendje, duke përfshirë analiza të mëtejshme. Ecuria e hetimeve apo nismave parandaluese mund të tregojnë nevojën për të ndryshuar zgjedhjet taktike.

### Profilat e objektivave

Profili i objektivit është i posaçëm për një person dhe përmban hollësi të mjaftueshme për të nisur një hetim/operacion ndaj objektivit ose për të ndihmuar një operacion të ndërmarrë ndaj një individi apo një grupi individësh. Ai tregon lidhjet me hetimet e tjera (në të gjitha nivelet e modelit) dhe mund të përfshijë profilet e rrezikut të autorëve të veprave penale që janë potencialisht të rrezikshëm. Në bazë të inteligjencës, profili i objektivit përmban interpretimin e linjës më të mirë të veprimit dhe propozime për të mbushur boshllëqet e informacioneve të përpunuara.

### Profilat e problemit

Profilat e problemit identifikojnë seritë ekzistuese apo në shfaqje e sipër të krimeve apo incidenteve. Ato gjithashtu evidentojnë "pikat e nxehta" kriminale dhe të incidenteve së bashku me mundësitë për të bërë punë parandaluese siç tregohet nga informacionet e përpunuara. Në rastin e identifikimit të serive të krimeve, kur metodat konfirmohen dhe shihen lidhjet me autore potencialë të veprave penale, profili mbështet hetimin piketues dhe reagues si dhe nismat parandaluese.



### Njësitë e Inteligjencës – përparësitë e punës informative

Për një njësi inteligjence efektshme dhe e sigurt janë katër asete kryesore që përshkruhen më poshtë: burime të përshtatshme informacioni, staf të organizuar mirë dhe të aftë, qasje në produktet e njohurive dhe në produktet e sistemit.

#### Burimet e informacionit

Burimet ku duhet të kenë qasje stafet informative kanë diapazon të gjerë dhe përfshijnë viktimat, dëshmitarët, të burgosurit, informatorët dhe produktet e përgjimeve. Një regjim informativ i pajisur mirë është i aftë të ketë qasje në një diapazon të gjerë të dhënash ekzistuese, si dhe të ndërmarrë rekrutim proaktiv të burimeve dhe zhvillime për të mbushur boshllëqet e evidentuara në informacionin e përpunuar.

#### Stafi

Aseti i dytë që nevojitet janë njerëzit. Është shumë e rëndësishme që të caktohet një drejtues informativ me status të përshtatshëm si drejtues njësie në mënyrë që t'i jepet kuptim dhe vlerë teknike analitike dhe produkteve përpara se t'i prezantohen grupit të ndarjes së detyrave dhe koordinimit.

Është po aq e rëndësishme që disiplina informative të përfaqësohet në mënyrë të përshtatshme në diskutimet drejtuese për burimet financiare dhe njerëzore. Njësitë e inteligjencës duhet jo vetëm të jenë të pajisura me të dhënat dhe informacionet e ditura, por duhet gjithashtu të kenë mundësinë të mbledhin informacione me anë të mjeteve proaktive ose të fshehura. Shpesh evidentohen boshllëqet në informacionet e përpunuara, të cilat nuk mund të plotësohen me analiza dhe shqyrtime të materialeve në dispozicion. Njësitë e inteligjencës duhet të kenë aftësitë dhe kapacitetin të menaxhojnë burimet dhe mundësinë për operacione të përgjimit teknik.

Për të arritur standardet sipas modelit, nevojiten analistë të trajnuar. Teknikat analitike dhe produktet janë pjesë e një diapazoni standard që përforcon trajnimin profesional kombëtar për analistët e zbatimit të ligjit.

#### Produktet e njohurive

Modeli vlerëson që inteligjenca si disiplinë ka nevojë të mësohet. Stafi ka nevojë për qasje në produktet e njohurive që i japin siguri cilësore modelit. Këto produkte kombëtare dhe vendore të njohurive përcaktojnë rregullat e sjelljes ose praktikën më të mirë sipas të cilës realizohen proceset komplekse dhe kushtet sipas të cilave mund të punohet ndërmjet agjencive të ndryshme. Qasja në produktet e njohurive e bën stafin të jetë i përshtatshëm për rolin e vet. Prandaj, termi 'produktet e njohurive' përshkruan një larmi informacionesh dhe rregullash vendore, rajonale, dhe kombëtare që duhen përqafuar nga strategjia e inteligjencës së një organizate.

#### Produktet e sistemit

Produktet e sistemit janë ambiente mundësuese për mbledhjen, marrjen, ruajtjen dhe përdorimin e informacionit. Ato ofrojnë mjetet me anë të së cilave të dhënat mbahen, merren dhe analizohen. Sipas MKI-së, njësitë efikase të inteligjencës duhet të kenë qasje në disa sisteme kombëtare të dhënash, dosje të policisë lokale, të dhëna kriminale dhe informacione të përpunuara dhe në larminë e gjerë të informacioneve me burim të hapur<sup>72</sup>

72 Për informacione të hollësishme për produktet e sistemit për njësitë e inteligjencës, shih NCIS (2000).

### Siguria

Integriteti i MKI-së kërkon standarde të përshtatshme të sigurisë fizike, mjedisore, teknike dhe të personelit. Politika e Klasifikimeve të Sigurisë të Qeverisë ofron standarde të përbashkëta për mbrojtjen e dokumenteve me ndjeshmëri të lartë dhe materialeve të tjera të agjencive të qeverisë. Parimet e saj vlejnë dhe për të dhënat që ruhen në kompjuter dhe në sisteme elektronike regjistrimi.

### Mbrojtja e të dhënave

Efektivët e Lartë janë përgjegjës për zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të përshtatshme dhe sistemeve që sigurojnë se informacionet personale të individëve ruhen në përputhje me kërkesat e Ligjit të Mbretërisë së Bashkuar për Mbrojtjen e të Dhënave, te vitit 1998, dhe me ligjet e tjera përkatëse. Administrimi i informacioneve duhet të kryhet në përputhje me Kodin e Praktikës për Administrimin e Informacionit Policor.

### 8.2.2 Hartimi i politikave dhe planifikimi strategjik

Policia e Shtetit në Ren-Vestfalinë Veriore në Gjermani aplikon Policimin me Bazë Inteligjencën (PBI), përfshirë hartimin e politikave dhe planifikimin strategjik<sup>73</sup> Sistemi i menaxhimit dhe kontrollit të strategjive bazohet në katër shtylla që përfaqësojnë detyrat bazë të Policisë së Shtetit:

- Parandalimi i rrezikut dhe reagimi në rast emergjencash (Rr&E);
- Lufta kundër krimit (Hetimi);
- Lufta kundër aksidenteve rrugore (Trafiku);
- Shërbimet administrative (ShA).

Të 47 autoritetet policore rajonale (APR) në Ren-Vestfalinë Veriore (RVV), edhe pse me përmasa të ndryshme, kanë strukturë organizative identike që konsiston në katër drejtori, ku secila merret me detyrat përkatëse dhe ka një personel shtesë që mbështet titullarin e autoritetit policor.

Në aspektin strategjik, Ministria e (Punëve të) Brendshme (MB) identifikon prioritetet kombëtare në secilën fushë të katër shtyllave të përmendura më lart (strategji për çdo fushë). Prioritetet formulohen, vlerësohen periodikisht dhe përditësohen në bazë të analizës së informacionit dhe të dhënave që krahasohen dhe kontrollohen ndërmjet dy agjencive shtetërore. Me këtë proces bëhet edhe akordimi i burimeve dhe buxhetit për APR-të sipas ngarkesës.


Shembuj i prioriteteve potenciale:

- (Rr&E) Qasja dhe aksesimi në Polici;
- (Hetimi) Ulja e kriminalitetit të të miturve;
- (Trafiku) Ulja e aksidenteve nga të moshuarit;
- (ShA) Disponueshmëria e Personelit në APR.

---

73 Autoriteti përgjegjës: Landesamt für Zentrale Polizeiliche Dienste NRW, Duisburg, Gjermani.




**POLITIKËBËRJA DHE PLANIFIKIMI STRATEGJIK**



FPS: Faktorët e Përgjithshëm të Suksesit

FVS: Faktorët e Veçantë të Suksesit

Figura 8.4 Hartimi i politikave dhe planifikimi strategjik bazuar tek Inteligjenca në Policinë e Shtetit të Ren-Vestfalisë Veriore, Gjermani



Për secilin prioritet, Ministria e Punëve të Brendshme përcakton **Faktorët e Përgjithshëm të Suksesit (FPS-të)** që përmbajnë një grup standardesh, procedurash dhe treguesish aplikimi i të cilave është i detyrueshëm për të gjitha APR-të. Ato duhet të përfshihen në **Programin Vjetor të Sigurisë** së APR-ve, e cila përshkruan edhe prioritetet dhe objektivat vendore të APR-ve, si edhe masat dhe përgjegjësitë. Standardet, procedurat dhe treguesit rajonalë të detyrueshëm quhen **Faktorët të Veçantë të Suksesit (FVS-të)**. Secila drejtori APR ka detyrimin të kontribuojë në arritjen e objektivave të tre drejtorive të tjera.

Në emër të Ministria e Punëve të Brendshme, dy agjencitë shtetërore (Byroja Shtetërore e Hetimeve dhe Byroja Shtetërore e Shërbimeve Teknike Policore) ngarkohen me kontrollin dhe vlerësimin periodik të aktiviteteve në terrenin e APR-ve, të cilat dokumentohen edhe në të ashtuquajturin Bilanc Sigurie, i cili është dokumenti vjetor i çdo APR-je. Formatit dhe strukturës, si e Programit të Sigurisë, ashtu edhe e Bilancit të Sigurisë, janë të përcaktuara dhe identike për të gjitha APR-të. Ato përbëjnë bazën e procesit të marrjes së vlerësimeve dhe ndërhyrjes që përfshin, ndër të tjera, nxitjen dhe mbështetjen e praktikave më të mira. APR-të kanë ngritur edhe grupe krahasuese me të dhëna strukturore përkatëse, me qëllim intensifikimin e shkëmbimit të përvojës.

### **Avantazhet e modelit të përshkruar:**

- fokusim te detyrat bazë duke pas parasysh kufizimet me burimet dhe buxhetin
- rritja e “pronësisë” dhe përgjegjësisë lokale të APR-së, duke mbajtur parasysh objektivat kombëtarë;
- standardizim i sistemit të raportimit dhe kontrollit në nivel kombëtar;
- krahasim më i mirë mes APR-ve.

### **8.2.3 Suedi: Strukturat organizative dhe vendimmarrëse sipas modelit PBI në Suedi**

Policia Suedeze iu nënshtrua një reforme të thellë në vitin 2015, nga 21 Autoriteti Policor të pavarur ku secila drejtohej nga një strukturë drejtuese në Bordin Kombëtar të Policisë, u krijua një Autoritet Policor Kombëtar të kryesuar nga Komisionari Kombëtar i Policisë, i ndarë në shtatë rajone policore dhe Departamenti Kombëtar i Operacioneve. Këto ndryshime organizative përfshinë edhe krijimin e një strukture të re dhe të proceseve të bashkëpunimit dhe koordinimit për PBI-në në Suedi në nivel strategjik kombëtar, nivel operacional kombëtar, nivel strategjik rajonal, nivel operacional rajonal dhe nivel operacional vendor. Struktura organizative e modelit suedez të PBI-së është komandë dhe kontroll nga lart poshtë. Në të gjitha takimet e grupeve drejtuese të secilit nivel merr pjesë një përfaqësues i nivelit të më poshtëm, me qëllim që të sigurohet koordinimi dhe shkëmbimi i informacionit mes niveleve.

*Grupi Drejtues Strategjik Kombëtar (GDSK)* kryesohet nga Komisionari kombëtar i policisë. Përfaqësuesit e tjerë janë shtatë komisionarët e policisë rajonale, kryetari i Departamentit kombëtar të operacioneve dhe titullarët e departamenteve kombëtare të tjera, përfshirë financën, komunikimin dhe burimet njerëzore. GDSK bën takime me video-konferencë çdo dy javë dhe mbledhje tradicionale çdo muaj. Përgjegjësitë kryesore të GDSK-së janë diskutimi dhe vendimmarrja për drejtimet dhe planet kombëtare strategjike, si edhe përcaktimi i fushave prioritare afatgjatë, përfshi shpërndarjen e burimeve, bazuar në vendimet, raportet strategjike dhe vlerësimet e qeverisë.





Figura 8.5 Strukturat organizative dhe vendimmarrëse të modelit suedez PBI

*Grupi Drejtues Operativ Kombëtar (GDOK)* kryesohet nga kryetari i Departamentit Kombëtar të Operacioneve. Përfaqësuesit e tjerë janë zv.shefat e shtatë rajoneve policore, kryetari i Divizionit Kombëtar të Planifikimit Operativ dhe kryetari i Departamentit Kombëtar të Mjekësisë Ligjore. Kryetari Operativ i Shërbimit Suedez të Sigurisë dhe kryetari i Departamentit Kombëtar të Prokurorisë Publike nga Autoriteti i Prokurorëve Suedez marrin pjesë në mbledhje si vëzhgues. GDOK zhvillon mbledhje me video-konferencë çdo dy javë dhe mbledhje tradicionale çdo muaj. Përgjegjësitë kryesore të GDOK-së janë t'ju japin prioritet aksioneve, operacionet dhe hetimet kombëtare, bazuar në inteligjencën e Njësisë Kombëtare të Inteligjencës Kriminale që funksionon brenda Departamentit Kombëtar të Operacioneve pranë Autoritetit të Policisë Kombëtare Suedeze.

*Grupet Drejtuese Strategjike Rajonale (GDSR)* kryesohen nga komisionarët policorë rajonalë të secilit prej shtatë rajoneve policore. Përfaqësuesit e tjerë janë kryetarët e secilës zonë policore të rajonit dhe kryetarët e burimeve njerëzore, financës, komunikimit, zhvillimit, si edhe të njërive rajonale hetimore dhe operative, ndër të tjerë. GDSR-të kanë mbledhje çdo dy javë. Përgjegjësitë kryesore të GDSR-ve janë të diskutojnë dhe të marrin vendime për planet dhe drejtimit strategjike rajonale, si edhe të vendosin fushatë prioritare afatgjate, përfshirë shpërndarjen e burimeve, bazuar në vendimet kombëtare të GDOK-së si edhe vlerësimet e raportet strategjike.

*Grupet Drejtuese Operative Rajonale (GDOR)* kryesohen nga nënkryetarët e secilit prej shtatë rajoneve policore. Përfaqësuesit e tjerë janë kryetarët e Grupeve Operative Vendore (GOV) në secilën zonë policore në rajon dhe kryetarët e njërive rajonale hetimore dhe operative, ndër të tjera. Kryetari i secilës njësi rajonale të inteligjencës vepron si relator i GDOR-ve, që zhvillon mbledhje çdo dy javë. Përgjegjësitë kryesore të GDOR-ve janë prioritizimi i aksioneve, operacioneve dhe hetimeve rajonale, bazuar në informacionin e disponueshëm dhe raportet me inteligjencë të grumbulluar prej njërive rajonale të inteligjencës. GDOR mund të marrë vendimin që t'i drejtojë aksionet e propozuara të nivelit vendor dhe mund të kërkojë mbështetje operative dhe inteligjencë nga niveli kombëtar (GDOK).

*GOV-ët* kryesohen nga komisionarët e policisë vendore. Anëtarët e tjerë janë drejtuesit e zonave policore nënvendore dhe kryetarët e njërive hetimore dhe operative vendore. Kryetarët e grupeve të inteligjencës vendore veprojnë si relatorë të GOV-it që zhvillon mbledhje çdo javë. Përgjegjësitë kryesore të GOV-it përfshijnë marrjen e vendimeve për aksione, operacione dhe hetime vendore bazuar në raportet nga Njësia e Inteligjencës vendore. GOV mund të kërkojë mbështetje operative dhe inteligjencë nga niveli rajonal (GDOR).



### Përpjekjet e Përbashkëta Kombëtare të strukturave të Inteligjencës dhe Operative në Suedi kundër krimit të organizuar

Në vitin 2009, nëntë autoritete publike suedeze nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi që të ndërmarrin përpjekje të përbashkëta inteligjence dhe operative për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar. Zbatimi i kësaj nisme kombëtare u shtri në vitin 2016 edhe në nivel rajonal dhe vendor. Puna zhvillohet paralelisht dhe është e lidhur me strukturat zbatuese të PBI-së të përshkruara më lart.

Këto aksione të përbashkëta janë masa specifike inteligjence, operative dhe hetimore, por përbëjnë vetëm një pjesë të përpjekjeve të përgjithshme të Autoritetit Policor Suedeze dhe të autoriteteve bashkëpunuese në luftën kundër krimit të organizuar.

12 agjencitë/autoritetet kombëtare më poshtë marrin pjesë dhe kontribuojnë në përpjekjet e përbashkëta kundër krimit të organizuar:

- Policia Kombëtare Suedeze
- Zyra Kombëtare e Punësimit
- Autoriteti i Krimit Ekonomik
- Agjencia e Sigurimeve Shoqërore
- Shërbimi i Burgjeve dhe Provës
- Autoriteti Ekzekutues
- Bordi i Migrimit
- Roja Bregdetare Suedeze
- Agjencia e Tatimeve
- Shërbimet e Sigurisë
- Doganat
- Prokuroria






Figura 8.6 Përpyekjet e Përbashkëta Kombëtare të strukturave të Inteligjencës dhe Operative në Suedi kundër krimit të organizuar



Të gjitha këto 12 agjenci kombëtare marrin pjesë dhe bashkëpunojnë në forumin ndërinstitucional *Këshilli i Bashkëpunimit*, i përbërë nga kryetarët e secilës agjenci / autoritet bashkëpunues dhe kryesohet nga Komisioneri Kombëtar i Policisë Suedeze. Detyra parësore e këtij Këshilli është të marrë vendime për një strategji të përbashkët kundër krimit të organizuar në Suedi. Këshilli zhvillon takime dy herë në vit. Për qëllime koordinimi dhe shkëmbim informacioni, kryetari i strukturës më poshtë (Këshilli Operativ) vepron si raportues.

Nën Këshillin e Bashkëpunimit është *Këshilli Operativ*, detyra kryesore e të cilit është t'i bëjë prioritet dhe operativ vendimet strategjike që merr Këshilli i Bashkëpunimit. Këshilli Operativ që zhvillon mbledhje çdo muaj, merr vendime edhe për përdorimin e Grupeve Operative të Veprimit dhe burimet e tjera në detyrat e përbashkëta hetimore apo operative. Secila nga 12 agjencitë / autoritetet ka një përfaqësues në Këshillin Operativ që kryesohet nga kryetari i Departamentit Kombëtar të Operacioneve pranë Autoritetit Kombëtar Policor; kjo garanton lidhje të dy strukturave dhe qarkullim informacioni.

*Sekretariati* mbështet këshillat operativ dhe bashkëpunues dhe proceset e tyre. Detyrë kryesore ka planifikimin, përgatitjen dhe paraqitjen e propozimeve për vendime, mbajtjen e procesverbaleve dhe garantimin e ndjekjes së mbledhjeve të Këshillave Operativ dhe Bashkëpunues. Sekretariati ka edhe rol koordinues dhe është përgjegjës për procesin në lidhje me grupet e veprimit.

*Këshillat e Bashkëpunimit Rajonal* në të shtatë rajonet e vendit kanë detyrë kryesore ngritjen e aksioneve të përbashkëta në nivel vendor dhe rajonal. Mbledhjet i zhvillojnë çdo katër javë dhe raportojnë te Këshilli Operativ përmes Sekretariatit.

Entet brenda përpjekjeve të përbashkëta mbështeten nga struktura inteligjence të përbëra nga Qendrat Rajonale të Inteligjencës, që janë struktura ndërinstitucionale, me seli në shtatë rajonet policore, si edhe nga Qendra Kombëtare e Inteligjencës, edhe kjo strukturë ndërinstitucionale, pranë Departamentit Kombëtar të Operacioneve. Këto qendra që përfaqësohen nga 11 agjenci / autoritete bashkëpunuese,<sup>74</sup> kontribuojnë në përpjekjet e përbashkëta me shërbime analitike dhe produkte inteligjence. Sipas ligjit të 2016-ës, këto agjenci/autoritete jo vetëm lejohen, por e kanë detyrim shkëmbimin e të dhënave, informacionit dhe inteligjencës për detyra inteligjence që kryhen brenda forumit, kur trajton aktivitet kriminal të rëndë i kryer në mënyrë të organizuar dhe sistematikisht në bashkëpunim.

*Grupet Operative të Veprimit* përbëhen nga 200 punonjës të forcave ligj zbatuese. Grupet janë të ndara në seksione prej 20 ose 30 oficerësh, me seli në shtatë rajonet policore si dhe në Departamentin Kombëtar të Operacioneve. Secila njësi ka një kryetar/drejtues grupi, hetues, analistë dhe administratorë. Grupet e veprimit bashkëpunojnë çdo ditë edhe me burimet shumëdisiplinare të autoriteteve të tjera bashkëpunuese, si skuadra të përbashkëta në aksione (veprime) të vendosura prej Këshillit Operativ.

74 Prokuroria suedeze nuk është e përfaqësuar në Qendrat e Inteligjencës, sepse prokuroria nuk zotëron dhe nuk përpunon informacione.

### 8.2.4 Republika e Serbisë: strukturat operative dhe të inteligjencës të PBI-së

Ministria e Brendshme e Republikës së Serbisë vendosi të zbatojë PBI-në në Serbi për të përmirësuar zbatimin e ligjit dhe për të rritur rezultatet në luftën kundër krimit dhe kërcënimeve të tjera ndaj sigurisë në nivel të lartë, si edhe për të harmonizuar fuqinë policore me standardet, strukturën, cilësinë dhe terminologjinë e forcave policore të vendeve të zhvilluara në Evropë dhe në botë. Në këtë drejtim, Serbia miratimin Ligjin e ri për Policinë në 2016-ën, që përcakton PBI-në dhe udhëzon si të aplikohet në praktikën e policimit në Serbi.

### Ligji për Policinë

#### Neni 34

#### Modeli i Inteligjencës Policore

“Në kryerjen e detyrave policore, Policia aplikon modelin e policimit me bazë inteligjencën (PBI). PBI është një model menaxhimi i punës policore bazuar në inteligjencën kriminale.

Inteligjenca kriminale është një grup të dhënash të mbledhura, të vlerësuara, të përpunuara dhe të analizuar, që shërben si bazë për marrjen e vendimeve të informuara në lidhje me kryerjen e detyrave policore.”.

- **Ministria e Brendshme e Republikës së Serbisë. “Dekreti për shpalljen e Ligjit për Policinë.” PR nr. 1, Beograd, 28 janar, 2016.**

Ligji për Policinë përcakton dhe sqaron rolet dhe përgjegjësitë e strukturave të ndryshme policore si dhe nivelet në menaxhimin e elementëve kyç të modelit PBI, përfshirë hartimin e Vlerësimit Strategjik të Sigurisë Publike, si edhe planeve strategjike dhe operative, të cilat përcaktojnë prioritetet dhe objektivat e policisë bazuar në Vlerësimin Strategjik.<sup>75</sup>

Pas një studimi të thelluar të modeleve PBI si ai i Mbretërisë së Bashkuar, i SHBA-së, i Kanadasë, Australisë dhe Suedisë, Ministria e Brendshme serbe hartoi një model të PBI-së që është plotësisht i përshtatur me specifikat e sistemit policor në Republikën e Serbisë. Modeli PBI serb përshkruhet në Udhëzuesin Kombëtar PBI<sup>76</sup> dhe përfshin këta kapituj:

- Struktura e Modelit PBI në Republikën e Serbisë
- Udhëheqja dhe Orientimi i Niveleve Strategjike dhe Operative
- Procesi dhe Praktikata e Inteligjencës Kriminale
- Detyrat e Inteligjencës Kriminale (planifikimi, grumbullimi, përpunimi, analiza dhe qarkullimi i informacioneve)
- Planifikimi i Policimit Operativ (zbatimi)
- Siguria dhe Modeli PBI
- Punonjësit dhe Njësitë përgjegjëse për Çështjet e Inteligjencës Kriminale
- Zhvillimi dhe Trajnimi i Personelit
- Sistemet e Informacionit dhe Komunikimit.

75 Ligji për Policinë (2016); neni 24 (roli dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Policisë në Ministrinë e Brendshme); neni 25 (detyrat dhe aktivitetet kryesore të departamenteve policore).

76 Ministria e Brendshme e Republikës së Serbisë (2016)..

Në udhëzuesin serb, termi “policim me bazë inteligjencën” i referohet një sistemi dhe metodologjie për administrimin e inteligjencës kriminale dhe punës së planifikuar policore operative, ku inteligjenca shërben si bazë për përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave strategjikë e operative në parandalimin dhe goditjen e krimit dhe kërcënimeve të tjera ndaj sigurisë. Gjithashtu, është baza për marrjen e vendimeve të përshtatshme për punën dhe aksionet policore operative, angazhimin racional të burimeve njerëzore në dispozicion, si edhe për shpërndarjen e burimeve materiale dhe teknike.

Ministria e Brendshme serbe po e zbaton modelin PBI në praktikatat e policimit në Serbi. Autoriteti Policor Suedez dhe Agjencia Ndërkombëtare Suedeze e Bashkëpunimit për Zhvillim i kanë dhënë mbështetje policisë serbe në procesin e zbatimit që nga fillimi. Për hartimin e modelit serb të PBI-së, u përgatit një analizë boshllëqesh për të evidentuar aktivitetet konkrete që duhen marrë për sa i përket përshtatjes së kuadrit ligjor, strukturës organizative, si dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore dhe TIK. Janë miratuar shumë dokumente rregullatore që i përkasin PBI-së. Janë miratuar edhe Vlerësimi Strategjik i Sigurisë Publike që mbulon një periudhë prej pesë vitesh dhe Vlerësimi Kombëtar i Kërcënimeve nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar. Po ashtu, janë ngritur edhe burimet njerëzore të ngarkuara me zbatimin e PBI-së. Plani është që PBI të zbatohet plotësisht nga Ministria e Brendshme e Republikës së Serbisë deri në vitin 2018.

PBI-ja serbe është model i hartuar për të menaxhuar të gjithë punën e policisë, jo thjesht punën e fokusuar në parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar.

*Kushtet e nevojshme* për funksionimin efektiv të modelit PBI, sipas Ministrisë së Brendshme dhe Udhëzuesit të PBI-së janë:

1. *Udhëheqja dhe orientimi* – Ky është funksion kyç i modelit që shtrihet në nivel strategjik e operativ dhe kryhet në përputhje me një metodologji të përcaktuar dhe sistemin e përgjegjësisë.
2. *Procesi i sistematizuar i inteligjencës kriminale* – Procesi i plotë i inteligjencës kriminale në praktikë duhet të strukturohet në nën-procese (detyra), funksione dhe aktiviteteve që ose janë të lidhura reciprokisht, ose kryhen në të njëjtën kohë.
3. *Strukturë organizative efikase* – Njësitë dhe nën-njësitë organizative që janë të angazhuara në inteligjencën kriminale dhe punën operative policore ngrihen të tilla që të jenë në përputhje me proceset dhe funksionet e përcaktuara (proceset dhe funksionet e ngjashme kryhen brenda të njëjtës njësi organizative).
4. *Burimet e të dhënave dhe informacionit* – Të gjitha burimet e hapura dhe të mbyllura duhet të identifikohen dhe të përdoren me efikasitet me qëllim grumbullimin e të dhënave dhe informacionit.
5. *Fokusimi te problemet më të vështira të sigurisë* – Duhet vendosur prioritete mes krimit të organizuar, korrupsionit dhe veprave të tjera penale të rënda, bashkë me autorët e tyre (organizatorët dhe ekzekutuesit).
6. *Produktet e inteligjencës kriminale* – Në përputhje me metodologjinë e përcaktuar për kryerjen e punës së inteligjencës kriminale dhe kriteret e cilësisë të përcaktuara, Njësia për Çështjet e Inteligjencës Kriminale prodhon produkte inteligjence që janë parakusht për formulimin e duhur të objektivave, përcaktimin e prioriteteve dhe vendimmarrjen për kryerjen e punës policore.
7. *Korrniza ligjor* – Duhet të parashikohet një kuadër i përshtatshëm ligjor me qëllim që PBI të funksionojë me sukses.

8. *Burimet njerëzore* – Efektiviteti e policisë duhet të përzgjidhen me kujdes (sipas kritereve dhe procedurave të posaçme) dhe të trajnohen për kryerjen e punës së inteligjencës kriminale.
9. *Burimet teknike* – Bazat e të dhënave dhe teknologjia e informacionit, ambientet e përshtatshme, pajisjet dhe mjetet teknike janë të elementë të nevojshëm për modelin PBI.
10. *Koha si burim* – Duhet kohë dhe durim për të ndryshuar kulturën organizative dhe mënyrën e të punuarit.

Siç tregon Figura 8.7, zbatimi i PBI-së përbëhet nga tre nën-procese që përbëjnë fluksin e aktiviteteve në formën e numrit tetë. Këto nën-procese janë: (1) udhëheqja dhe orientimi (blu); (ii) puna e inteligjencës kriminale (e bardhë); dhe (iii) puna e planifikuar operative policore (e kuqe). Nën-procesi i nivelit të mesëm, udhëheqja dhe orientimi, luan rol menaxherial (drejtim dhe koordinim) me nën-proceset e tjera. Së pari, brenda nën-procesit 'udhëheqja dhe orientimi', drejtuesit përkatës fillojnë (kërkojnë) zbatimin e punës së inteligjencës kriminale. Bazuar në ndarjen e detyrave dhe kërkesave, aktivitetet konkrete të inteligjencës planifikohen dhe zbatohen, ndërsa rezultatet paraqiten në një raport. Së dyti, mbi bazën e këtij raporti, drejtuesit marrin vendime për zbatimin e punës së planifikuar operative policore. Së treti, bazuar në këto vendime, aktivitetet konkrete operative policore planifikohen dhe zbatohen, të pasuar nga një raport vlerësimi. Skema e procesit të inteligjencës kriminale (me të bardhë) mund të përfundojë pas një cikli, ose të përsëritet (plotësohet me masa shtesë) në disa cikle, në varësi të suksesit në trajtimin e kriminit dhe rrethana të tjera.




Figura 8.7 Modeli PBI i Serbisë

Burimi: Ministria e Brendshme, Republika e Serbisë.



Strukturat organizative PBI të Serbisë ndajnë vendimmarrjen, udhëheqjen, orientimin dhe koordinimin në tre nivele: kombëtare, rajonale dhe vendore. Në përputhje me parimet PBI, secili nivel ka nivelin vendimmarrës bazuar në produktet e inteligjencës kriminale strategjike dhe operative, duke inkuorporuar analizën dhe vlerësimet në të gjitha planifikimet dhe menaxhimin e forcave zbatues të ligjit:

- *Grupi Orientues Strategjik (GSO)* në nivelin kombëtar në Drejtorinë e Policisë së Ministrisë së Brendshme kryesohet nga Drejtori Kombëtar i Policisë. Funkcionet dhe përgjegjësitë kryesore bien nën këto kategori: ngarkimi për kryerjen ose kërkesa për një vlerësim strategjik të sigurisë publike dhe produkteve të tjera të inteligjencës kriminale kombëtare; planifikim strategjik, përfshirë vendimmarrjen dhe shpërndarjen e burimeve, bazuar në vlerësimin strategjik dhe produktet e tjera konkrete të inteligjencës kriminale; si dhe monitorim dhe verifikim i zbatimit të planeve strategjike.
- *Grupet Drejtuese Operative* në nivel vendor kryesohen nga secili prej 27 shefave të Drejtorive të Policisë Rajonale (DPR) me këto funksione kryesore: planifikimi operativ në nivel rajonal për parandalimin dhe goditjen e krimit, bazuar në planet strategjike të GSO-së; ngarkimi dhe koordinimi i aktiviteteve operative në nivel DPR; vendimmarrja bazuar në produktet konkrete të inteligjencës kriminale në nivel rajonal; dhe vlerësimi i detyrave, operacioneve dhe hetimeve të përfunduara prej policisë rajonale.

- *Grupet Drejtuese Operative* në nivel vendor kryesohen nga secili prej 27 shefave të Drejtorive të Policisë Rajonale (DPR) me këto funksione kryesore: planifikimi operativ në nivel rajonal për parandalimin dhe goditjen e krimit, bazuar në planet strategjike të GSO-së; ngarkimi dhe koordinimi i aktiviteteve operative në nivel DPR; vendimmarrja bazuar në produktet konkrete të inteligjencës kriminale në nivel rajonal; dhe vlerësimi i detyrave, operacioneve dhe hetimeve të përfunduara prej policisë rajonale.

- *Grupet Udhëheqëse Operative (GUO)* në nivel vendor/stacioni përbëhen nga drejtuesit e stacioneve policore dhe kryesohen nga Komandantët e Stacionit. GUO-t kanë këto funksione kryesore: planifikimi operativ në nivel vendor/stacioni për parandalimin dhe goditjen e krimit, bazuar në planet strategjike të përgatitura nga GSO, Plani Operativ Vjetor i PPGDO-së dhe produktet e inteligjencës kriminale; vendimmarrja, ngarkimi i detyrave dhe koordinimi në nivel vendor/stacioni i aktiviteteve operative, përfshirë hetimin.

Modeli PBI duhet të mishërojë edhe menaxhimin e cilësisë, me qëllim që të jetë një model për menaxhimin e punës operative policore mbi bazën e inteligjencës kriminale. Në Udhëzuesin e PLBI-së, "cilësia" theksohet në lidhje me procesin PBI, burimet njerëzore, trajnimin, kriteret e cilësisë, standardet dhe produktet e inteligjencës kriminale, si edhe në kontekstin e marrëdhënies ndërmjet grupeve udhëheqëse dhe orientuese strategjike dhe operative nga njëra anë, si dhe shërbimi i analizës nga ana tjetër. Kjo tregon se cilësia njihet si një element shumë i rëndësishëm i modelit PBI.



## 8.2.5 Mali i Zi: Vlerësimi i Kërcënimeve nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar

Bazuar në rekomandimet e dhëna në Vlerësimin e Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar (VKKRKO), një autoritet ligjzbatues ka kompetencën të vendosë një listë prioriteteve kombëtare ndërinstucionale (mes agjencive) në luftën kundër krimeve të rënda dhe të organizuar. Këto prioritete pasqyrohen në përcaktimin e detyrave prioritare specifike operative dhe hetimore, si edhe në koordinimin ndërinstucional.

Siç shpjegon Figura 8.8, Vlerësimin e Kërcënimit nga Krimet e Rënda dhe Krimi i Organizuar mbulon periudhën 4-vjeçare dhe hartohet nga një ekip ndërinstucional i përbërë prej përfaqësuesve të sektorit të sigurisë dhe inteligjencës në Mal të Zi.

### DOKUMENTET DHE PRIORITETET STRATEGJIKE




Figura 8.8 Zhvillimi dhe planifikimi strategjik i VKKRKO-së në Mal të Zi

Prioritetet e VKKRKO-së 2013-2017 përfshijnë këto fusha:

- *krimet e rënda ndaj jetës dhe trupit të shkaktuara nga konfliktet ndërmjet grupeve të organizuara kriminale;*
- *Terrorizmi dhe ekstremizmi fetar,*<sup>77</sup> që lidhet kryesisht me pjesëmarrjen e shtetasve malazezë në forcat e huaja të armatosura si edhe me forcimin e ekstremizmit fetar në Gadishullin e Ballkanit;
- *korruptsi i nivelit të lartë i kryer nga persona që kanë statusin e zyrtarit publik;*
- *trafikimi i drogës,* që është aktivitet kriminal dominues nga një numër i madh grupesh të organizuara kriminale;
- *fajdetë,* që njihet si problem i veçantë që rezultojnë në kryerjen e shkeljeve të rënda penale;
- *migrimi i paligjshëm dhe trafikimi i qenieve njerëzore,* që karakterizohet nga abuzimi me procedurat e azilit si edhe shfrytëzimi seksual dhe për punë;
- *pastrimi i parës dhe hetimet financiare,* që njihen si mjet efektiv në luftën kundër krimin të organizuar.

77 Termi i OSBE-së është "ekstremizmi i dhunshëm".

*Grupi Kombëtar Ndërinstitucional Operativ*<sup>78</sup> është një grup pune për luftën kundër krimeve të rënda dhe krimit të organizuar i ngritur në vitin 2015. Grupi operativ është një organ ndërinstitucional që përbëhet nga përfaqësues të këtyre institucioneve:

- Ministria e Drejtësisë
- Policia
- Agjencia Kombëtare e Sigurisë
- Doganat
- Departamenti i Të Ardhurave Publike
- Administrata për Parandalimin e Pastrimit të Parasë dhe Financimit të Terrorizmit.

Grupi Ndërinstitucional Operativ ka këto detyra:

- propozon prioritetet kombëtare në luftën kundër krimeve të rënda dhe krimit të organizuar
- propozon objektiva strategjike dhe plane strategjike shumëvjeçare në luftën kundër krimeve të rënda dhe krimit të organizuar;
- propozon një Model Kombëtar Inteligjence për përcaktimin e prioritetëve, menaxhimin dhe caktimin e detyrave në trajtimin e krimeve të rënda dhe krimit të organizuar bazuar në VK-KRKO;
- miraton dhe zbaton plane operative vjetore në luftën kundër krimeve të rënda dhe krimit të organizuar, bazuar në prioritetet strategjike të përcaktuara;
- siguron bashkëpunim ndërinstitucional në kryerjen e aktiviteteve të posaçme në nivel operativ në luftën kundër krimeve të rënda dhe krimit të organizuar;
- shqyrton masa për zbatim efikas të Modelit Kombëtar të Inteligjencës në përcaktimin e prioritetëve, menaxhimin dhe caktimin e detyrave bazuar në VKKRKO;
- dorëzon raporte tremujore të punës që bën pranë Byrosë për Koordinimin Operativ;
- kryen detyra të tjera me qëllim drejtimin e aktiviteteve në luftën kundër krimeve të rënda dhe krimit të organizuar;

Mali i Zi ka modifikuar lehtësisht metodologjinë e vlerësimit të Kanadasë, Sleipnir, që përdoret për të vlerësuar kërcënime nga grupet e organizuara kriminale të identifikuara dhe për të krahasuar kërcënimet ndërmjet grupeve, si edhe për të identifikuar boshllëqet në inteligjencë që duhen mbushur. Versioni i modifikuar malëz i modelit Sleipnir përbëhet nga 14 kritere kërcënimi që janë objekt vlerësimi, siç paraqiten në Tabelën 8.3.

---

78 Fletorja Zyrtare e Malit të Zi. "Ligji për Bazën e Sektorit të Inteligjencës dhe Sigurisë në Mal të Zi". Nr. 28/14: Neni 17.



Tabela 8.3 Versioni malazez i instrumentit vlerësues Sleipnir

Identifikimi i Grupit	Shifra e kërcënimit	Kërcënimit													
		Korrupsioni	Dhuna	Biznes i ligjshëm	Pastrim i parasë	Bashkëpunim me grupet kriminale	Mbrojtja e Kërëve	Monopoli	Territori i veprimt	Kundërmasat	Diversiteti (krimi)	Disiplina/rendi	Kohezioni	Përmasat	Eksportiza
N-RV01-00	230.3														
N-RA03-00	226.0														
N-BK02-06	215.4														
N-BK06-09	212.1														
R-BS01-92	209.3														
R-BS01-90	206.8														
R-NI04-08	202.9														
R-NI01-95	193.5														
R-HI02-08	191.7														
R-BK01-06	189.1														
R-HI01-08	184.1														
R-UR07-09	183.7														
L-UK02-05	180.2														
L-IA01-97	177.9														
L-PG02-00	174.2														
L-BS06-11	172.7														
L-BS04-00	172.1														
L-BS08-00	171.2														
L-HI04-10	161.1														
L-HI03-10	143.2														

Kërcënimit	i lartë	Mesatar	i panjohur	i ulët	Zero
Vlera i atribuohet në matricë					

### 8.3 PBI dhe policimi në komunitet

Policimi në komunitet fokusohet në zgjidhjen kolektive të problemit, parandalimin e krimit dhe ndërtimin e besimit ndërmjet policisë dhe komuniteteve të cilave iu shërbejnë. Praktikrat dhe parimet e policimit në komunitet ndihmojnë në ngritjen dhe forcimin e partneritetit polici-publik, ku policia, agjencitë shtetërore dhe komunitetet vendore bashkëpunojnë aktivisht për zgjidhjen e problemeve dhe halleve të komunitetit.<sup>79</sup> Lëvizja e policimit në komunitet bazohet në konceptim që angazhimi i komunitetit i përmirëson operacionet policore dhe efektin organizativ të saj, si edhe forcon legjitimitetin e policisë në sytë e publikut.

Fokusi specifik i policimit në komunitet po rritet dhe po përmirëson marrëdhëniet ndërmjet komunitetit dhe policisë, dhe bazohet në identifikimin e krimit dhe kundërvajtjeve vendore bashkërisht me policinë ku, edhe zgjidhja e tyre mund të bëhet bashkërisht kur është e mundur. Policimi në komunitet ngrihet me besimin se një qasje më e koordinuar dhe bashkëpunuese mund të zgjidhë problemet aktuale dhe t'i parandalojë në të ardhmen. Kjo qasje përfshin edhe punën në mënyrë më shumë-disiplinore dhe me mundësinë që edhe partnerëve të tjerë, si edhe përfshirjen në një program të pushtetit vendor, agjencive dhe departamenteve të tjera shtetërore edhe të shoqatave e komunitetit.

Policimi komunitet mund të çojë edhe në komunikim më të mirë dhe më të qëndrueshëm me dhe nga publiku. Edhe pse oficerët e policimit në komunitet nuk duhet të ngarkohen me detyrën e grumbullimit të inteligjencës, forcimi i besimit mund të rezultojë për policinë një burim i paçmuar i informimit dhe sensibilizimit të komunitetit. Kështu, policia merr informacion të çmuar për planifikimin dhe shënjestrimin më me efikasitet të operacioneve kundër krimit dhe terrorizmit dhe kështu, policimi në komunitet dhe PBI drejtpërdrejtë mbështesin njëri-tjetrin.

Policimi në komunitet është përpjekur të zgjerojë mandatin policor nga një fokus i ngushtë i luftimit dhe hetimit të krimit, në një fokus më të gjerë që angazhon më aktivisht komunitetin me qëllim që të merren mendimet dhe shqetësimet e komunitetit për një gamë të gjerë problematikash: përfshirë frikën nga krimi, parandalimin e krimit, prishjen e qetësisë publike, konfliktet fizike dhe probleme të tjera sociale dhe të lagjes. Parimet kryesore të pasqyruara në policimin në komunitet përfshijnë një qasje më të orientuar drejt shërbimit, e bazuar në vizibilitet, qasje dhe njohje; me fokus të veçantë të zgjidhja e problemeve në mënyrë kolektive.<sup>80</sup> Kështu, policia ka një mjet për t'u qasur më me efektivitet publikut si dhe të identifikojë dhe të zgjidhë problemet që janë prioritet për publikun.<sup>81</sup>

Sipas parimeve kryesore të policimit në komunitet, policia duhet:

- të angazhohet, të mobilizohet dhe të jetë partner i komuniteteve;
- të dëgjojë shqetësimet e komuniteteve;
- të përfshihet në zgjidhjen e problemeve me komunitetin;
- të jetë i dukshëm dhe e kapshme për publikun;
- të njohë publikun dhe të njihet prej publikut;
- t'u përgjigjet nevojave të komuniteteve;
- të respektojë dhe të mbrojë të drejtat e të gjithë anëtarëve të komunitetit; dhe
- të japë llogari për veprimet dhe rezultatet e veprimeve që ndërmerr.<sup>82</sup>

79 OSBE (2008a: 89).

80 Innes, Martin. Why 'soft' policing is hard: on the curious development of reassurance policing, how it became neighbourhood policing and what this signifies about the politics of police reform. *Journal of community applied social psychology*, Vol. 15, No. 3 (2005: 156-169); and Quinton, Paul and Morris, Julia. "Neighbourhood policing: the impact of piloting and early nation implementation.", (Home Office Online Report, 01/2008) [<http://webarchive.nationalarchives.gov.uk/20110314171826/http://rds.homeoffice.gov.uk/rds/pdfs/08/rdsolr0108.pdf>] Vizituar më 2 qershor 2017. rds/pdfs/08/rdsolr0108.pdf] Пристапено на 2 јуни 2017 година.

81 Bullock (2013: 126-127).

82 OSCE, ODIHR/TNTD (2014: 76).

Siç folëm në Kapitullin 3, PBI është hartuar për të sfiduar modelin policor dominues dhe tradicional që bazohet në policim reagues. PBI është një qasje dhe kuadër vendimmarrës menaxherial nga poshtë lart, dhe ka implikime si për mënyrën si organizohet polici, por edhe për mënyrën si funksionon. Në aspektin organizativ, ndryshe nga policimi në komunitet që i jep diskrecion të lartë efektivëve policorë që të ndërtojnë marrëdhënie me komunitetet vendore, PBI është detyrimisht më e centralizuar. Grumbullimi dhe analizimi sistematik i të dhënave dhe informacionit shërbejnë si bazë për vendimmarrje menaxheriale të informuar.

PBI dhe policimi në komunitet janë qasje komplementare që mbështesin njëra-tjetrin, por kanë disa karakteristika dalluese në lidhje me orientimin e tyre, fokusin hierarkik dhe aktorët vendimmarrës të përshkruar në Tabelën 8.4.

**Tabela 8.4 Krahasimi i dimensioneve kyçe të policimit në komunitet dhe PBI**

